

MANUALI I RAN

Reagimet ndaj personave të kthyer: Luftëtarët e huaj terroristë dhe familjet e tyre

the 1990s, the incidence of *S. flexneri* has increased in the United Kingdom [10]. In the United States, *S. flexneri* has been reported to be the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [11]. In the United Kingdom, *S. flexneri* serotype 3 is the most common serotype isolated from patients with shigellosis [12].

There is a paucity of data on the epidemiology of *S. flexneri* in the United Kingdom. In the 1980s, *S. flexneri* was the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis in the United Kingdom [13]. In the 1990s, *S. flexneri* was the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis in the United Kingdom [14].

The purpose of this study was to determine the prevalence of *S. flexneri* in the United Kingdom. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12]. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12]. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12]. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12]. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12]. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12]. The study was conducted in the United Kingdom, where *S. flexneri* is the most common serotype of *Shigella* isolated from patients with shigellosis [12].

MANUALI I RAN

Reagimet ndaj personave të kthyer: Luftëtarët e huaj terroristë dhe familjet e tyre

Akronimet

CVE	Lufta kundër terrorizimit të dhunshëm
ERC22+	Extreme Risk Guidelines 22 – Mjet i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për vlerësimin e rrezikut
ESCN	European Strategic Communications Network
LHT	Luftëtarët e huaj terroristë
HCR-20	Mjet për vlerësimin e rrezikut (Menaxhimi Historik, Klinik i Rrezikut)
HTS	Hay'at Tharir al-Sham
IR46	Mjet për vlerësimin e rrezikut i përdorur nga policia holandeze
OJQ	Organizatë joqeveritare
PTSD	Çrregullimi i stresit post-traumatik
RAN	Radicalisation Awareness Network
RAN CoE	Radicalisation Awareness Network Centre of Excellence
RAN H&SC	Radicalisation Awareness Network Health and Social Care (Grupi i Punës)
RAN POL	Radicalisation Awareness Network Police and Law Enforcement (Grupi i Punës)
RAN P&P	Radicalisation Awareness Network Prison and Probation (Grupi i Punës)
TRAP-18	Mjet për vlerësimin e rrezikut
SHED	Shkelës ekstremist i dhunshëm
VERA-2	Mjet për vlerësimin e rrezikut

Rekomandimet e specialistëve për Shtetet anëtare

Kjo listë rekomandimesh nga specialistët vlerëson përvojat e specialistëve dhe reflekton masat që specialistët mendojnë se do të lehtësonin punën e homologëve të tyre. Ajo synon t'u japë autoriteteve kombëtare më shumë informacione rreth nevojave dhe ideve të specialistëve ndërsa shqyrtojnë përjasjet dhe strategjitë ekzistuese nën dritën e sfidave që lidhen me luftëtarët e huaj terroristë (LHT) që kthehen dhe familjet e tyre.

Rekomandimet e specialistëve rreth vlerësimit të rrezikut dhe bashkëpunimit multi-agjenci

- 1) Për të përshtatur vlerësimet me specifikat e të kthyerve, merrni në konsideratë përdorimin e RAN CoE Returnee 45, një mjet për hetimin e motivit, përkushtimit dhe rreziqeve që paraqesin personat e kthyer, me qëllim që:
 - a) të kontrolloni nëse vlerësimet e rrezikut të përdorura aktualisht mund të përfitojnë nga ky mjet i RAN, ose;
 - b) të përshtatet mjeti i RAN, që përfshin 45 tregues, sipas rrethanave lokale nëse nuk ekziston një mjet i strukturuar për vlerësimin e rrezikut.
- 2) Ndërsa ISIS-i dhe ndoshta edhe organizata të tjera terroriste krijojnë dosje personale rreth aftësive të rekrutëve, konsideroni edhe ju që të përfshini informacionin e këtyre dosjeve në hartimin e reagimeve ndaj individëve të kthyer.
- 3) Si hap i parë në përshtatjen e reagimeve ndaj individëve të kthyer, mund të jetë e dobishme që të konsiderohen dy breza, megjithëse nuk është e përshtatshme të bëhet diferencim strikt:
 - a) brezi i parë i të kthyerve ishin kryesisht burra dhe përbëhej nga ata që ishin motivuar të largohejshin për arsye humanitare dhe/ose për të luftuar kundër regjimit të Asadit — me disa përjashtime të dukshme — më të prirur që të zhgënjehen, ndoshta më pak të dhunshëm dhe relativisht të lirë për t'u larguar nga territoret e kontrolluara nga terroristët;
 - b) brezi i dytë i të kthyerve, ai aktual, është më i kalitur në betejë dhe i përkushtuar ideologjikisht, i është dashur të shmangë mbikëqyrjen e lartë të ISIS-it për t'u arratisur dhe mund të jetë kthyer me motive të dhunshme: për të dëmtuar qytetarët e BE-së.
- 4) Ndërsa oficerët e policisë (lokale) shpesh përfshihen në një fazë të hershme, merrni në konsideratë pika specifike veprimi për oficerët e policisë që merren me të kthyerit, duke përfshirë:

- a) pjesëmarrjen në menaxhime të çështjes multi-agjenci dhe hapjen e dosjeve për këdo që është larguar, në vend që të prisni për kthimin e tyre;
 - b) ndërgjegjësimin për procedurat e mbrojtjes së fëmijëve dhe mënyrën e trajtimit të abuzimit të fëmijëve;
 - c) testimin e protokolleve për ndarjen e informacionit me prindërit në rastet e të kthyerve;
 - d) caktimin e një specialisti policie me të cilin mund të konsultohen specialistët e tjerë të vijës së parë;
 - e) bashkëpunimin me punonjësit e familjeve gjatë përfshirjes me familjet, veçanërisht gjatë vizitave në shtëpi dhe që kjo të bëhet sapo një person largohet sepse kjo lehtëson krijimin e partneritetit kur ai/ajo kthehet.
- 5) Merrni në konsideratë krijimin e një pike kontakti të caktuar ose taskforcë në nivel kombëtar, ose nëse është e përshtatshme, një koordinator për personat e kthyer, për të garantuar koherencën me politikën dhe masat e agjencive qeveritare dhe për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me koordinatorët lokalë multi-agjenci.
 - 6) Rishikoni dhe, aty ku është e përshtatshme, përshtatni programet, metodat dhe ndërhyrjet ekzistuese për të riintegruar individët e radikalizuar, në vend që të zhvilloni metoda të reja vetëm për personat e kthyer; përshtatja e ndërhyrjeve që janë vërtetuar se janë efikase në rrethana të krahasueshme do të ketë vlerë të shtuar të shpejtë krahasuar me programet krejtësisht të reja.

Rekomandimet e specialistëve rreth ndjekjes penale dhe burgosjes

- 7) Investoni në risocializimin e të kthyerve të dënuar ndërkohë që janë ende nën ndalim për të ulur rrezikun e recidivizmit në ekstremizëm të dhunshëm.
- 8) Preferohet që ndërhyrjet e risocializimit të nisin përpara gjyqit, qoftë kur janë nën ndalim apo në një mjedis lokal. Megjithatë, bashkëpunimi me luftëtarët e huaj terroristë të kthyer për ndërhyrjet e risocializimit përpara gjyqit do të jetë sfidues sepse bashkëpunimi mund të shihet sikur nënkupton se janë fajtorë
- 9) Për të shmangur efektet negative afatgjata të burgut të sigurisë së lartë për personat e kthyer me rrezikshmëri të ulët, nevojiten vendimet dhe masa të personalizuar mbi vendosjen dhe rehabilitimin, duke marrë në konsideratë profilet e ndryshme të personave të kthyer dhe të shkeljeve që mund të kenë kryer.
- 10) Konsideroni vendosjen e personave të kthyer në burgje specifike, në përputhje me konstatimet e vlerësimit të specializuar të rrezikut, bazuar në:
 - a) kapacitetin e burgut për të ofruar një shumëllojshmëri ndërhyrjesh që nevojiten për rehabilitimin e personit të kthyer;

- b) shkallën se sa është i mundur bashkëpunimi multi-agjenci mes burgut dhe organizatave të tjera;
 - c) dinamikën e popullatës i burgosur-burg (p.sh. nëse i kthyer ka status hero i ose ngacmohet nga të tjerët, kjo mund të ndërhyjë në procesin e rehabilitimit dhe duhet të merret në konsideratë transferimi i të burgosurit).
- 11) Merrni në konsideratë krijimin e një strukture për ndarjen e informacionit për rastet e të kthyerve që u jep mundësinë shërbimeve të burgut dhe të provës të marrin informacione të mjaftueshme rreth rrethanave në të cilat ka jetuar personi i kthyer dhe rreziqet e mundshme ndaj sigurisë që kjo mund të paraqesë për popullatën dhe personelin e burgut, si edhe për komunitetin e gjerë, nëse personi i kthyer lihet i lirë sipas shërbimit të provës. Ky informacion mund të shërbejë gjithashtu për implementimin e programeve të përmirësuar të rehabilitimit.
 - 12) Rishikoni shërbimet e mbështetjes fetare në burg dhe në shërbimin e provës, sepse shumë të kthyer dëshirojnë të bëjnë jetë fetare. Kjo duhet të shfrytëzohet në një mënyrë pozitive për rehabilitimin dhe kërkon kapacitete dhe resurse të mjaftueshme për materiale dhe kurse, dhe shërbyes fetarë të aftë, të trajnuar dhe të besuar.
 - 13) Lehtësoni zhvillimin e moduleve të trajnimit për personelin që punon (direkt) me personat e kthyer për të mbështetur shërbimet gjyqësore, të burgut dhe shërbimin e provës që i adresohen:
 - a) informacionit rreth situatave ndaj të cilave janë ekspozuar personat e kthyer;
 - b) informacionit rreth vlerësimeve të specializuara të rrezikut, mënyrës së interpretimit të tyre dhe se çfarë kuptimi kanë ato në praktikën e përditshme;
 - c) ndërgjegjësimin për traumën dhe se si të balancohet nevoja për të marrë informacion me nevojën për të mbajtur shkelësin e kthyer të stabilizuar nga ana emocionale dhe mendore;
 - d) informacionit rreth kuadrit ligjor dhe strukturave për ndarjen e informacionit të aplikueshëm për personat e kthyer.
 - 15) Merrni në konsideratë plotësimin e politikave të drejtësisë penale me përpjekje për risocializim për personat e kthyer për të cilët nuk është opsion ndjekja penale (p.sh. për shkak të mungesës së provave rreth aktiviteteve penale ose të përgjegjësisë penale).
 - 16) Nëse do të përfshihen të gjithë faktorët e rëndësishëm në një përpjekje gjithëpërfshirëse për të risocializuar dhe riintegruar personat e kthyer sipas rekomandimeve, për të koordinuar këtë përqasje multi-agjenci duken më të përshtatshme autoritet vendore dhe lokale.
 - 17) Përfshini specialistë të shëndetit mendor në kontrollin e shpejtë pas kthimit si edhe në çdo trajtim të nevojshëm. Duhet të kuptohet se të kthyerit mund të jenë jo vetëm autorë të dhunës, por edhe viktimat, duke përfshirë përdhunimin, rrahjet dhe torturat. Përveç PTSD, ata mund të kenë një ndjesi tradhtie dhe zhgënjimi.
 - 18) Identifikoni nëse fëmijët që shoqërojnë të rriturit e kthyer ose — nëse fëmijët kanë qëndruar në BE — nëse ata do të preken nga kthimi i një ose të dy prindërve.
 - 19) Kini kujdes se shumë të kthyer — edhe nëse nuk përfshihen në sjellje kriminale — ende mund të mbështesin fort ideologji që kundërshtojnë femohuesit, fetë e tjera, të ashtuquajturit “të pafë”, të drejtat e grave dhe madje edhe shoqëritë e BE-së si të tilla. Shumica kanë qenë subjekt i një indoktrinimi të thellë. Konsideroni dialogun, përkujdesjen dhe teknika të tjera për të kthyerit që kanë bindje të tilla të forta.
 - 20) Konsideroni nëse riintegrimi i të kthyerve duhet të përfshijë asistencën për çështje praktike të tilla si arsimi, punësimi dhe strehimi, sepse kjo mund të nxisë rehabilitimin.
 - 21) Vlerësoni nëse familjet e luftëtarëve të huaj terroristë mund të jenë partnere në riintegrimin e të afërmeve, idealisht përpara kthimit të tyre. Me kusht që familjet vetë të mos mbështesin ideologji ekstremiste, ato janë shumë të vlefshme në përpjekjet për integrim.
 - 22) Duke pasur parasysh faktin se familjet dhe rrjetet shoqërore të drejtpërdrejta të të kthyerve do të jenë ndikuar shumë nga ngjarjet, duhet marrë në konsideratë mbështetja me grupet e personave të afërt, mbështetja psikologjike dhe mbështetja teologjike për këto familje. Kjo mbështetje ka objektivin e zhvillimit të një mjedisi familjar rezistent për të penguar përfshirjen e ardhshme në ekstremizëm dhe grupe terroriste.

Rekomandimet e specialistëve rreth risocializimit të personave të kthyer në shoqëri

- 14) Informoni autoritetet lokale dhe përfshijini ato në përgatitjen për kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë në një mjedis lokal. Gjithashtu, kur komunitetet kanë numra të lartë luftëtarësh të huaj terroristë, merrni në konsideratë zhvendosjen e të kthyerve, qoftë brenda të njëjtës komunë ose edhe nëpër komuna dhe rajone të tjera, duke qenë se ngjeshja e personave të kthyer brenda komuniteteve (të vogla) pengon rehabilitimin e tyre.

Rekomandimet e specialistëve rreth fëmijëve të kthyer

Duke marrë parasysh nevojën për kujdes dhe mbështetje të menjëhershme, si edhe përqasjen afatgjatë për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të kthyer në shoqëritë e BE-së,

- 23) Konsideroni që t'u jepni specialistëve udhëzime ligjore rreth trajtimit të fëmijëve të kthyer. Në veçanti, kur ka shqetësime se fëmija është përfshirë në aktivitete kriminale jashtë vendit, duhet kushtuar vëmendje e veçantë ndaj dilemës viktimë-autor i krimit, ndarjes së informacionit rreth çështjeve të fëmijëve të kthyer, aplikimin e legjislacionit për të miturit dhe të rriturit në këto raste dhe përdorimit të dënimeve alternative përmes programeve rehabilituese/restauruese.
- 24) Konsideroni që të zhvilloni një përmbledhje të ekspertizës ekzistuese për rehabilitimin e fëmijëve të kthyer. Kjo duhet të përfshijë të paktën përvojë rreth: fëmijëve nga zonat e konflikteve/zonat e luftës, radikalizimin dhe ekstremizmin, trajtimin e traumave, çështjet ligjore në lidhje me fëmijët, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, zhvillimin e fëmijës.
- 25) Për të ndihmuar me zhvillimin e një përgjigjeje koherente dhe efikase ndaj fëmijëve të kthyer, mund të merret në konsideratë një mjet vlerësimi i specializuar për rrezikun dhe nevojat për fëmijët e kthyer; ky mjet mund të aplikohet për një target grup të gjerë fëmijësh që janë radikalizuar ose që janë vulnerabël ndaj radikalizimit.
- 26) Çdo mjet vlerësimi i zhvilluar duhet të marrë në konsideratë fazat e zhvillimit të një fëmije. Prandaj duket e papërshtatshme përshtatja e një mjeti vlerësimi që është projektuar fillimisht për të rriturit.
- Ekzaminoni se si strukturat ekzistuese multi-agjenci mund të trajtojnë fëmijët e kthyer. Mund të përfshihen organizatat me ekspertizë në mbështetjen e fëmijëve të kthyer për të ofruar udhëzime të thella.
- 27) Siguroni trajnim të mjaftueshëm për specialistët që trajtojnë fëmijët e kthyer. Këto module mund të jenë pjesë e trajnimit ekzistues të ndërgjegjësimit ose të ekspertizës rreth parandalimit dhe luftimit të radikalizimit. Disponohen të paktën dy nivele trajnimi:
- a) Trajnimi bazë rreth ndërgjegjësimit për specialistët në kontakt (të drejtpërdrejtë) me fëmijët e kthyer (p.sh. mësuesit e shkollave, punonjësit socialë, anëtarët e organizatave të aktiviteteve argëtuese). Ky trajnim bazë mund të trajtojë, si kërkesë minimale:
 - i) informacion rreth situatës në Siri/Irak ndaj të cilës janë ekspozuar këta fëmijë;
 - ii) ushtrime bazë reaguese dhe për ndërgjegjësimin ndaj traumës kur fëmija i kthyer shfaq një sjellje të veçantë;
 - iii) Informacion rreth mënyrës se si të raportoni shenjat shqetësuese dhe ku të kërkonti ndihmë shtesë.
 - b) Trajnim i thellë dhe sesione të përbashkëta mësimore për specialistët e përfshirë direkt dhe nga afër në rastet e fëmijëve të kthyer (p.sh. shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, profesionistët e mbështetjes së

familjeve, oficerët lokalë të policisë, psikologët). Ky trajnim i thellë mund të përfshijë mësim për kujdesin e birësimit dhe integrimin në shkolla.

Rekomandimet e specialistëve rreth çështjeve që mbulojnë disa fusha (gjinia dhe komunikimi)

- 28) Konsideroni implementimin e reagimeve të riintegrit për personat e kthyer meshkuj — duke pasur parasysh të kaluarën kriminale, kontrollin e ulët të impulseve dhe prirjen për dhunë — me reagime të specializuara për personat e kthyer femra. Shumë gra janë rekrutuar për të përmbushur detyra të ndryshme nga ato që u caktohen burrave (p.sh. bashkëshorte ose nënë), por mund të jenë përfshirë në forma të ndryshme dhune (p.sh. detyrimin e sjelljes sipas rregullave strikte të grupit terrorist në të ashtuquajturën “Brigada Khansaa”). Kjo përshtatje rrit efektshmërinë e vlerësimit të rrezikut dhe të riintegrit.
- 29) Kuptoni se riintegrimi i nënave që kanë arritur të kthehen me fëmijë të vegjël varet shumë nga frika e tyre se mos humbin fëmijët për shkak të masave mbrojtëse për fëmijët. Prandaj, konsiderojeni bashkëpunimin me riintegrimin si një kusht paraprak për kujdestarinë.
- 30) Për të luftuar narrativën terroriste se personat e kthyer do të trajtohen jashtëzakonisht keq në vendet e BE-së, duke përfshirë burgosjen pa gjyq të drejtë, marrjet e gjata në pyetje dhe perspektivën se asnjëherë nuk do të pranohen (sërisht) në shoqëri, konsideroni të theksoni shtetin ligjor, kujdesin shëndetësor dhe arsimin, që do të aplikohen të gjitha për ata. Duke qenë se shumica e personave të kthyer kontaktojnë me familjet e tyre përpara se të kthehen, anëtarët e familjeve janë në pozicionin e duhur për t'u komunikuar këtë. Konsideroni informimin e profesionistëve të mbështetjes së familjeve rreth praktikës aktuale ligjore dhe rehabilituese dhe pasojat për personat e kthyer në mënyrë që ata t'u japin familjeve informacion të saktë.
- 31) Prisni që të ketë mosbesim, armiqësi, stigmatizim dhe izolim për të komplikuar riintegrimin e personave të kthyer, dhe konsideroni adresimin e këtyre sfidave duke komunikuar rreth strategjive të reagimit.
- 32) Prisni që raportet e medias (sociale) të kenë ndikim në shkallën e hapjes së shoqërive ndaj riintegrit të personave të kthyer. Prandaj, përgatitni një strategji (lokale) komunikimi, idealisht përpara mbërritjes së personave të kthyer brenda komunitetit lokal.
- 33) Kur komunikoni me personat e kthyer, familjet e tyre si edhe shoqëritë pritëse ndjekin një strategji që është realiste dhe transparente rreth pasojave dhe situatave me të cilat do të përballen personat e kthyer kur kthehen, duke përfshirë ndjekje penale, monitorim, burgosje dhe ndërhyrje për mbrojtjen e fëmijëve.

Luftëtarët e huaj terroristë (LHT) të kthyer



LHT-të në shifra

Mbi **42 000** luftëtarë të huaj terroristë nga mbi **120** vende u bashkuan me organizatat terroriste mes viteve **2011** dhe **2016**, nga të cilët +/-**5000** vinin nga Evropa. Largimet arritën kulmin në vitin **2015** dhe prej atëherë janë pakësuar.

Kush janë personat e kthyer?

Nga kombësi, etni, mosha dhe gjini të ndryshme
 Të gjithë kanë njëfarë niveli traume dhe problemesh emocionale/ psikologjike



Burra

Rrezik më i lartë përvojë dhe aftësish në luftim.

Shpesh të përfshirë në dhe të ekspozuar ndaj mizorive të luftës.

Role të ndryshme rolesh brenda territoreve të kontrolluara nga.



Gra

Roli në familje dhe nënat për ushtarët e ardhshëm.

Të nxitura nga ndjesia e fuqizimit dhe roli i tyre në ndërtimin e "kalifatit".

Të përfshira në rekrutimin, indoktrinimin e fëmijëve dhe të tjerëve.



Fëmijë

Indoktrinimi intensiv ideologjik përmes arsimit dhe socializimit.

Të rekrutuar për luftim dhe aktivitete të tjera të dhunshme nga mosha 9 vjeçare.

Të traumatizuar rëndë.

Pse kthehen ata?




Të zhgënjyer /
të penduar



Ende të nxitur
nga ideologjia
dëshirojnë kushte
më të mira jetese
(oportunistë)



Të dërguar për të kryer një
sulm (ose ndiejnë se mund
të bëjnë më shumë për
kauzën në Evropë se në
Siri/Irak)



Të kapur dhe të
kthyer kundër dëshirës

Veprimet kyçe për t'u konsideruar



Menaxhimi i çështjeve
mes shumë agjencie.



Strategjia (lokale) e
komunikimit.



Plani i masave të
ndërhyrjes.



Menaxhimi i çështjeve
mes shumë agjencie.



Strategjia (lokale) e
komunikimit.



Plani i masave të
ndërhyrjes.

Skenarët



Ndjekja penale

- Prioritet për risocializimin dhe riintegrimin gjatë burgimit / lirimit me kusht
- Trajnimi i personelit të specializuar
- Vendosje në burgje dhe opsione transferimi të përshtatura



Mosndjekja penale / risocializimi

- Ndërtimi i lidhjeve dhe mbështetja e familjes së të kthyerit nëse është e mundur
- Informacion dhe /ose trajnim për të gjithë që janë në kontakt me të kthyerit
- Përqasje gjithëpërfshirëse për këshillimin, trajtimin (për shëndetin mendor) dhe mbështetjen praktike



Fëmijët

- Fokusimi në normalizimin dhe risocializimin sa më të shpejtë
- Zhvillimi i një këndvështrimi për ekspertizën e fokusuar në traumën dhe indoktrinimin e fëmijëve
- Trajnimi i specialistëve të vijës së parë që punojnë me fëmijët e personave të kthyer

Pasqyra e lëndës

Rekomandimet e specialistëve për Shtetet anëtare	5
1 Hyrje në këtë manual	13
1.1 Manuali për specialistët, rekomandimet e specialistëve për Shtetet anëtare.	14
1.2 Struktura e manualit	14
2 Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer; fakte, shifra dhe profile Luftëtarët e huaj terroristë	17
2.1 Fakte dhe shifra	17
2.2 Rekrutimi, motivimet dhe kushtet e jetesës	18
2.2.1 Rekrutimi dhe udhëtimi.	18
2.2.2 Motivimet për udhëtim (hixhreti).	18
2.2.3 Përfjetimi në arenën e luftimeve	20
2.2.4 Kthimi në Evropë	21
2.3 Profilet e ndryshme të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer	23
2.3.1 Gjeneratat e ndryshme	23
2.3.2 Ndryshimet mes burrave, grave dhe fëmijëve	24
2.3.3 Motivet e ndryshme për kthimin	26
2.4 Sfidat e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer	26
3 Hetimi dhe vlerësimi i rrezikut.	29
3.1.1 Pas nisjes për në Siri / përgatitja e menjëhershme për kthimin	29
3.1.2 Pikat specifike të veprimit për oficerët e policisë që merren me personat e kthyer.	30
3.1.3 Personat e kthyer në tranzit dhe mbërritja në shtëpi	31
3.2 Mjetet e vlerësimit të rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm	32
3.2.1 RAN CoE Returnee 45	33
4 Marrëveshja multi-agjenci mbi ndërhyrjen.	35
4.1 Koordinacija na nacionalnom nivou	35
4.2 Multiagencijski proces na lokalnom i regionalnom nivou.	36
5 Rruga me ndjekje penale	41
5.1.1 Përmbledhje e përgjithshme dhe çështje	41
5.1.2 Sfidat specifike për personat e kthyer	41
5.2 Parimet drejtuese nga perspektiva e burgut	43
5.3 Metodët konkrete dhe modelet e ndërhyrjes në një mjedis burgu	43
5.3.1 Metodët e sigurisë dhe ndërhyrjet	44
5.3.2 Rehabilitimi dhe integrimi: metodat dhe ndërhyrjet	46

5.4	Parimet drejtuese nga perspektiva e shërbimit të provës	51
5.5	Metodat dhe modelet e ndërhyrjes në një mjedis shërbimi prove	52
6	Rruga pa ndjekje penale / risocializimi	59
6.1	Hyrje	59
6.1.1	Pamje e përgjithshme	59
6.1.2	Katër parimet drejtuese për risocializimin dhe riintegrimin e personave të kthyer	59
6.2	Metodat konkrete dhe modelet e ndërhyrjes	62
6.2.1	Reagimet e mbështetjes së familjeve	62
6.2.2	Mentorimi dhe këshillimi	66
6.2.3	Reagimet për shëndetin mendor	70
6.2.4	Reagimet praktike	73
7	Fëmijët e kthyer	75
7.1	Pamje e përgjithshme	75
7.2	Parimet drejtuese rreth punës me fëmijët e kthyer	76
7.3	Strategjia e reagimit ndaj fëmijëve të kthyer	77
7.4	Metodat dhe ndërhyrjet	81
7.4.1	Reagimi ligjor dhe mbrojtja e fëmijës	81
7.4.2	Vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave	83
7.4.3	Vendosja dhe kushtet e jetesës	84
7.4.4	Mbështetja e familjes	85
7.4.5	Roli i (para)shkollave	85
7.4.6	Praktika e informuar rreth traumës	87
7.4.7	Adresimi i ideologjisë ekstremiste	89
7.4.8	Ndërtimi i kapaciteteve për të trajtuar fëmijët e kthyer	89
8	Çështjet që mbulojnë disa fusha	91
8.1	Diferencimi gjinor	91
8.2	Çështjet e komunikimit dhe kundër narrativave	92
8.2.1	Strategjia lokale e komunikimit	92
8.2.2	Komunikimi rreth kthimit	94
	Referencat	95
	Aneksi 1: Përmbledhje e mjeteve të vlerësimit të rrezikut	98
	Aneksi 2: ESCN Personat e kthyer: Çështjet e komunikimit dhe kundër narrativave	101



1 Hyrje në këtë manual

Ky manual thekson reagimet ndaj luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) dhe familjeve të tyre, që kthehen ose planifikojnë të kthehen në vendet e tyre brenda Bashkimit Evropian, nga zonat e konflikteve terroriste si Siria dhe Iraku.¹ Kur termi “person i kthyer” përdoret në këtë manual, u referohet luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjeve të tyre (gra dhe fëmijë).

Reagimet paraqiten nga **këndvështrimi i një specialisti**, dhe duhet të konsiderohet si pjesë e një seti më të gjerë reagimesh ndaj luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer (duke përfshirë masat me fokus sigurie si p.sh. drejtësia penale ose masat administrative).

Kur trajtohen luftëtarët e huaj terroristë të kthyer dhe familjet e tyre, kërkesë paraprake është ruajtja e sigurisë. Ndërhyrjet e ndryshme të propozuara prandaj përfshijnë një aspekt të qartë të sigurisë (p.sh. si pjesë e ekipeve multi-agjenci). Vlerësimet e rrezikut janë mjeti i duhur për të vlerësuar rreziqet e sigurisë dhe për të zhvilluar masat më të përshtatshme zbutëse. Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë mes specialistëve në terren dhe faktorëve të rëndësishëm publikë, duke përfshirë forcat e zbatimit të ligjit, duhet të sigurojë komunikimin e rreziqeve të sigurisë përmes kanaleve të përshtatshme.

Ky manual përcakton përjasjet e përgjithshme që do të përshtaten sipas situatës specifike përkatëse në Shtetet anëtare të BE-së duke marrë parasysh se kompetencat dhe strukturat ndryshojnë brenda qeverive kombëtare, rajonale dhe vendore.

Shtetasit evropianë që udhëtojnë drejt Sirisë, Irakut dhe zonave të tjera të konflikteve që janë nën kontrollin e grupeve terroriste, tani po kthehen. Në muajt e fundit, ISIS-i ka qenë nën presion ushtarak gjithnjë e më rritje në Siri dhe Irak, gjë që i ka shkaktuar grupit humbje të territoreve, udhëheqësve, anëtarëve, dhe itinerareve të furnizimit. Nëse “kalifati” i ISIS-it mposhtet ushtarakisht ose rrëzohet, numri i luftëtarëve të huaj terroristë që kthehen në Evropë (veçanërisht në Austri, Belgjikë, Francë, Finlandë, Holandë, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar) mund të rritet. Megjithëse është e vështirë të parashikohet se si do të evoluojë situata, Shtetet anëtare të BE-së më të prekura presin një rritje të ngadaltë, por graduale të personave të kthyer, në vend që të ketë një numër të madh që mbërrin në njëkohësisht. Këta persona do të kenë të kaluar të ndryshme dhe një numër i madh i të kthyerve do të jenë gra dhe fëmijë.

Trajtimi i këtyre personave të kthyer është kompleks dhe në krye të axhendës për shumë qeveri dhe autoritete vendore. Ndërkohë që kuadri legjislativ dhe opsionet e politikës mund të variojnë sipas Shtetit anëtar, ekzistojnë sfida të përbashkëta kur bëhet fjalë për personat e kthyer, dhe mënyra të përbashkëta për t'i trajtuar ato me efektshmëri. Këto do të ndahen në këtë manual.

Gjatë Konferencës së nivelit të lartë të RAN (HLC) më 9 nëntor 2016, sfidat që lidhen me luftëtarët e huaj terroristë të kthyer u adresuan nga Komisioneri për Migrimin, Punët e Brendshme dhe Nënshetësinë — Dimitris Avramopoulos, dhe Komisioneri për Unionin e Sigurisë — Sir Julian King. Ata theksuan nevojën që specialistët evropianë, ligjvënësit dhe studiuesit të hartojnë dhe të ndajnë reagimet e përshtatshme ndaj kësaj sfide.

Lexim i mëtejshëm: Raporti i RAN HLC:

Ky **dokument aktual** përmban informacion shtesë rreth diskutimeve gjatë RAN HLC, që iu adresua luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer, dhe në veçanti fëmijëve të kthyer dhe polarizimit.

Që prej nëntorit 2016, RAN Centre of Excellence ka zhvilluar mbi dymbëdhjetë takime me specialistët e vijës së parë mbi temën e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer. Gjatë takimeve të grupit të punës së RAN, subjekti është diskutuar nga këndvështrime dhe fusha ekspertize të ndryshme: policia, autoritetet lokale, burgu dhe shërbimi i provës, rinia, familja dhe komunitetet, dalja nga radikalizimi kujdesi shëndetësor dhe social. Sfidat dhe reagi-

¹ Shumë prej reagimeve në këtë manual mund të aplikohen gjithashtu edhe kur trajtohen luftëtarë të tjerë të mëparshëm të huaj (terroristë).

met janë diskutuar gjithashtu nga këndvështrimet e ndryshme të Shteteve anëtare të BE-së brenda Rrjetit të Ligjvënësve të Parandalimit Kombëtar² dhe Komiteti Drejtues i RAN CoE³. European Strategic Communication Network (ESCN)⁴ ka ofruar kontribut dhe ekspertizë të përbashkët mbi komunikimin strategjik dhe strategjitë e komunikimit. Specialistët e vijës së parë nga Shtetet anëtare të BE-së më të prekura kanë ndarë detajet e çështjeve të tyre për të kthyerit dhe mësimet e nxjerra prej tyre; këto çështje janë përdorur për të dhënë kontekstin për këshillat dhe udhëzimet brenda këtij manuali. Si përfundim, janë përdorur dhe janë referuar burime multinacionale, evropiane dhe ndërkombëtare në përgatitjen e këtij manuali. Ky dokument është kulmimi i këtyre përpjekjeve dhe konstatimeve.

1.1 Manuali për specialistët, rekomandimet e specialistëve për ligjvënësit

Ky manual ka si objektiv kryesisht specialistët e vijës së parë siç janë punonjësit socialë, profesionistët e kujdesit shëndetësor, mësuesit ose oficerët e policisë dhe të burgjeve që duhet të merren me personat e kthyer individualisht dhe në nivel lokal. Ai përcakton parimet drejtuese, disa përskrime hap pas hapi, metodat dhe ndërhyrjet që mund të përdoren për të reaguar ndaj personave të kthyer. Specialistët që lexojnë këtë manual mund të referohen te:

Rastet studimore: Specialistët nga vendet e BE-së kanë ndarë përvojat konkrete dhe mësimet e nxjerra nga puna me personat e kthyer. RAN e ka përdorur këtë informacion për të krijuar raste studimore që ilustrjnë formulimet që përmban ky manual dhe për të ofruar informacione specifike rreth realitetit (shpesh me më shumë nuanca dhe më kompleks) gjatë punës së përditshme me personat e kthyer.

Praktika në veprim: shembuj të praktikave konkrete që përdoren nëpër BE janë theksuar, të shoqëruara me referenca për më shumë informacione rreth këtyre praktikave. Shumë janë gjithashtu pjesë e Koleksionit të Praktikave të RAN që shërben për të frymëzuar specialistët në punën e tyre të përditshme.

Lexim i mëtejshëm: Studime, raportime dhe analiza të zgjeruara, janë kryer mbi të gjitha temat dhe çështjet që adresohen në këtë manual, si brenda RAN CoE ashtu edhe nga organizata të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare. Referencat për këtë material shtesë janë integruar në tekst për specialistët që kërkojnë informacion më të thellë dhe më të detajuar rreth çështjeve specifike.

Ky manual synon t'u japë autoriteteve kombëtare më shumë informacione rreth nevojave dhe ideve të specialistëve ndërsa shqyrtojnë përqasjet dhe strategjitë ekzistuese nën dritën e sfidave që lidhen me luftëtarët e huaj terroristë. **Një listë e rekomandimeve të specialistëve për Shtetet anëtare** është përfshirë në fillim të këtij manuali.

1.2 Struktura e manualit

Manuali përbëhet nga tetë kapituj, që pararenden nga Lista e kontrollit e Rekomandimeve për Shtetet anëtare.

- [Rekomandimet e specialistëve për Shtetet anëtare](#)
- [Kapitulli 1 Hyrje në këtë manual](#)
- [Kapitulli 2 Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer; fakte, shifra dhe profile](#)
- [Kapitulli 3 Hetimi dhe vlerësimi i rrezikut](#)
- [Kapitulli 4 Marrëveshja multi-agjenci mbi ndërhyrjen](#)
- [Kapitulli 5 Ndjekja penale](#)

² Rrjeti i Ligjvënësve të Parandalimit Kombëtar është një rrjet kombëtar ligjvënësish i specializuar në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në 28 Shtetet anëtare të BE-së. Rrjeti mbështetet nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Migrimin dhe Punët e Brendshme (DG HOME).

³ Komiteti Drejtues i RAN përbëhet nga bashkëdrejtuesit e Grupeve të Punës të RAN dhe DG HOME.

⁴ European Strategic Communications Network (ESCN) është një rrjet i 26 shteteve që bashkëpunojnë për të ndarë analizën, praktikën e mirë dhe idetë rreth përdorimit të komunikimeve strategjike në luftën kundër terrorizmit të dhunshëm (CVE).

- [Kapitulli 6 Mosndjekja penale / risocializimi](#)
- [Kapitulli 7 Fëmijët e kthyer](#)
- [Kapitulli 8 Çështjet që mbulojnë disa fusha: gjinia dhe komunikimi](#)

Kapitulli 2 ofron një përmbledhje të fushës së aplikimit të çështjes së luftëtarëve të huaj terroristë nëpër Shtetet e ndryshme anëtare të BE-së, informacione të shkurtra se çfarë i motivon luftëtarët e huaj të largohen dhe kontekstin në të cilin kthehen luftëtarët e huaj terroristë të kthyer.

Kapitujt 3 deri 6 përshkruajnë skenarët e ndryshëm gjatë punës me një luftëtar të huaj terrorist të kthyer. Për qartësi, është përdorur një rend logjik. Në realitet, disa prej hapave zhvillohen njëkohësisht.

Kur mbërrin një person i kthyer, qeveria kombëtare dhe/ose vendore do të jenë në pritje të tij/saj për shkak të informacionit të marrë përmes policisë ose agjencive të sigurisë ose inteligjencës, rrugëve të tjera diplomatike ose qeveritare të marrjes së informacioneve, ose do të informohen pak pasi luftëtari i huaj terrorist të kthehet përmes autoriteteve vendore, specialistëve në terren, anëtarëve të familjes ose vetë luftëtari i huaj terrorist. Vlerësimet e inteligjencës dhe hetimet e policisë janë kërkesa paraprake për të përcaktuar rrezikun e mundshëm dhe nëse duhet të ketë ndjekje penale (**Kapitulli 3**).

Paralelisht me këtë, nevojitet koordinimi në nivel kombëtar dhe lokal për të mbështetur planin e ndërhyrjes multi-agjenci për riintegrimin e personit të kthyer brenda shoqërisë (qoftë menjëherë ose pas vuajtjes së dënimit), duke minimizuar kështu rrezikun e mundshëm që mund të paraqesë personi i kthyer. Një ekip lokal multi-agjenci nga qyteti nga është personi i kthyer duhet të njoftohet gjithashtu dhe të fillojë përgatitjet e reagimit të vet (**Kapitulli 4**).

Personi i kthyer mund të ndiqet penalisht, të burgoset dhe të lirohet (me kusht) ose të marrë dënim me shërbim në komunitet (me kusht) (**Kapitulli 5**). Si alternativë, ai/ajo nuk do të ndiqen penalisht dhe risocializimi duhet të nisë menjëherë (**Kapitulli 6**).

Kur përfshihen fëmijë, ata kërkojnë vëmendje të veçantë. Në shumicën e rasteve, ata do të bashkohen me prindërit e tyre të kthyer, por do të kenë nevojë për kujdes specifik (**Kapitulli 7**).

Si përfundim, në **Kapitullin 8**, janë dhënë informacione dhe këshilla të shkurtra mbi çështjet që mbulojnë disa fusha siç është gjinia dhe komunikimet rreth luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer.

Struktura e Manualit të personit të kthyer vizualizohet më mirë si vijon (shikoni faqen vijuese):

Lista për Shtetin anëtar

Kapitulli 1

Hyrje në manual

Kapitulli 2

Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer: Fakte, shifra dhe profile

Kapitulli 3

Hetimi dhe vlerësimi i rrezikut

- Hetimi dhe roli i policisë
- Mjetet e vlerësimit të rrezikut
- Mjeti hetimor RAN CoE Returnee 45

Kapitulli 5

Rruga me ndjekje penale Burgimi:

- Masat e sigurisë
- Deradikalizimi
- Riintegrimi/risocializimi (lidhja me familjet)
- Ndërhyrja ndaj traumës
- Mbështetja psikologjike
- Mentorimi

Publikimi:

- Riintegrimi/risocializimi
- Mbështetja e familjes
- Ndërhyrja ndaj traumës
- Mbështetja psikologjike
- Mentorimi
- Çështje praktike (strehimi, arsimit)

Kapitulli 4

Përqasja multi-agjenci ndaj ndërhyrjeve

- Protokollet e ndarjes së informacionit
- Modelet e bashkëpunimit dhe përfshirja e palëve
- Zhvillimi i planeve të masave

Kapitulli 6

Rruga pa ndjekje penale:

- Deradikalizimi
- Riintegrimi/risocializimi
- Mbështetja e familjes
- Ndërhyrja ndaj traumës
- Mbështetja psikologjike
- Mentorimi
- Çështje praktike (strehimi, arsimit)
- Këshillimi

Kapitulli 7

Fëmijët e kthyer

- Çështjet ligjore - Mbrojtja e fëmijës - Roli i shkollave
- Vendorsja dhe kushtet e jetesës - Praktika e informuar rreth traumës - Mbështetja e familjes

Kapitulli 8

Çështjet që mbulojnë disa fusha

Gjinia, komunikimi strategjik dhe narrativat

2 Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer: Fakte, shifra dhe profile

Ky kapitull jep informacione rreth eksperiencave të Evropës në lidhje me luftëtarë e huaj terroristë të kthyer, si edhe pse kaq shumë njerëz u larguan nga Evropa për t'u bashkuar me grupe terroriste. Ai trajton profilet e shumta të luftëtarëve të huaj terroristë të Evropës, si edhe motivet e ndryshme për kthimin dhe sfidat që krijojnë këto.

Luftëtarët e huaj terroristë (LHT)

Luftëtarët e huaj terroristë nuk janë fenomen i ri. Shumë zona konfliktesh kanë tërhequr luftëtarë të huaj në të kaluarën, si p.sh. Bosnja, Çeçenia, Afganistani, Pakistani etj. Efektet e padëshiruara kanë qenë të dukshme në shumë sulme terroriste, si p.sh. në sulmet me bombë në Londër në vitin 2005, autorët e të cilave kishin marrë trajnim jashtë vendit në Pakistan. Ajo që është unike për kontigjentet aktuale të luftëtarëve të huaj në Siri dhe Irak është volumi i lartë i luftëtarëve të huaj, që është i paprecedentë. Shumë nga këta shtetas evropianë që udhëtojnë drejt Sirisë, Irakut dhe zonave të tjera të konflikteve ku sundojnë grupet terroriste, tani po kthehen. Në fakt, shumë prej tyre janë kthyer tashmë.

Në muajt e fundit, ISIS-i ka qenë nën presion ushtarak gjithnjë e më rritje në Siri dhe Irak, gjë që i ka shkaktuar grupit humbje të territoreve, udhëheqësve, anëtarëve, dhe itinerareve të furnizimit. Nëse "kalifati" i ISIS-it mposhtet ushtarakisht ose rrëzohet, numri i luftëtarëve të huaj terroristë që kthehen në Evropë (veçanërisht në Austri, Belgjikë, Francë, Finlandë, Holandë, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar) pritet të rritet. Megjithatë është e vështirë të parashikohet se si do të zhvillohet situata, Shtetet anëtare të BE-së më të prekura presin një rritje të ngadaltë, por graduale të personave të kthyer, në vend që të ketë një numër të madh që mbërrijnë njëkohësisht. Ekzistojnë përlllogaritje të ndryshme, që parashikojnë nga 1200 deri në 3000 persona të kthyer. Ata do të kenë të kaluar të ndryshme dhe një numër i madh i të kthyerve do të jenë gra dhe fëmijë. Deri më tani norma e kthimit për luftëtarët e huaj terroristë është rreth 20-30 %.

2.1 Fakte dhe shifra

Më shumë se 42 000 luftëtarë të huaj terroristë kanë udhëtuar për t'u bashkuar me ISIS-in nga mbi 120 vende (mes viteve 2011-2016). **Më shumë se 5000 luftëtarë të huaj terroristë janë nisur nga Evropa.** Shumë prej tyre janë larguar nga Belgjika, Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, por një numër i konsiderueshëm është larguar edhe nga Austria, Danimarka, Finlanda, Italia, Holanda, Spanja dhe Suedia. **Përqindja mesatare e luftëtarëve të huaj terroristë që kthehen në Evropë është rreth 30%,** por shifra është më e lartë për Danimarkën, Suedinë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Rreth gjysma e luftëtarëve të huaj terroristë nga këto vende janë kthyer.

Mobilizimi i luftëtarëve të huaj terroristë duket se ka arritur kulmin në vitin 2015, dhe **flukset u frenuan në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2016** në lidhje me udhëtimin në Siri. Vazhdimi i konfliktit që përfshiu Irakun, Sirinë dhe zona të tjera konfliktesh, i kombinuar me rënien e ISIS-it, ka sjellë një shqetësim serioz dhe në rritje për një eksod masiv të luftëtarëve dhe një fluks hyrës të madh të luftëtarëve të huaj terroristë që kthehen. Është e qartë se Evropa duhet të presë një rritje në numrin e të kthyerve që kanë jetuar dhe luftuar me ISIS-in ose grupin e lidhur me al-Qaeda Hayat Tahrir al-Sham (HTS, i njohur më parë si Jabhat Fateh al-Sham, me emrin e mëparshëm Jabhat-al Nusra).

Ekspertët konsiderojnë se nuk ka të ngjarë të ketë një eksod masiv të luftëtarëve të huaj terroristë, por disa do të kthehen në lagjet e tyre të vjetra (kjo ka më shumë mundësi të ndodhë për gratë dhe fëmijët). Disa do të burgosen, të tjerë jo. Shumë do të përjetojnë trauma nga shkaktimi ose dëshmimi i dhunës. Disa persona të kthyer do të jenë të zhgënjyer dhe madje të penduar; disa të tjerë do të vazhdojnë të kenë pikëpamje ekstremiste të dhunshme dhe mund të bëhen radikalizues influencues, ose madje edhe terroristë në gjendje

të fjetur. Disa do të kthehen me qëllimin e qartë për të planifikuar dhe ekzekutuar sulme.

Sulmet terroriste në Bruksel në maj 2014 (Muzeu Hebraik) dhe mars 2016 (aeroporti dhe stacioni i metrosë), si edhe sulmet e shumëfishta në Paris në nëntor 2015, ishin të gjitha mizori të kryera në njëfarë shkalle nga luftëtarët e huaj terroristë të kthyer. Në sulmet e Parisit, të paktën gjashtë prej autorëve ishin luftëtarë të huaj terroristë të kthyer nga Siria, ndërsa tre nga pesë sulmuesit e Brukselit ishin luftëtarë të huaj terroristë të kthyer. Megjithatë shumë luftëtarë të huaj terroristë të kthyer nuk bëhen terroristë operacionalë, thjesht kontakti me grupe terroriste “xhihadiste” si ISIS-i dhe/ose HTS nënkupton rreziqe të konsiderueshme të sigurisë kombëtare. Është gjetur lidhja operationale mes ISIS-it dhe autorëve për një numër të konsiderueshëm komplotesh terroriste brenda Evropës. Mes viteve 2014-2016, u kryen 42 sulme terroriste kundër Perëndimit, nga të cilat 38 përfshinin lidhje mes ISIS-it dhe terroristëve që kryen sulmet.⁵

2.2 Rekrutimi, motivimet dhe kushtet e jetesës

Nuk ekziston një profil i vetëm shabllon për luftëtarët e huaj terroristë të kthyer. Historitë e tyre, përjetimet, traumat dhe aftësitë e fituara ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Çdo përjasje efikase për të trajtuar personat e kthyer duhet të ketë këtë parasysh. Në këtë kapitull, manuali ofron informacion në thellësi brenda taktikave të rekrutimit të ISIS-it, situatën në terren në Siri dhe Irak, si dhe rolet e ndryshme që luhen nga llojet e ndryshme të luftëtarëve të huaj terroristë, duke përfshirë gratë dhe fëmijët.

2.2.1 Rekrutimi dhe udhëtimi

Itineraret e udhëtimit që përdoren për t'u bashkuar me ISIS-in ose grupe të tjera terroriste shpesh përfshijnë fluturime drejt qyteteve në Turqi, dhe më pas udhëtimin në kufirin Turqi-Siri. Atje, rekrutët ndihmohen të kalojnë kufirin nga persona ndihmës të ISIS-it; ata intervistohen ose merren në pyetje, plotësohen formularët e rekrutimit për të verifikuar ata që kanë ndihmuar udhëtimin dhe për të dhënë detaje të tjera të verifikueshme personale. Këto formularë përfshijnë 23 fusha me të dhëna.⁶ Dëshmitë e luftëtarëve të huaj tregojnë se **rekrutët më pas ndahen sipas aftësive specifike të identifikuara nga ISIS** që përcaktojnë nëse rekruti, pas stërvitjes, do të marrë detyra në vijën e frontit ose role më të specializuara. Kur plotësohet kjo dosje personeli nga ISIS-i, rekrutët meshkuj pyeten se kush i rekomandoi ose kush mund të dalë garant për ta, dhe çfarë roli dëshirojnë të luajnë. Në veçanti, ata pyeten “të zgjedhin nga tri opsione: luftëtar, sulmues vetëvrasës, dhe luftëtar vetëvrasës (Inghimasi)”. Ky formular rekrutimi është një mjet i çmuar për të verifikuar informacionin e dhënë nga luftëtarët e huaj terroristë të kthyer gjatë intervistave.

Manualët e rekrutimit si p.sh. *Hixhreti drejt Shtetit Islamik (2015)* ofrojnë këshilla praktike për përgatitjen, pajisjet dhe udhëtimin, si edhe udhëzime se si të fshihen pas mbërritjes në Turqi dhe gjatë rrugës për në shtëpitë e ndryshme të sigurta përgjatë kufirit. Ai përmban gjithashtu pjesë që u përkushtohen grave që udhëtojnë drejt Sirisë. Rekrutet femra këshillohen se mund të udhëtojnë pa një mahram (shoqërues mashkull) për të maskuar qëllimin e tyre. Kur udhëtojnë së bashku me bashkëshortët, gratë çohen në një shtëpi të veçantë të quajtur madhāfah⁷ derisa burrat e tyre të kenë përfunduar kampin stërvitor. Që prej vjeshtës 2015, flukset e udhëtimeve janë reduktuar. Ulja e flukseve të udhëtimit ka ndodhur për shkak të një mungese në rekrutë, zhgënjimit mes luftëtarëve të kthyer, humbjeve ushtarake dhe territoriale nga ISIS-i, si dhe masat e synuara të sigurisë kundër luftëtarëve të huaj duke ua bërë të vështirë atyre që të udhëtojnë.

2.2.2 Motivimet për udhëtim (hixhreti)

Ka arsye të shumta për individët që bashkohen me grupet ekstreme terroriste të tilla si ISIS-i dhe HTS. Kjo do të thotë se **nuk ekziston një profil shabllon psikologjik për luftëtarët e huaj terroristë**. Ata janë gjithashtu të

⁵ Olidort J. (2016), Inside the Caliphate's Classroom: Textbooks, Guidance Literature and Indoctrination Methods of the Islamic State, Policy Focus 147.

⁶ Dodwell, B., Milton, D., Ressler, D., Then and Now: Comparing the Flow of Foreign Fighters to AQI and the Islamic State (Version of 8 December 2016). Marrë nga <https://www.ctc.usma.edu/v2/wp-content/uploads/2016/12/Then-and-Now.pdf>.

⁷ Fjala madhāfah aplikohet për një shtëpi vizituese ose shtëpi pritjeje. Që prej xhihadit në Afganistan, ajo përdoret për shtëpitë e sigurta ku terroristët e huaj akomodohen përpara se të bashkohen me kampet stërvitore xhihadiste.

kombësive, etnive, moshave të ndryshme dhe të të dyja gjinive. Nuk ekziston një faktor i vetëm, por shumë vektorë që kombinohen për të formuar kombinime të pafundme shkaqesh. Një mori e ndryshme faktorësh të nxitura nga media sociale, dinamika e grupit dhe radikalizuesit influencën procesin e radikalizimit⁸. Ekziston ende një mungesë informacioni të konsoliduar dhe të bazuar në prova rreth sfondit dhe procesit të radikalizimit për ata luftëtarë të huaj terroristë që janë larguar drejt Sirisë dhe Irakut, si edhe rreth problemeve që shoqërojnë personat e kthyer. Shpesh informacionin e kanë shërbimet e sigurisë dhe policia. Megjithatë ka disa përjashtime, siç përshkruhet më poshtë.

Një mënyrë për të kuptuar pse individët janë të motivuar dhe rekrutohen për t'u bashkuar me këto grupe, është të shikojmë **temat qendrore të propagandës së ISIS-it** dhe mënyrën se si janë ndërtuar. [Ingram](#)⁹ argumenton se blloqet ndërtuese të propagandës së ISIS-it kanë lindur nga tri tema të ndërthurura dhe të lidhur me njëra-tjetrën: **identiteti, konstrukti i krizës dhe konstrukti i zgjidhjes**. Përkatësisht, ISIS-it përdor ndërthurjen mes narrativave përforcuese të vlerave, dikotomisë, krizës për të forcuar identitetet brenda dhe jashtë grupit, si edhe sistemin e përgjithshëm të kuptimit. Tema specifike janë projektuar në të gjithë propagandën e ISIS-it, sipas, [të tilla si: utopia mëshira, përkatësia, brutaliteti, viktimizimi, lufta dhe utopia Winter](#).¹⁰ [Të tjerë](#)¹¹ kanë identifikuar tema të tilla si: **ushtria, qeverisja, da'wa (përhapja), hisbah (kontrolli i sheriatit), promovimi i "kalifatit" dhe sulmet e armiqve**. Këto studime ofrojnë pika hyrjeje për të kuptuar motivimet e luftëtarëve të huaj terroristë për të kryer *hixhretin*.

Një [studim](#)¹² i numrave të vjetër të revistave të ISIS-it *Dabiq* dhe *Rumiyah* zbulon tema të ndryshme të paraqitura, por një luhajtje mes të dyjave: lufta dhe utopia. Nuk është çudi që studimi tregon se çështja e luftës ka qenë më e spikatur me kalimin e kohës ndërsa ISIS-i ka humbur territore. Në lidhje me temat e lutës, ISIS-i paraqet fitore të pashmangshme, martirizim, vrasjen e armiqve dhe viktimizim. Temat që lidhen me utopinë fokusohen te përkatësia, mirëqenia, drejtësia dhe rendi, dhe duke fshirë shkeljet kulturore.




Figura 2: Lisa Kaati (FOI, Maj 2017)

⁸ Radicalisation Awareness Network (RAN), (2016). Raport: 'The Root Causes of Violent Extremism'. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/home-affairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_root-causes_jan2016_en.pdf.

⁹ Ingram, H.J. (2016), *Deciphering the Siren Call of Militant Islamist Propaganda* (The Hague: ICCT).

¹⁰ Winter, C., *Documenting the Virtual Caliphate* (London: Quilliam Foundation, 2015).

¹¹ Zelin, A. Y., *Picture Or It Didn't Happen: A Snapshot of the Islamic State's Official Media Output*. (Versioni i 2015). Marrë nga <http://www.terrorismanalysts.com/pt/index.php/pot/article/view/445/html>.

¹² Kaati, L., (2017), *Det digitala kalifatet: En studie av Islamiska statens propaganda* (Stockholm: FOI (FOI-R—4429—SE)).

Një temë qendrore që ISIS-i promovon për të tërhequr mbështetësit dhe rekrutët është ajo e suksesit. Slogani i ISIS-it *“Baqiyah wa-Tatamaddad”* (qëndrojmë dhe zgjerohemi) paraqet një imazh që ISIS-i vazhdimisht arrin sukses dhe fitore të pashmangshme. Si i tillë është në lëvizje të vazhdueshme dhe në veprim kinetik. Ai **kombinon këtë imazh statusi dhe përkatësie me atë të një utopie për “myslimanët e devotshëm”**, dhe njëkohësisht e paraqet veten si mbrojtës i myslimanëve që janë nën sulmet dhe dhunën e shtypësve dhe tiranëve. Sipas propagandës së ISIS-it, kushtet shtypëse që përjetojnë ata që vuajnë, të kombinuara me premtimin e një utopie fetare, e bëjnë detyrë të shenjtë për çdo individ që të kryejë hixhretin dhe të shpallë xhihadin kundër armiqve. Edhe disfatat dhe humbjet interpretohen si pjesë e procesit që çon betejat përfundimtare apokaliptike, që janë pjesë e eskatologjisë së ISIS-it.

Strategjitë e rekrutimit kryhen si në botën virtuale ashtu edhe në atë reale. Mesazhet online janë të thjeshta, të fuqishme dhe binare, dhe u ofrojnë myslimanëve zgjedhje radikale mes braktisjes së jetës së tyre laike dhe me konflikte në Perëndim dhe të ndërmarrjes së hixhretit drejt të ashtuquajturit kalifat, ose të qëndrojnë të shtypur dhe të nënshtruar nga tiranët në Perëndim. Si i tillë rekrutimi i ISIS-it fokusohet te teknologjitë bindëse që shfrytëzojnë konfuzionin rreth identitetit dhe fokusohen te bindja, manipulimi emocional dhe bindja e plotë.

Ka shumë arsye pse rekrutët janë të tërhequr ndaj kësaj ideologjie shkatërruese dhe të motivuar të bashkohen. Për disa prej tyre ofron **ngazëllim dhe status, mundësi për të grabitur, paga, strehim**, si dhe opsionin për të mbajtur gra si skllave; për të tjerët është një mundësi për të ofruar **ndihmë humanitare**.¹³ Për disa ofron një rrugë arratisjeje nga jeta e tyre e zakonshme, e trishtuar dhe e mbushur me probleme. Të tjerët kërkojnë **një sens përkatësie, një sens qëllimi dhe një thirrje më të lartë**. Mund të ofrojë ngazëllim dhe aksion, ose rregulla të rrepta se si të jetojnë brenda një kornize të qartë morale. Disa rekrutohen nga brenda familjeve të tyre dhe rretheve shoqërore. Duke përdorur teknikat bindëse, rekrutuesit e ISIS-it identifikojnë dobësitë psikologjike të individëve dhe me mjeshtëri i shfrytëzojnë këto përmes teknikave në botën virtuale dhe atë reale.

Motivimi humanitar ishte i fortë në fazën e hershme të konfliktit deri në 2014 kur u shpall “kalifati”. Ndërkohë që individët u tërhoqën fillimisht për të udhëtuar për arsye humanitare, disa të tjerë më vonë u tërhoqën nga ideologji dhe synime shkatërruese.

Lexim i mëtejshëm: *Raport i RAN mbi “Shkaqet bazë të ekstremizmit të dhunshëm”*: Nuk ka një shkak apo synim shabllon për radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Në vend të kësaj, ka një sërë faktorësh në makronivele, mesonivele dhe mikronivele të analizës. Raporti i RAN ofron një përmbledhje të “shkaqeve bazë” të ekstremizmit të dhunshëm.

2.2.3 Përjetimi në arenën e luftimeve

Përjetimet e luftëtarëve të huaj terroristë janë të ndryshme, por jashtëzakonisht sfiduese për t’u trajtuar në disa nivele. Pasi rekrutët e rinj kanë kaluar në territorin e ISIS-it, ata përballen me kontrole të shumta sociale dhe sigurie që kufizojnë sjelljen e tyre, komunikimin dhe lirinë e lëvizjes. Rekrutët ndahen sipas gjinisë. Luftëtarët e huaj terroristë meshkuj i nënshtrohen regjistrimit dhe marrjes në pyetje ndërsa dorëzojnë edhe dokumentet e tyre të identitetit.

Të rekrutuarit e ISIS-it të gjithë marrin pjesë në **kurse të detyrueshme për sheriatin**. Kohëzgjatja e kursit varret nga vlerësimi i ISIS-it për besnikërinë e individit dhe vlerën e tij për grupin, por mund të zgjasë nga tri javë deri në tre muaj ose më shumë. Këto kurse zhvillohen paralelisht me **stërvitjen ushtarake**, përmbajtja e të cilës varet nga fakti nëse ka nevojë për luftëtarë të rinj apo nëse rekruti po stërvitet për një sulm vetëvrasës.

¹³ Motivimi humanitar ishte i fortë në fazën e hershme të konfliktit deri në 2014 kur u shpall “kalifati”. Ndërkohë që individët u tërhoqën fillimisht për të udhëtuar për arsye humanitare, disa të tjerë më vonë u tërhoqën nga ideologji dhe synime shkatërruese.

ISIS-i aplikon gjithashtu edhe **taktika shokuese**, si brenda dhe jashtë fushës së betejës. Një strategji qendrore është përdorimi i brutalitetit ekstrem, që përfshin prerje masive të kokave, ekzekutime në vend dhe tortura. Kjo frikëson popullatën dhe e bën të nënshtrohet duke bërë të mundur kontrollin e territoreve të okupuara. Nuk janë vetëm të rriturit që e përjetojnë këtë, por edhe fëmijët, disa prej të cilëve rekrutohen në kampe indoktrinimi dhe stërvitore që nga mosha nëntë vjeçare. Fëmijët e vegjël të ndikueshëm jo vetëm ekspozohen ndaj shkatërrimeve të luftës, por edhe ndaj akteve të panumërta të një mizorie të papërshtueshme, nga prerjet masive të kokave deri te rrahjet publike, prerjet e gjymtyrëve dhe kryqëzimet. Disa fëmijë shfrytëzohen në role luftuese ose si ekzekutues.

ISIS-i përdor gjithashtu fëmijët si sy dhe veshë – si informatorë – duke krijuar një mjedis jashtëzakonisht mosbesues. Kjo shkatërron lidhjet tradicionale të besnikërisë brenda fisit dhe familjes sepse akuzimet për shkelje të sheriatit përdoren si vegla në luftën e brendshme të ISIS-it dhe kundër të gjithë armiqve. Gjykatat e Sheriatit administrohen nga Divani i Gjykimit dhe Ankesave dhe japin gjykime fetare për çdo çështje. Burokracitë e konsiderueshme dhe dokumentacionet dhe dokumentet e hollësishme përbëjnë funksione për kontroll më të rreptë. Kontrolli i infrastrukturës, ushqimit, ujit dhe vendeve të punës përdoret si mjet kundër vendasve për t'i detyruar të bashkohen me ISIS-in. Divani i Sigurisë Publike përforcon sigurinë e brendshme dhe punën e kundër-inteligjencës. Udhëtimi jashtë kufijve të qytetit është i ndaluar pa leje dhe kërkon autorizim zyrtar.

Kur mbërrin në Siri, **gratë** janë të detyruara të jetojnë në fjetore për gratë e pamartuara të njohura si *maqar*. Burrat mund të zgjidhen, por ata më pas rregullisht dërgohen në vijën e frontit ose në misione. Nëse ai vdes, gruaja e tij vendoset në *shahada's maqar* (për të vejat).

Gratë duhet të sillen sipas një kodi të rreptë veshjeje në publik, duke veshur niqab dhe doreza. Divani *Hisbah* (policia morale) detyron këto kode për veshjet dhe rregulla strikte për udhëtimin. Nëse kapen duke shkelur kodin e veshjes, *Hisbah* mund t'i dërgojë një njoftim burrit të saj. Burri më pas duhet të shfaqet përpara një seance gjyqësore të sheriatit, ku do të vendosen ndëshkimet për të dhe gruan e tij, që variojnë nga gjobë deri në rrahje publike ose madje edhe vdekje.

2.2.4 Kthimi në Evropë

Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer arrijnë në Evropë përmes disa itinerareve:

- disa kërkojnë mbështetje konsullore, sidomos nëse kërkojnë pasaporta të reja ose me fëmijë të lindur në Siri ose Irak; disa udhëtojnë me dokumente identiteti të falsifikuar;
- disa kthehen përmes shmangieve përmes destinacioneve të tjera evropiane; disa udhëtojnë sërish pas direkt përmes Turqisë.
- disa më pas kapen nga autoritetet turke ose irakiane, ose nga forcat kurde;

Duke udhëtuar drejt destinacioneve evropiane, personat e kthyer mund të takohen në aeroport nga policia ose punonjës të sigurisë, të cilët i arrestojnë personat e kthyer ose, më e pakta, merren në pyetje për të vlerësuar nivelet e rrezikut, gjendjen emocionale të personit të kthyer si edhe gjendjen e përgjithshme të tij. Disa prej tyre kthehen pa e vënë re dhe ose raportojnë veten, ose raportohen nga anëtarët e familjes, autoritetet lokale ose specialistët. Disa mund të mbeten pa u vënë re. Nëse nuk akuzohen për shkelje që lidhen me terrorizmin, disa ende mund të përballen me ndjekje penale për mashtrim financiar ose mashtrim për përfitime sociale. Ky takim i parë shpesh mund të përdoret si pikë hyrjeje për hetime dhe ndërhyrje të mëtejshme. Është gjithashtu e dobishme të përdoren mjetet e vlerësimit të rrezikut ([shikoni kapitullin 3](#)) në këtë takim dhe në takime të mëtejshme.

Rrugët e kthimit




Figura 3, Kthimi në Evropë

Shërbimet e sigurisë dhe policia duhet t'i japin informacion, mundësisht përmes pikës së caktuar të kontaktit (shikoni kapitullin 4), ekipit përkatës lokal të koordinimit multi-agjenci të caktuar për rastin. Ky ekip do të përfshijë: koordinator ose përfaqësues të autoriteteve vendore, policinë lokale, shërbime profesionale të punës sociale / mbështetje për familjet, shërbime të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe një profesionist të shëndetit mendor. Në bazë të rastit, mund të përfshihet një profesionist i arsimit, një përfaqësues i burgut dhe/ose të shërbimit të provës, profesionistë të OJQ-ve (p.sh. punonjës ndihmës për daljen nga radikalizimi) ose anëtarë të komunitetit. Ata duhet të organizojnë takime rreth personave të kthyer ku secila agjenci individuale kërkohet që të japë kontribut dhe të shfaqë pikëpamjet e veta rreth personit të kthyer në fjalë, dhe se si duhet t'i afrohen atij ose asaj dhe të bien dakord me formën më të mirë të ndërhyrjes.

Ky ekip koordinimi multi-agjenci duhet të japë, deri në shkallën më të gjerë të mundshme, një pasqyrë 360 gradë të individit në fjalë, prindërve të tyre, fëmijëve, miqve, historinë dhe rrethanat aktuale. **The team should develop a tailored action plan for the returnee concerned** and clear instructions as to which agencies are in the lead to carry out meetings, risk assessments and dialogue with the returnee, their relatives, friends, and relevant stakeholders (shihni kapitullin 4).

Nëse personat e kthyer arrestohen, ndiqen penalisht dhe dënohen me burg (shihni kapitullin 5), ekipi lokal i bashkëpunimit multi-agjenci duhet të vlerësojë dhe të jetë në gjendje të zhvillojë takime të hershme me të burgosurin, si edhe me prindërit e tij/saj dhe bashkëshortin/bashkëshorten, për të krijuar një marrëdhënie personale dhe mundësisht një marrëdhënie pune. Kjo marrëdhënie duhet të përfshijë ndërhyrje risociali-

zimi të tilla si mentorimin, asistencën praktike në marrëdhëniet me autoritetet rreth strehimit, punësimit, kushteve të liritetit etj. ([shikoni kapitullin 6](#)).

Nëse personi i kthyer nuk ndiqet penalisht, është e rëndësishme që ekipi lokal i koordinimit multi-agjenci të krijojë procedura për menaxhimin e personit të kthyer dhe nevojave të mundshme. Është e rëndësishme që ekipi të organizojë **mentorimin dhe mbështetjen e familjes**. Këto ndërhyrje mund të shihen si barometra për mirëqenien e personit të kthyer. Ata ofrojnë mundësinë për të zhvilluar vlerësime rreziku të personave të kthyer dhe vlerësim të dinamikës së familjes. Në të njëjtën kohë ata ofrojnë mundësinë për të krijuar marrëdhënie besimi dhe pune me personin e kthyer dhe familjen e tij/saj ([shikoni kapitullin 6](#)).

Një çështje tjetër e rëndësishme është të vlerësohet mirëqenia e fëmijëve në këto familje dhe të mbrohen nga çdo rrezik, si p.sh. indoktrinimi ose detyrimi për të udhëtuar sërish në territoret e kontrolluara nga terroristët. Këto vlerësime të vështira duhet të kryhen nga profesionistë. Konsultimi i gjerë me personin e kthyer, plus familjen dhe miqtë është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm ([shikoni kapitullin 7](#)).

2.3 Profilet e ndryshme të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer

Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer kanë profile të ndryshme si edhe arsye të ndryshme për t'u kthyer. Ata që kanë udhëtuar për t'u bërë pjesë me ISIS-in ose Hayat Tahrir al-Sham (HTS) kanë luajtur role të ndryshme brenda organizatave, nga sulmues vetëvrasës të gatshëm dhe role të tjera dytësore.

2.3.1 Gjeneratat e ndryshme

Si hap i parë në përshtatjen e reagimeve ndaj disa grupeve të personave të kthyer, mund të jetë e dobishme që të konsiderohen dy breza, megjithëse nuk është e përshtatshme të bëhet diferencim strikt:

- Brezi i parë i të kthyerve, kryesisht burra dhe të motivuar të largoheshin për arsye humanitare dhe/ose për të luftuar kundër regjimit të Asadit ishin — me disa përjashtime të dukshme — më të prirur që të zhgënjehen, ndoshta më pak të dhunshëm dhe relativisht të lirë për t'u larguar nga territoret e kontrolluara nga terroristët;
- Brezi i dytë i të kthyerve, ai aktual, është më i kalitur në betejë dhe i përkushtuar ideologjikisht, i është dashur të shmangë mbikëqyrjen e lartë të ISIS-it për t'u arratisur dhe mund të jetë kthyer me motive të dhunshme: për të dëmtuar qytetarët e BE-së.

Duhet marrë në konsideratë edhe **fëmijët e kthyer**. Nga mosha nëntë vjeçare, disa kanë marrë trajnim ushtarak dhe ideologjik. Fëmijët e kthyer kanë përjetuar trauma lufte, kanë qenë dëshmitarë të ekzekutimeve dhe ndëshkimeve, dhe në disa raste janë detyruar të ekzekutojnë njerëz. Kjo është theksuar për shembull nga agjencia holandeze e inteligjencës AIVD në publikimin e tyre *Focus on Returnees*¹⁴ (2017) dhe *Life With Daesh: The Myth Unravelling*¹⁵ (2016).

Duke qenë se ISIS-i ka vendosur shumë barriera për luftëtarët e huaj terroristë që largohen (mbikëqyrje të rreptë dhe monitorim të komunikimeve, kërcënime për ekzekutim), autoritetet duhet të **vënë në dyshim qëllimet e personave të kthyer**, të hetojnë nëse ata kanë kryer krime (duke përfshirë ato jashtë vendit), dhe nëse kanë motive të mëtejshme që janë kthyer, si p.sh. të planifikojnë sulme brenda Evropës.

¹⁴ Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë (2017), *Focus on Returnees*. Marrë nga <https://english.aivd.nl/publications/publications/2017/02/15/publication-focus-on-returnees>.

¹⁵ Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë (2016), *Life with ISIS: the Myth Unravelling*. E disponueshme në <https://english.aivd.nl/publications/publications/2016/06/17/life-with-isis-the-myth-unravelling-available-in-arabic>.

Lexim i mëtejshëm: Center for Asymmetric Threat Studies (CATS) pranë Universitetit Suedez të Mbrojtjes

Ky studim ekzaminon një seri ndryshorësh të luftëtarëve të huaj nga Suedia që janë bashkuar me grupe terroriste xhihadiste në Siri dhe Irak mes qershorit 2018 dhe shtatorit 2016.

Publikimet e inteligjencës holandeze rreth ISIS-it

Ky *dokument* përshkruan jetën brenda të ashtuquajturit kalifat.

Në këtë *dokument* theksohen kërcënimet e mundshme që paraqesin personat e kthyer për shoqërinë.

2.3.2 Ndryshimet mes burrave, grave dhe fëmijëve

- **Personat e kthyer meshkuj:** Burrat në veçanti mund të jenë përfshirë në krime lufte si vrasje, përdhunim dhe skllavëri, dhe mund të kenë marrë pjesë në mizori terroriste ose ekstremiste të dhunshme. **Të gjithë kanë qenë dëshmitarë të dhunës ekstreme dhe kanë jetuar në kushte të pasigurta dhe të pasigurtshme.** Është gjithashtu e rëndësishme që të vihet re se zhgënjimi me një grup terrorist nuk do të thotë detyrimisht se ata distancohen nga një ideologji e dhunshme, dhe as nuk do të thotë se shpëputen nga kauza e xhihadit, kur kthehen në BE.
- **Personat e kthyer femra:** Disa analiza të grave që bashkohen me ISIS-in i përshkruajnë ato si viktimat¹⁶. Kjo perspektivë nuk lejon që të pranohen veprimet e këtyre grave dhe shpërfill faktin se **gratë perëndimore që janë bërë pjesë e grupeve xhihadiste, kanë tendencën të jenë shumë të motivuara nga ideologjia.** Për shumë gra, bashkimi me ISIS-in nxitet nga **ideale utopike**, dhe plotëson nevojën për **emocione dhe kuptim**. Propaganda e ISIS-it fokusohet në projektimin e një imazhi jete të idealizuar në Siri dhe Irak. Faktorë të tjerë që ndikojnë te largimi i grave nga Evropa drejt ISIS-it përfshijnë adoleshentet që bien në dashuri me imazhin e martesës me një “luftëtar” ose diskriminimin (të perceptuar ose të përjetuar). Shumë gra përpiqen që të themelojnë të ashtuquajturin kalifat sipas metodologjisë profetike, që në bazat e saj, në sistemin e bindjeve të tyre, është një sistem i plotë qeverisjeje. ISIS-i paraqet një imazh romantik të një shoqërie pa diskriminim në të cilën gratë lejohen të praktikojnë besimin e tyre. Botëkuptimi dialektik selafist-xhihadist i ISIS-it, që e ndan botën në të kundërta si pastërtia dhe papastërtia, fokusohet në refuzimin e dynjasë (botës materiale), që ndjekësit e dënon si të korruptuar dhe ndotëse.

Shumë gra janë bindur që të besojnë se bashkimi me ISIS-in do t’u japë atyre një sens **fuqizimi**. Disa e panë këtë si revoltë që mund t’i çlironte ato nga kufizimet dhe traditat prindërore, duke u dhënë mundësinë të gjenin identitetin e tyre, komunitetin e tyre dhe një sens përkatësie. Duke u bashkuar me ISIS-in, ato kanë menduar se do të ishin në gjendje të merrnin vendime të pavarura rreth jetës dhe të ardhmes së tyre, që do t’u lejonte të martoheshin jashtë kontrollit të familjes. ISIS-i e paraqet familjen si pikën qendrore, që garanton stabilitet për luftëtarët e huaj terroristë që udhëtojnë drejt frontit dhe ngre moralin brenda radhëve të luftëtarëve.

Revista e ISIS-it, Dabiq, i portretizon gratë si ato që lindin fëmijët dhe janë të domosdoshme për mbi jetesën afatgjatë të të ashtuquajturit Shtet Islamik. Përgjegjësia kryesore e grave është të rrisin fëmijët dhe t’i indoktrinojnë ata me vlerat bazë të të ashtuquajturit kalifat: djemtë duhet të sakrifikohen si martirë dhe vajzat duhet të ndjekin shembullin e nënës së tyre.

ISIS-i ka zhvilluar një burokraci të qartë të virtytit publik që përforcohet nga *Hisbaa* dhe gjykatat e sheriatit. Kjo nënkupton një listë të gjatë kodesh për veshjet dhe sjelljet e dënueshme. Për shembull, të gjitha gratë duhet të kenë një shoqërues mashkull për të dalë nga shtëpia. Gratë duhet të shoqërohen nga një *mahram*, që është një shoqërues mashkull që ka lidhje familjare, p.sh. vëllai ose babai, ose gra të tjera

¹⁶ Shikoni për shembull, Lakhani, S., Ahmadi, B. (2016), Women in Extremist Movements: Not Just Passive Victims, (U.S. Institute of Peace). Marrë nga <https://www.usip.org/blog/2016/11/women-extremist-movements-not-just-passive-victims>.

kur dalin jashtë ose kur udhëtojnë. Njësia *al-Khaansa* e përbërë vetëm nga gratë imponon virtytin publik, kryen ndëshkime dhe marrin pjesë në postblogoje për të kontrolluar gratë (për t'u siguruar që burrat nuk përdorin niqabin si maskim). Me këtë njësi janë bashkuar një numër grash perëndimore.

Rekrutimi i grave në ISIS zakonisht kryhet përmes medias sociale dhe gjatë aktiviteteve sociale si kujdesi për fëmijët, përgatitja e ushqimeve dhe pjesëmarrja në demonstrimet e aktivistëve.

Është gjithashtu e qartë se **gratë luajnë një rol aktiv në përhapjen e propagandës së ISIS-it** në median sociale për të tërhequr rekrute femra. Gratë në Siri janë vënë në dispozicion të të tjerave për këshilla rreth gjërave si p.sh. si të kryejnë hixhretin, si të paketojnë, sa para të sjellin me vete etj.

Femrat e kthyer shpesh kthehen në vendet e origjinës brenda BE-së për një arsye ose një kombinim të disa arsyeve: disa janë të zhgënjyera pasi përjetojnë vështirësi dhe shtypje, ose pasi burrat u vriten; të tjera kthehen për trajtim mjekësor dhe mbështetje nga familja. Në disa raste, për gratë janë paguar shuma parash dhe janë shpëtuar nga familjet e tyre. Disa janë kthyer për shkak të presionit të familjes.

Është e rëndësishme që të vihet re se ka mbështetëse të ISIS-it që mund të ushtrojnë presion mbi femrat e kthyer pasi ato kthehen në shtëpi.

- **Fëmijët e kthyer:** Fëmijët dhe minorenët e sjellë në Siri ose të lindur në familje që janë betuar për besnikëri ndaj Shtetit Islamik paraqesin një problem serioz dhe të veçantë. Një numër i konsiderueshëm fëmijësh janë çuar në Siri dhe Irak nga një ose të dy prindërit. Shumë të tjerë kanë lindur në familjet e luftëtarëve të huaj terroristë në terren. Ata që kanë lindur në zonat e luftimeve, rrezikojnë të jenë pa nënshtetësi sepse certifikatat e lindjes nga ISIS-i janë të pavlefshme. Është i rëndësishëm të përcaktohet atësia dhe mëmësia për t'u mundësuar fëmijëve të kthehen në Evropë.

Është shumë e vështirë të jepen shifra ekzakte të fëmijëve që jetojnë në territoret e kontrolluara nga ISIS-i në Siri dhe Irak. Shumë gra mbeten shpejt shtatzënë sepse mjetet kontraceptive janë të paligjshme dhe sepse ISIS-i dëshiron që familjet të kenë sa më shumë fëmijë të jetë e mundur. Për shembull, **koordinatori holandez i antiterrorizmit përlogarit se të paktën 80 fëmijë me lidhje holandeze jetojnë brenda territorit të kontrolluar nga ISIS-i në Siri dhe Irak.** Nga këta 80 fëmijë të njohur, 30% janë mes katër dhe tetë vjeç dhe rreth gjysma e tyre janë tre vjeç e poshtë. Sipas zyrtarëve francezë ka rreth 460 minorenë francezë në territorin e pretenduar nga ISIS-i, ku gjysma e tyre është nën pesë vjeç dhe një e treta kanë lindur atje. Zyrtarët belgë raportuan rreth 78 minorenë belgë në territorin e pretenduar nga ISIS-i.

Rekrutimi i fëmijëve në ISIS fillon zyrtarisht në moshën 9 vjeçare dhe vazhdon derisa arrijnë 15 vjeç. Fëmijët që 9 vjeç marrin pjesë në stërvitje me armë.¹⁷ Shumë prej këtyre fëmijëve rekrutohen përmes rrugëve të shumta, që variojnë nga indoktrinimi fetar në xhami dhe kampe, prindërit e tyre dhe nxitje financiare. Ky socializim i fëmijëve vazhdon përmes gjashtë fazave: “joshja, shkollimi, përzgjedhja, nënshtimi, specializimi dhe stacionimi”¹⁸. Këta *Ashbal al-Khilafah*, ose “këlyshët e Kalifatit” shpesh detyrohen të marrin pjesë në kampe ku i nënshtrohen indoktrinimit intensiv ideologjik, stërvitjes në aftësi luftarake (arte marcialë dhe vetëmbrojtje) dhe si të trajtojnë të burgosurit.

Rekrutët fëmijë të ISIS-it indoktrinohen për të treguar besnikëri absolute ndaj ISIS-it dhe përkushtim ndaj martirizimit si kauzën më të lartë. Kjo besnikëri rrënjësohet përmes udhëzimeve fetare dhe shikimit të videove të ISIS-it. Pasi socializohen në radhët e ISIS-it, ata kryejnë role të ndryshme: spiunë, predikues, rekrutues, ushtarë, ekzekutues, sulmues vetëvrasës. Mësuesit dhe zyrtarët e ISIS-it u kërkojnë fëmijëve të veprojnë si informues, të raportojnë çdo sjellje të dyshimtë të prindërve të tyre ose të të tjerëve që shkelin ligjet fetare ose që sugjerojnë kundërshtim ndaj rregullave të ISIS-it.

Vajzave shpesh u kërkohet të qëndrojnë në shtëpi me nënat e tyre që të rriten për të ndihmuar burrat e tyre të ardhshëm. Gjithashtu inkurajohet edukimi fetar. Sipas manifestit të ISIS-it “Gratë dhe Shteti Islamik: Ma-

¹⁷ Shërbimi i Përgjithshëm Holandez i Inteligjencës dhe Sigurisë (2017), Focus on Returnees. E disponueshme në <https://english.aivd.nl/publications/publications/2017/02/15/publication-focus-on-returnees>.

¹⁸ Horgan, J. G., Taylor, M., Winter, C., From Cubs to Lions: A Six Stage Model of Child Socialization into the Islamic State. *Studies in Conflict & Terrorism* (Volume 40, Issue 7, 2017).

nifesti dhe studimi i rastit”, vajzat mund të martohen në moshën nëntë vjeçare dhe maksimumi në moshën 16 ose 17 vjeçare. Ato nuk duhet të punojnë.

Fëmijët përdoren gjithashtu në përpjekjet e propagandës së ISIS-it: ISIS-i filmon dhe shpërndan video ekzekutimesh në të cilat fëmijët vrasin të burgosur në mënyra barbare. Përdorimi i fëmijëve nga grupi është jo vetëm taktik, por edhe strategjik në termat e shtetndërtimit dhe krijimit të një brezi të ri. Fëmijët inkurajohen të bashkohen si sulmues vetëvrasës, një rol i shpallur nga mësuesit e tyre si thirrja më e lartë për të rinjtë e devotshëm myslimanë.

Jashtë kampeve stërvitore, fëmijët mësohen në shkolla të administruara nga ISIS-i që kanë në programin mësimor vetëm edukim fetar. ISIS-i ka prodhuar një program mësimor në dy nivele: “Selafizimi [i islamit] dhe ISISizimi [i shoqërisë]”.¹⁹ Përmes këtij procesi, ISIS-i promovon vetëm atë që perceptohet si interpretimi më i pastër i islamit, duke u përqendruar njëkohësisht në përgatitjen e brezit të ardhshëm përmes fokusimit të “kalifatit”, shtetndërtimi, dhuna dhe apokalipsi.

Mirëqenia e fëmijës duhet të jetë prioriteti kryesor për reagimin multi-agjenci. Fëmijët janë jashtëzakonisht të ndikueshëm dhe të manipulueshëm. Ekspozimi ndaj niveleve ekstreme të dhunës krijon traumë dhe mund të bëjë që fëmijët të humbasin ndjeshmërinë ndaj brutalizimit dhe dhunës. Është një rrezik i madh imitimi i gjërave që bëjnë të rriturit. Kjo do t'i traumatizojë ata dhe do t'i çojë në probleme psikosociale dhe ndoshta rreziqe të mëdha sigurie për të ardhmen. Duke kuptuar shkallën e indoktrinimit, ekspozimi ndaj dhunës dhe kushtet e jetesës të përjetuara janë thelbësore në vlerësimin e këtyre fëmijëve.

Lexim i mëtejshëm: *Inside the Caliphate's Classroom: Textbooks, Guidance Literature and Indoctrination Methods of the Islamic State* nga Jacob Olidort: ky dokument përshkruan se si shkollohen fëmijët në të ashtuquajturin kalifat.

2.3.3 Motivet e ndryshme për kthimin

Ne mund të bëjmë dallim mes arsyeve dhe motiveve të ndryshme që qëndrojnë pas luftëtarëve të huaj terroristë që dëshirojnë të kthehen:

1. synime për të kryer sulme;
2. zhgënjim dhe pendesë — disa nuk i durojnë dot më kushtet e tmerrshme të jetesës, të tjerë nuk shohin asnjë mundësi për të qëndruar (për shkak të humbjes së pushtetit nga grupi terrorist të cilit i përkisnin)²⁰;
3. presioni dhe ndërhyrja e familjes;
4. arsye shëndetësore (p.sh. plagosje ose lindje);
5. kthim pas strehimit në Turqi;
6. kapje dhe ekstradim drejt BE-së.

2.4 Sfidat e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer

Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer janë një shqetësim i madh sigurie pikërisht për përvojën e tyre në fushëbetejë, stërvitjen në përdorimin e armëve dhe lidhjet me rrjetet ndërkombëtare terroriste. **Humbja e ndjeshmërisë ndaj përdorimit të dhunës, kombinuar me çrregullimin e stresit post-traumatik (PTSD)** që shpesh shoqëron përjetimet e luftimit dhe përfshirjen e mundshme në mizori si ato që publikon me krenari nga ISIS-i, rrit më tej kërcënimin e mundshëm që paraqitet nga të kthyerit.

Ky koktej faktorësh rreziku shumëfishohet përmes **poshtërimit, irritimit, brutalizimit, traumës dhe humbjes**. Efekti i kombinuar i kësaj mund të jetë radikalizimi i mëtejshëm, aftësitë luftuese dhe një prag më i ulët për dhunë dhe vrasje, si edhe një mentalitet luftues. Shumë luftëtarë të huaj terroristë vuajnë nga çrregullime

¹⁹ Olidort J. (2016), *Inside the Caliphate's Classroom: Textbooks, Guidance Literature and Indoctrination Methods of the Islamic State*, Policy Focus 147.

²⁰ Tri llojet e para të frymëzuara mbi tipologjinë të përdorura nga Z. Richard Barrett, Drejtor i Global Strategy Network.

psikologjike, që manifestohen në kontrollin e ulët të ngacmimit, probleme me menaxhimin e zemërimit, agresion dhe dhunë në marrëdhëniet sociale. Luftëtarët e huaj terroristë shpesh kthehen në mjediset e mëparshme radikale ose bandat kriminale, duke pasur një efekt negativ në dinamikën sociale.

Ka shumë **sfiga sigurie** dhe skenarë të mundshëm për luftëtarët e huaj terroristë që kthehen. Ata që arrijnë deri në Turqi ose në vendet fqinje të Sirisë/Irakut mund të kërkojnë ndihmë konsullore duke qenë se nuk kanë identifikim apo pasaportë dhe mjete financiare. Procedurat dhe planet e masave nevojiten sapo të kthyerit paraqiten jashtë vendit. Këto duhet të shoqërohen — [siç përshkruhet në paragrafin 2.2.4](#) — nga bashkëpunimi mes niveleve kombëtare dhe lokale. Fëmijët që kanë lindur pa regjistrim ose dokumente duhet të përpunohen dhe të koordinohen.

Sfidat për femrat e kthyer:

- përkushtimi i thellë ndaj idealit të “kalifatit” dhe ISIS-it;
- presioni social nga grupet e grave që mbështesin ISIS-in në atdhe;
- mundësia për t’u larguar nga shtëpia dhe realizimi i kësaj, sepse rregullat e ISIS-it synojnë t’i mbajnë gratë të mbyllura në shtëpi; shkelja e këtij rregulli nënkupton edhe shkeljen e tabusë së veçimit të gjinive;
- stigmatizimi brenda komunitetit;
- përballja me dhunën dhe lëvizjet kufizuese të dëshmuara/të përjetuara;
- çështjet e mbrojtjes së fëmijëve sepse edhe fëmijët mund të jenë radikalizuar.

Sfidat për fëmijët e kthyer:

- vërtetimi i atësisë dhe mëmësisë dhe kombësisë (ndoshta përmes testimit të ADN-së);
- problemet fizike dhe psikologjike;
- përballja me stresin dhe traumat ekstreme; efektet e të cilave mund të manifestohen përmes humbjes së të folurës, agresivitetit, frikës intensive dhe shenjave të çrregullimeve të stresit post-traumatik;
- përjetimi i luftës dhe nënshtrimi ndaj dhunës dhe ndëshkimeve si pjesë e jetës së përditshme;
- indoktrinimi (fëmijëve u mësohet në moshë të re se kushdo që nuk aplikon interpretimin e saktë dhe strikt të islamit është *kufar* (jobesimtar) dhe duhet vrarë
- përballja me pjesëmarrjen në ekzekutime;
- përballja me përfshirje të ndryshme në misione terroriste ose grumbullimi i informacioneve specifike në Perëndim dhe i inteligjencës të dobishme për ISIS-in;
- përjetimi i martesave të detyruara dhe abuzimit seksual;
- vuajtjet fizike përmes rrahjeve të mëparshme, torturës dhe përdhunimit;
- lëndimet e pësura përmes ndëshkimit ose luftimit;
- shpëputja nga prindërit e tyre — kampet stërvitore janë projektuar për të bërë këtë;
- vulnerabiliteti ndaj influencës nga sjellja dhe qëndrimi i prindërve;
- stigmatizimi si “terrorist” në shkollë;
- lidhjet e prishura faqefisnore dhe ndryshimi i linjave të besnikërisë, veçanërisht mes fëmijëve që kërkojnë përkatësi dhe identitet;
- mungesë familjarizimi me shoqërinë e BE-së dhe normat e saj.



3 Hetimi dhe vlerësimi i rrezikut

Ky kapitull paraqet një kuadër për kryerjen e vlerësimeve të kërcënimit dhe rrezikut të personave të kthyer. Ai është hartuar për të udhëzuar procesin e zhvillimit të mjeteve të përshtatshme që policia dhe ekipet e bashkëpunimit multi-agjenci mund të përdorin për të vlerësuar rreziqet e personave të kthyer dhe masave të ndërhyrjes. Kapitulli jep gjithashtu një përmbledhje të disa modeleve të vlerësimit të rrezikut për qëllime të ndryshme. Nuk është zhvilluar asnjë model specifik që fokusohet te luftëtarët e huaj terroristë. Çështje më e rëndësishme, ky manual ofron pikërisht këtë model, modelin RAN CoE Returnee 45.

Ekzistojnë **katër kërkesa paraprake** kur një person kthehet sërish në vendin e tij:

1. Personi i kthyer duhet të identifikohet dhe të merret në pyetje për informacione rreth udhëtimit të tij/saj, veprimeve dhe kthimit, si dhe për informacion rreth organizatës terroriste me të cilën është bashkuar.
2. Duhet të bëhet një vlerësim rreziku i kërcënimit që paraqet personi i kthyer për shoqërinë.
3. Në nivel kombëtar, një pikë kombëtare kontakti ose taskforce duhet gjithashtu të fillojë të përgatisë — në kontekstin multi-agjenci — ndërhyrjet e nevojshme për të minimizuar rrezikun kur personi i kthyer të kthehet në shoqëri ([shikoni kapitullin 4](#) për detaje). Ky person duhet të krijojë gjithashtu kontaktet me ekipin e bashkëpunimit multi-agjenci.
4. Bashkëpunimi lokal multi-agjenci duhet të fillojë të përgatisë një përjasje të koordinuar të përshtatur me rrethanat e personit të kthyer dhe rreziqeve që ai/ajo paraqet kur kthehet në qytetin e tij/saj.

Dy të parat adresohen në këtë kapitull — dy të fundit në [kapitullin 4](#).

3.1.1 Pas nisjes për në Siri / përgatitja e menjëhershme për kthimin

Në rastet kur individët kanë arritur të bashkohen me grupet terroriste jashtë vendit, është e rëndësishme që policia të fillojë të punojë me çështjen e tyre përpara se të kthehen.

Kjo ka tri arsye kryesore:

1. Ekziston një rrezik i konsiderueshëm që motrat ose vëllezërit dhe personat e përafërt të bëhen objektiv për t'u rekrutuar nga jashtë vendit. Parandalimi i rekrutimit zinxhir duke përdorur të njëjta rrjete leh-tësuese dhe financuese është shqetësim prioritar i policisë.
2. Në rastet ku familjet nuk ishin në dijeni të nisjes, ato kanë nevojë për këshillim të konsiderueshëm dhe mbështetje për të ndërtuar marrëdhënie të besuara me të afërmit e tyre dhe të tjerët që janë pranë luftëtarit të huaj me qëllim që të asistojnë në risocializimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer.
3. Krijimi i kontaktit me familjen do të japë informacione të çmuara rreth dinamikës dhe kontekstit të familjes. Ai do të japë gjithashtu një mundësi për grumbullimin e të dhënave në rrethanat e luftëtarit të huaj, që do të jenë me vlerë për të menaxhuar procesin e personit të kthyer. Shumica e personave të kthyer kthehen në mjedisin që ata njohin. Krijimi i marrëdhënieve brenda këtyre mjedisve dhe marrja e informacioneve rreth individëve të tjerë vulnerabël dhe mënyra se si personi i kthyer mund të influencojë në mjediset radikale do të jetë me vlerë. (Për më shumë rreth mbështetjes së familjeve shikoni kapitullin 4).

Pothuajse të gjitha përjasjet ndaj personave të kthyer në Evropë ndjekin të njëjtin proces. Ky proces është përmbledhur nga koordinatori holandez i antiterrorizmit dhe fleta e tij e fakteve [Përjasja gjithëpërfshirëse për të kthyerit](#) (figura 3). Përjasja është pak a shumë njësoj si ajo që po zhvillohet dhe përmirësohet për individët radikalë që duan të udhëtojnë ose që janë ndaluar të largohen drejt të ashtuquajturit kalifat. Kjo **përjasje investiguese e bazuar në inteligjencë bëhet vija e parë e reagimit**, duke filluar me një hetim penal dhe vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimit që paraqet personi i kthyer ndaj komunitetit dhe shoqërisë. Në rastet ku nuk ka ndjekje penale, çështja do të menaxhohet nga ekipi i bashkëpunimit multi-agjenci dhe do

të zhvillohet një përjasje individuale ndaj çështjes. Konstatimet nga Grupi i Punës i RAN Police (RAN POL) kanë theksuar se nuk nevojiten përjasje të reja radikale dhe institucione për trajtimin e personave të kthyer. Në vend të kësaj, objektivi duhet të jetë të imitohen përjasjet e suksesshme, të përshtaten ato dhe të përmirësohen.

Udhëtimi



Përtë penguar individët që të udhëtojnë përt'u bashkuar me një organizatë terroriste, autoritetet vendore e kombëtare dhe organizatat e tjera punojnë së bashku. Kur zbulojnë se dikush dëshiron të bashkohet me një organizatë terroriste, personi diskutohet në një ekip multidisiplinor menaxhimi të çështjes. Ky ekip përbëhet nga komuna, policia kombëtare, prokuroria dhe palë të tjera lokale dhe kombëtare. Ata diskutojnë dhe caktojnë ndërhyrjet sipas rastit. Shembuj të ndërhyrjeve janë: marrja e pasaportave, përdorimi i sistemeve ndërkombëtare të identifikimit të udhëtarëve, urdhër-arrestet evropiane ose masat e mbrojtjes së fëmijëve.

Kthimi



Të kthyerit zbulohen sa më shpejt të jetë e mundur për të minimizuar kërcënimin e tyre të mundshëm. Prokuroria dhe policia hetojnë udhëtarët e njohur xhihadistë. Ata mund t'i nënshtrohen gjithashtu edhe një hetimi inteligjence. Këto hetime mund të zbulojnë gjithashtu se dikush dëshiron të kthehet në Holandë ose në Evropë. Në nivel ndërkombëtar, shkëmbehet informacion për të zbuluar personat e kthyer në kohë. Nëse një person i kthyer zbulohet jashtë Holandës, ai ose ajo mund të shoqërohet në Holandë nga policia ushtarake.

Mbërritja



Çdo i kthyer arrestohet për t'u marrë në pyetje dhe për t'u ndjekur penalisht në bazë të hetimit penal. Gjithashtu, bëhet një vlerësim për kërcënimin që paraqet secili person i kthyer. Të kthyerit i nënshtrohen gjithashtu diskutimit në një ekip multidisiplinor menaxhimi të çështjes.

Përjasja individuale



Ekipi multidisiplinor i menaxhimit të çështjes vendos se cilat ndërhyrje përshtaten më mirë për të minimizuar kërcënimin e mundshëm nga personi i kthyer. Kryesore është të ketë një përjasje të personalizuar. Shembuj të ndërhyrjeve janë: ndjekja penale, urdhrat e ndalimit, programet e kujdesit ose një program deradikalizimi. Nëse një person dënohet dhe si rrjedhojë burgoset, ai ose ajo i nënshtrohet ekipit multidisiplinor të menaxhimit të çështjes gjatë dhe pas burgimit.

Autoritetet vazhdimisht grumbullojnë informacione për të ngritur një çështje penale kundër të kthyerve, që ata të

Hetimi penal



Figura 4: Përjasja holandeze për të kthyerit

3.1.2 Pikat specifike të veprimit për oficerët e policisë që merren me personat e kthyer

- Hapja e **dosjeve** për këdo që është larguar për në Siri. Kjo duhet të përfshijë ndjekjen dhe hetimin, si edhe parandalimin dhe opsionet e risocializimit.
- Përcaktimi i **një procesi për menaxhimin e çështjes** për të punuar me personat e kthyer përmes strukturate multi-agjenci. Dy procese ndodhin njëkohësisht: 1) ndjekja dhe hetimi; dhe 2) parandalimi dhe përfshirja me familjen.
- Krijimi i një procesi për menaxhimin e çështjeve për të punuar me personat e kthyer që janë me fëmijë, i cili mbështetet te bashkëpunimi multi-agjenci i aplikuar për çështjet e mbrojtjes së fëmijës dhe çështjet e abuzimeve me fëmijët. Ky menaxhim çështjeje trajton të gjithë familjen që është e rrezikuar.
- **Testoni protokollet e ndarjes së informacionit** në skenarët me personat e kthyer. Çfarë përmirësimesh nevojiten dhe çfarë opsionesh dhe burimesh janë të disponueshme? Konsideroni hartimin e manualit të shkurtër dhe të përshtatur për punën me personat e kthyer që merr në konsideratë proceset, procedurat dhe burimet.
- Konsideroni caktimin e një **specialisti të burimeve policore të disponueshëm 24 orë në ditë** rreth çështjeve të personave të kthyer dhe ekstremizmit që mund të konsultohen nga specialistët e vijës së parë.

- **Përfshihuni me luftëtarët e huaj terroristë** dhe familjet sapo dikush të largohet për në Siri/Irak. Oficerë policie specifike, si p.sh. oficerët e kontaktit me familjet dhe oficerë policie të besuar në komunitet duhet të vihen në dispozicion për konsultime rreth çështjeve policore. Familjet janë të dëshpëruara për të marrë informacion se çfarë ndodh, si mund t'i kthejnë fëmijët sërish dhe çfarë do të ndodhë saktësisht kur fëmijët/bashkëshortët e tyre të kthehen. Vizitat në shtëpi, së bashku me mbështetjen për familjen dhe shërbimet sociale, mund të jenë të dobishme. Është e rëndësishme që oficeri i policisë (ose dikush tjetër) të ketë personalitetin e duhur dhe aftësitë e duhura për krijimin e marrëdhënieve për këtë bashkëveprim. (Shikoni kapitullin 4 rreth mbështetjes së familjeve.)
- Në rastet kur familjet nuk kanë besim te policia dhe autoritetet e tjera, **përdorni teknikat influencuese** për të krijuar lidhje. Disa policë përdorin teknikat e negociimit për pengjet për të ndërguar marrëdhënie pune me individët që e urrejnë ose e kundërshtojnë policinë. Gjashtë parimet kryesore të Robert B. Caldini të influencës²¹ (konsistenca, reciprociteti, pëlqimi, prova sociale, autoriteti dhe pamjaftueshmëria) formojnë një përjasje të vërtetuar për afrimin dhe influencimin e të kthyerve dhe familjeve të tyre.
- Në rastet ku ka persona të kthyer me fëmijë, **konsultohuni me profesionistët specialistë të kujdesit shëndetësor** për të përgatitur trajtimin specialist për traumat dhe procedurat e duhura të vlerësimit. Mësimet e nxjerra nga fëmijët ushtarë, si edhe fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi ose abuzimit seksual, na tregojnë se në lidhje me trajtimin, na nevojiten ndërhyrje afatgjata të cilat ofrohen nga specialistët dhe jo policia. Roli i policisë është të përcaktojë se si të bëhet përfshirja me fëmijët që mund të kenë qenë dëshmitarë, viktimë ose autorë të krimeve. Ne mund të nxjerrim mësimet me vlerë nga përvoja e policisë në trajtimin e abuzimit të fëmijëve dhe dhunës në shtëpi. (Shikoni kapitullin 5 rreth fëmijëve.)
- Kontrolloni **gjurmën financiare** të personave të kthyer, duke përfshirë llogaritë bankare, borxhet dhe transfertat. Hetimet financiare rrisin të kuptuarit rreth marrëdhënieve brenda rrjeteve. Shumë luftëtarë të huaj kanë akumuluar borxhe dhe kanë transferuar fonde për t'ua çuar grupeve terroriste me të cilat janë bashkuar.

Praktika në veprim: Shembuj të policisë që përdor bisedat si ndërhyrje:

A Guide to Police Conversation Intervention: A dialogue promoting responsibility and positive change.
Drejtoria Kombëtare e Policisë e Norvegjisë, 2011

3.1.3 Personat e kthyer në tranzit dhe mbërritja në shtëpi

Luftëtarët e huaj që përpiqen të kthehen në Evropë përballen me pengesa të panumërta praktike. Udhëtimi nga Siria deri në Turqi ose Libi dhe më pas në Itali është i vështirë dhe i rrezikshëm. Kur rekrutët bashkohen me ISIS-in, për shembull, atyre u kërkohet të dorëzojnë pasaportat te organizata për arsye sigurie. Këto dokumente më pas shkatërrohen ose përdoren nga trafikantët e qenieve njerëzore për qëllime terroriste ose aktivitete të tjera të paligjshme.

Disa luftëtarë të huaj arrijnë me sukses të kthehen në BE pa u vënë re nga shërbimet e sigurisë. Më shpesh, luftëtarët e huaj të kthyer dhe familjet e tyre kontaktojnë konsullatën ose ambasadën për të kërkuar pasaporta të reja. Luftëtarë të tjerë ndalohen nga autoritetet kombëtare të cilat, pas marrjes në pyetje dhe hetimit, mund t'i udhëzojnë më pas ambasadat/konsullatat e huaja dhe të dorëzojnë personat e kthyer. Kjo u jep shërbimeve të inteligjencës dhe policisë mekanizma të paralajmërimit të hershëm, që i sinjalizojnë ata për personat e kthyer shumë kohë përpara se të kthehen në shtëpi. Këta skenarë të ndryshëm sjellin një mori sfidash të ndryshme konsullore:

²¹ Robert Caldini, *Influence: The Psychology of Persuasion* (Harper Business, 2006).

- verifikimin e identitetit të personave të kthyer;
- trajtimin e fëmijëve të lindur pa nënshtetësi dhe pa vërtetim të identitetit;
- sa praktik është transferimi i personave të kthyer dhe familjeve në vendin e tyre – a duhet të përdoren eskortë e armatosur ose masa të tjera sigurie?
- si dhe kur duhen intervistuar minorenët;
- ndarja e informacionit mes shërbimeve të inteligjencës dhe policisë, si edhe mes policisë dhe agjencive të tjera qeveritare — procedurat e hetimit dhe ndjekjes penale mund të pengojnë gatishmërinë për të ndarë informacionet se dikush po kthehet;
- nëse duhen njoftuar familjet dhe kur.

Disa Shtete anëtare të BE-së kanë **ekipe multi-disiplinore pranë ambasadave/konsullatave** në vendet e huaja ku të kthyerit mbërrijnë fillimisht kur janë në tranzit për të përpunuar çështjet praktike dhe për të filluar hetimet penale.

Sfida ose detyra e parë është **hetimi penal dhe analiza e kërcënimit në lidhje me sigurinë kombëtare**. Kjo duhet të trajtojë gjithashtu elemente të problemeve ose nevojave përkatëse fizike dhe psikologjike, si edhe probleme të ngjashme. Vlerësimi fillestar i rrezikut mund të bëhet nga shërbimet e sigurisë dhe inteligjencës dhe policia. Shumë shërbime të tilla dhe agjenci policore nuk e dinë vendndodhjen e luftëtarëve të huaj; arsyet e tyre për të shkuar në Siri ose Irak; me cilat organizata janë bashkuar; çfarë aktivitete kanë ndërmarrë; arsyet e kthimit; ku do të kthehen, ose kërcënimin e dhunshëm që paraqesin ndaj shoqërisë.

Zhvillimi i hetimeve penale dhe vlerësimit të rrezikut është një sipërmarrje komplekse dhe kërkon mjete hetimi multi-modale dhe modele të vlerësimit të rrezikut. Detyra kryesore për shërbimet e inteligjencës dhe policinë është të kryejnë hetime të kujdesshme dhe intervista me luftëtarët e huaj.

3.2 Mjetet e vlerësimit të rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm

Shumë pak mjete ekzistuese të vlerësimit të rrezikut specifike për terrorizmin e dhunshëm janë testuar ose janë verifikuar për efektshmërinë e tyre. Qeveri të ndryshme përdorin mjetet e vlerësimit të rrezikut të dhunës për shkelësit terroristë dhe ekstremistë në një mjedis burgu, ose si instrument diagnostikues për të kontrolluar individët e radikalizuar për rreziqet dhe nevojat. Ato bazohen në provat e nxjerra nga analizat e gjera në literaturën e terrorizmit.

Ekzistojnë tri modele bazë për vlerësimin e rrezikut:

1. Gjykimi profesionist që përfshin parashikimet e rrezikut bazuar vetëm në përvojën dhe njohuritë e profesionistëve për individin që po vlerësohet;
2. Mjetet llogaritëse bazuar në listat e treguesve të rrezikut, duke përdorur një formulë që rezulton në parashikim të përgjithshëm të rrezikut (p.sh. i lartë, i mesëm ose i ulët);
3. Gjykim i strukturuar profesionist (SPJ), që kombinon të dyja përqasjet (profesioniste dhe llogaritëse) për të drejtuar procesin sistematikisht, duke identifikuar rreziqet dhe duke vlerësuar individin në kontekst. Në këtë model SPJ, vlerësimi bazohet si në praninë ashtu dhe në rëndësinë e faktorëve të rrezikut për individin në fjalë.

Këto modele drejtojnë procesin multi-agjenci, krijojnë një kuptim të përbashkët mes agjencive qeveritare dhe ofrojnë tregues rreziku të përdorshëm për dhunën në të ardhmen.

Vlerësimet e rrezikut zakonisht kryhen nga profesionistë të trajnuar brenda policisë ose shërbimeve sociale. Jo të gjitha mjetet e vlerësimit të rrezikut kërkojnë trajnim formal. Ato shpesh përdoren si udhëzuese së bashku me informacionet e tjera përkatëse që grumbullohen nga intervistat me të kthyerit dhe familjet e tyre. Dallohen disa mjete të vlerësimit të rrezikut: ERG+22, IR46, VERA-2 dhe TRAP-18. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përdor ERG22+ në procesin e kontrollit të individëve të referuar në procesin Channel. Në mënyrë të ngjashme, edhe Violent Extremism Risk Assessment (VERA-2) përdoret gjerësisht nga shërbimet e burgut

dhe shërbimi i provës në disa vende. IR46 është një model holandez për vlerësimin e rrezikut i përdorur në kontekstin multi-agjenci nga Shtëpia e Sigurt Rajonale e Haaglanden (Veiligheidshuis). Terrorist Radicalization Assessment Protocol (TRAP-18) përdoret si kuadër hetimor dhe aplikon 8 sjellje paralajmëruese të afërta dhe 10 karakteristika të skajshme më afatgjata. Shikoni aneksin 1 për një përmbledhje të këtyre katër mjeteve të vlerësimit të rrezikut.

Këto katër mjete mund të ofrojnë udhëzime rreth zhvillimit të vlerësimit të rrezikut. Elementet e këtyre mund të modifikohen gjithashtu për t'u përdorur si mjete për vlerësimin e rrezikut për luftëtarët e huaj terroristë. Të gjitha mjetet e vlerësimit të rrezikut funksionojnë me listat e treguesve për faktorë si p.sh.: (i) bindjet dhe sjelljet, (ii) konteksti dhe qëllimi, (iii) historiku dhe aftësitë, (iv) përkushtimi dhe motivimi (v) rrethanat mbrojtëse. Treguesit paraqiten më poshtë si udhëzues për gjykimin profesionist.

Është e rëndësishme që të vihet re se çdo nevojë për vlerësimin e rrezikut duhet të bazohet në trekëndëzin dhe gjykimin nga disa burime. Është gjithashtu e rëndësishme që të vlerësohet aspekti gjinor dhe të përdoren gjykime të tjera profesionale rreth rolit të minorenëve. Mjetet e vlerësimit të rrezikut duhet të jenë një komponent i strategjisë të vlerësimit me shumë metoda që përfshijnë mjete specifike që do të përdoren në kontekstet multi-agjenci. Ato duhet të kombinohen me intervistat e policisë dhe burime të tjera të rëndësishme për të ofruar një tablo diagnostikuese ose më të plotë të individëve që paraqesin rrezik të mundshëm.

3.2.1 RAN CoE Returnee 45

Bazuar në përvojën me mjetet e lartpërmendura të vlerësimit të rrezikut, **ne kemi krijuar posaçërisht një mjet hetimor për rrezikun për përdorimin me personat e kthyer. RAN CoE Returnee 45** është një mjet hetimor që do të përdoret në lidhje me luftëtarët e huaj terroristë të kthyer për të ndihmuar organizimin e reflektimit dhe planifikimit operacional për ndërhyrjet e mundshme, si edhe për të reduktuar kërcënimin për dhunë. Është një kuadër për hetimin e përgjithshëm rreth motivimit, niveleve të angazhimit dhe faktorëve të tjerë të rrezikut në të gjithë procesin e luftëtarit të huaj terrorist – nga largimi deri te kthimi.

Një arsye kryesore për të zhvilluar RAN CoE Returnee 45 ishte se mjetet ekzistuese të vlerësimit të rrezikut nuk ishin bashkërenditur specifikisht sipas parametrave të luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer, por ishin fokusuar në vend të kësaj në vlerësimin e rrezikut në burgje (VERA), vlerësimet multi-agjenci (ERG22), ose ishin targetuar për “ujqërit e vetmuar” (TRAP-18). Ekzistojnë disa karakteristika që janë të përbashkëta për RAN CoE Returnee 45 dhe mjete të tjera, si edhe bazë e fortë provash për sjelljet e rrezikshme të ekstremistëve, por mjeti i ri merr në konsideratë gjithashtu sjellje specifike të rrezikut të pranishme në rastet e luftëtarëve të huaj terroristë, nga largimi i tyre deri te kthimi.

RAN CoE Returnee 45 ofron një **shabllon për reagimin multi-agjenci** për të organizuar të dhënat operacionale rreth personave të kthyer në mënyrë që fusha specifike të fokusimit të mund të identifikohen dhe të izolojnë gjatë planifikimit të ndërhyrjeve. Ai shërben si një listë kontrolli, që i lejon specialistit të ndërhyrjes të përmbledhë me shpejtësi nivelet e rrezikut në mënyrë që të mund të hetohet më tej një çështje e identifikuar. Si për të gjitha mjetet e vlerësimit të rrezikut ose të hetimit të rrezikut, është e rëndësishme që të theksohet se ky është vetëm një mjet në këtë proces, dhe se duhet të verifikohet me një gamë burimesh të tjera informacioni (si p.sh. intervista e policisë etj.). Mjeti i hetimit të rrezikut nuk është mjet parashikues, por më shumë një mënyrë për të raportuar dhe organizuar sjellje të rrezikshme që duhet të vlerësohen më tej nga profesionistët përkatës.

Çdo seksion përmban një sistem vlerësimi që ofron një tregues të sjelljeve specifike të rrezikshme të cilat kërkojnë vëmendje të mëtejshme. Vlerësuesi analizon se pse një individ ka arritur rezultat të lartë, të mesëm ose të ulët, dhe identifikon fushat që kanë nevojë për hetim të mëtejshëm. Mjeti shërben si bazë për diskutimin në kontekstet multi-agjenci, ku merren vendime mbi veprimet lehtësuese specifike, si edhe çdo veprim shtesë që nevojitet. Është e rëndësishme që të vërehet se këto sjellje të rrezikshme kundërbalancohen nga faktorë mbrojtës, si edhe faktorë të mbështetjes së familjeve dhe faktorë të tjerë stabiliteti. Faktorët mbrojtës duhen faktorizuar në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të personit të kthyer.



4 Marrëveshja multi-agjenci mbi ndërhyrjen

Ky kapitull mbulon masat paraprake 3 dhe 4 ([shikoni kapitullin 3](#)). Ai ofron një kuadër për zhvillimin e koordinimit multi-agjenci në nivele kombëtare, rajonale dhe lokale.

Përvoja nëpër Evropë tregon se **strukturat multi-agjenci dhe proceset e punës janë thelbësore për manovrimin e rasteve të luftëtarëve të huaj terroristë**. Identifikimi i hershëm dhe efikas i personave të kthyer, ndarja e përmirësuar e informacionit dhe vendimmarrja e përbashkët janë të mundura vetëm kur veprimet janë të koordinuara. Informacioni rreth një personi që është larguar për t'u bashkuar me një grup terrorist, duhet të ndahet me partnerët përkatës në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Kjo ndarje informacioni fiton rëndësi sapo ka sinjale që luftëtari i huaj terrorist po kthehet.

Kur personi i larguar kthehet, vlerësimet e inteligjencës dhe hetimet e policisë janë kërkesa paraprake për të përcaktuar reagimet e duhura në përputhje me rrethanat specifike të secilit rast. Reagimet mund të përfshijnë procedime gjyqësore, masa administrative ose masa risocializuese. Paralelisht me këtë është puna në nivel kombëtar dhe brenda ekipit lokal të koordinimit multi-agjenci. Ky ekip fokusohet në minimizimin e rreziqeve që paraqesin personat e kthyer ndaj shoqërisë duke koordinuar **strukturat holistike dhe procedurat e punës** për të përgatitur riintegrimin dhe risocializimin brenda shoqërisë kur nuk ka prova të mjaftueshme për të garantuar ndjekjen penale. Si alternativë, ekipi përgatitet për procesin eventual të lirit.

4.1 Koordinimi në nivel kombëtar

Në fillim, është thelbësore që të bëhet dallimi mes koordinimit në nivel kombëtar dhe përqasjes lokale multi-agjenci. Tutela për koordinimin në nivel kombëtar shtrihet te policia dhe përpjekjet e inteligjencës, vlerësimi i rrezikut për personin e kthyer dhe ndjekja e mundshme penale. Koordinimi në nivel kombëtar nevojitet gjithashtu për të krijuar përpjekjet për rehabilitim. Kjo është thelbësore për të minimizuar rrezikun që paraqet personi i kthyer për shoqërinë. Përpjekjet për rehabilitim përfshijnë trajtimin mjekësor ose shëndetësor — nëse nevojitet — ose ndjekjen e fëmijëve nga shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve.

Nëse një person i kthyer **lirohet ose nuk ndiqet penalisht**, ekipi lokal/rajonal multi-agjenci duhet të përfshihet ose të marrë përsipër (në varësi të ndarjes së përgjegjësisë brenda vendit) koordinimin e reagimeve ndaj këtij personi të kthyer dhe fokusimin mbi risocializimin dhe rehabilitimin në shoqëri. Specialistët që mbështesin personin e kthyer në kthimin e tij/saj konkret në shoqëri, në fund të fundit janë në nivel lokal.

Pika kyçe është të garantohet se ekziston **koordinim vertikal dhe horizontal mes niveleve kombëtare dhe lokale/ rajonale** nga momenti kur personi i kthyer hyn në Shtetin anëtar dhe agjencitë ose autoritetet të mos dublikojnë punën. Për të garantuar këtë, mund të krijohet një pikë kombëtare kontakti ose taskforce për personat e kthyer. Detyrat dhe madhësia, shkalla dhe tutela e kësaj pike kontakti ose taskforce varet nga numri i luftëtarëve të huaj terroristë që janë aktualisht në territoret e kontrolluara nga terroristët dhe numri i pritshëm i personave të kthyer. Nëse aplikohet, kjo pikë kontakti ose taskforce duhet të jetë pjesë e organit koordinues kombëtar për antiterrorizmin ose parandalimin e radikalizimit. Ata duhet të bashkëpunojnë gjithashtu ngushtë me shërbimet e inteligjencës, policinë kombëtare dhe shërbimet e prokurorisë. Duke ofruar koordinim të përgjithshëm të përpjekjeve, pika e kontaktit ose taskforca mund të ofronte një pikë të vetme kontakti për agjencitë qeveritare (lokale) që punojnë me luftëtarët e huaj terroristë të kthyer dhe u jep mundësinë atyre të monitorojnë sfidat, masat dhe rezultatet.

Pika kombëtare e kontaktit ose taskforca parashikohet që të kryejë tri detyra kryesore për koordinimin:

Detyra 1: Minimizimi i rrezikut për shoqërinë duke nisur menjëherë përpjekjet për riintegrim

Objektivi i përgjithshëm është **të minimizohen rreziqet ndaj shoqërisë që paraqesin personat e kthyer** duke koordinuar nisjen e rehabilitimit dhe riintegrimin të tyre (eventual) në shoqëri. Kjo nënkupton organizimin e çdo trajtimi të nevojshëm mjekësor dhe garantimin e kryerjes së kontrollit nga profesionistët e shëndetit

mendor. Nëse përfshihen fëmijë, pika kombëtare e kontaktit mund të përfshijë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve ose të marrë masa për kujdesin e birësimit nëse nevojitet.

Kontaktimi i **ekipit lokal/rajonat të koordinimit multi-agjenci brenda qytetit ku kthehet personi** për të garantuar një fluks të koordinuar informacioni nga niveli lokal/rajonat në nivelin kombëtar, do të ishte gjithashtu një prej përgjegjësi të pikës kombëtare të kontaktit ose taskforcës, së bashku me asistimin në nivel lokal/rajonat me përgatitjet për kthimin e luftëtarit të huaj terrorist. Pika kombëtare e kontaktit ose taskforca do të ndihmonin gjithashtu në hartimin e një politike kombëtare dhe strategjie komunikimi ([shikoni kapitullin 8](#)) rreth personave të kthyer dhe mund të ngarkohet me hartimin e një përmbledhjeje kombëtare të përpjekjeve dhe rezultateve për qëllime të krijimit të politikave.

Detyra 2: Pika e kontaktit për nivelin rajonal dhe lokal

Pika kombëtare e kontaktit ose taskforca do të ishte gjithashtu **pika e kontaktit për autoritetet rajonale ose lokale**. Detyra kryesore do të ishte të asistoheshin këto autoritete në punën me personat e kthyer. Është e rëndësishme që informacioni dhe asistenca të jenë të shpejta.

Detyrat dytësore:

- të krijohet një fluks i koordinuar informacioni nga niveli lokal/rajonat në nivelin kombëtar dhe anasjelltas, duke përfshirë komunat që punojnë me ose që përgatiten për kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë në komunitetin e tyre;
- të ofrohet asistencë dhe informacion rreth punës me personat e kthyer, duke përfshirë rreth shëndetit mendor, mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, punësimit, strehimit, komunikimit dhe dhënies së kontekstit të asaj që kanë përjetuar personat e kthyer;
- të vihen autoritetet lokale në kontakt me organizatat e tjera nëse nevojitet;
- të vihen autoritetet lokale në kontakt me autoritetet e tjera lokale që punojnë me personat e kthyer;
- të grumbullohet informacion rreth sfidave dhe rezultateve lokale.

Detyra 3: Lehtësimi i shkëmbimit brenda BE-së

Një detyrë tjetër e mundshme për pikën kombëtare të kontaktit ose taskforcën është **koordinimi me pikat kombëtare të kontaktit / taskforcat për të kthyerit në Shtetet e tjera anëtare të BE-së** për të shkëmbyer informacion rreth personave të kthyer dhe përvojave me ndjekjen penale dhe risocializimin. Kontakti do të lehtësonte/inkurajonte gjithashtu një shkëmbim të përvojave dhe praktikave të mira mes politikëbërësve kombëtarë, koordinatorëve lokalë dhe specialistëve të vijës së parë në vende të ndryshme.

4.2 Procesi multi-agjenci në nivel lokal ose rajonal

Funksionimi bazë i përqasjes lokale/rajonale multi-agjenci, duke përfshirë ndërhyrjet e strukturuar dhe koordinimin mes agjencive të ndryshme, si edhe parimet drejtuese për menaxhimin efikas të çështjeve, është diskutuar gjerësisht në dokumentin e mëparshëm të politikës të RAN CoE, *Zhvillimi i një kuadri lokal parandalues dhe i parimeve drejtuese* (shikoni më poshtë “Leximi i mëtejshëm”).

Shumë autoritete lokale nëpër Evropë nuk kanë aktualisht procedura të qarta për punën me personat e kthyer, dhe e kanë integruar çështjen e personave të kthyer brenda strukturave të zakonshme multi-agjenci. Duhet marrë në konsideratë një numër elementesh me personat e kthyer përmes bashkëpunimit lokal multi-agjenci.

Shtimi i elementeve të personave të kthyer në skenarët ekzistues

Strukturat e përcaktuara dhe bashkëpunimi mes autoriteteve lokale, policisë dhe partnerëve të tjerë statutorë (si p.sh. arsimi, shërbimet sociale, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet e të rinjve, dhe madje edhe shërbimet e menaxhimit të shkelësve) kanë nevojë të ekzistojnë paraprakisht që të hartohen procedura dhe protokolle për trajtimin e çështjeve specifike. Është e rëndësishme që të krijohen **marrëveshje të**

qarta rreth roleve dhe kufizimeve përkatëse për të gjitha palët e përfshira. Koordinimi efikas kërkon praktikim të skenarëve të ndryshëm të trajtimit të çështjeve, duke përfshirë ato që janë fokusuar veçanërisht te personat e kthyer. Këta skenarë duhet të përfshijnë gjithashtu sfida dhe zgjidhje të ndryshme për situatat dhe profilet e ndryshme të personave të kthyer (mashkull, femër, fëmijë dhe familje të tëra).

Lexim i mëtejshëm: *Dokumenti i politikës i RAN CoE, Zhvillimi i një kuadri lokal parandalues dhe i parimeve drejtuese*, fokusohet në mënyrën se si do të zhvillohet kuadri i nevojshëm dhe komponentët për parandalimin lokal të planeve të masave. Cilat janë sfidat e parimeve që përfshihen në këtë punë dhe cilat janë parimet drejtuese? Dokumenti bazohet në përvojën e gjerë praktike dhe njohuritë kolektive nga më shumë se 20 qytete nëpër Evropë.

Qyteti i Kopenhagës (Danimarkë) zhvilloi një *kuadër lokal* për parandalimin e radikalizimit. Përpyqja e Kopenhagës për antiradikalizim është pjesë e nismës Safe City, dhe menaxhohet në bashkëpunim të ngushtë me punën për parandalimin e krimit dhe krijimin e një ndjesie sigurie në qytet. Qyteti punon ngushtë me SSP (një bashkëpunim lokal mes klubeve rinore, shërbimeve sociale dhe policisë) dhe Policia e Kopenhagës në parandalimin e radikalizimit.

Protokolli i ndarjes së informacionit

Një problem madhor për bashkëpunimin multi-agjenci janë **barrierat ligjore për ndarjen e informacionit mbi individët**. Kjo e bën thelbësor angazhimin ndaj një Protokolli për ndarjen e informacionit (ISP) mes agjencive që marrin pjesë në strukturat e bashkëpunimit multi-agjenci. Një ISP qartëson barrierat ligjore për shkëmbimin e informacionit mes agjencive të ndryshme dhe thekson mënyrën se si do të diskutohen dhe trajtohen çështjet gjatë takimeve multi-agjenci. Ai lejon gjithashtu qartësimin mbi zinxhirin e mbrojtjes në procesin e fluksit të informacionit (si kalohet informacioni nga shërbimi i sigurisë te policia dhe më pas te agjencitë e tjera).

Pika lokale e kontaktit

Krijimi i një pike kontakti në shërbimet sociale lokale dhe agjencitë e tjera do të **ndërtojë konfidencën në mekanizmat e ndarjes së informacionit**. Shërbimet sociale shpesh ankohen se informacioni rreth personave të kthyer është i pjesshëm ose madje mungon. Është e rëndësishme që të merret informacion dhe inteligjencë nga të gjithë partnerët rreth individit, komunitetit dhe familjes përpara, gjatë dhe pas udhëtimit. Mos harroni të njoftoni partnerët rreth asaj që ka ndodhur me informacionin që ata ndanë.

Praktika në veprim: Qendra Daneze për Parandalimin e Ekstremizmit, që funksionon nëpër nivelet lokale dhe kombëtare dhe është zyrë qendrore për praktikën e mirë. Ajo ofron mbështetje të drejtpërdrejtë operacionale për komunat lokale që trajtojnë çështjet e personave të kthyer.

Mundësia për modele të ndryshme bashkëpunimi

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të garantuar bashkëpunimin kur ajo nevojitet. Në varësi të strukturës organizative dhe shkallës së problemit të personave të kthyer, koordinimi multi-agjenci në nivel lokal mund të jetë strukturë e përhershme ose e përkohshme.

- *Struktura multi-agjenci në nivel lokal/rajonale:* Përdorimi dhe përshtatja e një strukture ekzistuese për bashkëpunimin multi-agjenci është e rëndësishme për të garantuar bashkëpunimin, efektshmërinë dhe koordinimin. Puna me personat e kthyer zakonisht kryhet brenda proceseve ekzistuese multi-agjenci. Modeli danez i SSP përfshin bashkëpunimin e ngushtë mes shkollave, shërbimeve sociale dhe policisë dhe ka funksionuar për mbi katër dekada në mbështetje të parandalimit të krimit. Kjo lloj strukture ekziston gjithashtu në Holandë, në “Shtëpitë e sigurta”, që gjithashtu fokusohen te parandalimi i krimit.

- *Ekipet e ndërhyrjes për të asistuar në nivel lokal/rajonat*: Disa vende dhe rajone kanë krijuar ekipe speciale profesioniste multi-agjenci që mund të thirren për asistencë në nivel lokal ose rajonal në vend të strukturave multi-agjenci. Modeli finlandez Anchor është një qendër e tillë, ku profesionistët punojnë për parandalimin e krimit dhe ndërhyrjet për të luftuar ekstremizmin përmes veprimit të koordinuar dhe të targetuar. Modeli shtrihet te bashkëpunimi me një OJQ, që mbështet shkëputjen nga dhuna me motivim ideologjik përmes mentorimit.

Këshilla për bashkëpunimin multi-agjenci²²:

- **Praktikoni procedurat** dhe Protokollet për Ndarjen e Informacionit duke përdorur skenarë të ndryshëm për personat e kthyer dhe raste të jetës reale.
- Sapo të merret informacioni rreth një nisjeje, duhet të hapen dosje rreth individit; kjo do të ndihmojë ndjekjen dhe hetimin si edhe parandalimin dhe risocializimin.
- **Përcaktoni se kush (cila agjenci) merr rolin drejtues** si menaxhere e ekipit të çështjeve.
- Krijoni një ekip specifik bashkëpunimi multi-agjenci për personat e kthyer ose zhvilloni takime speciale për personat e kthyer me ekipin lokal/rajonat multi-agjenci.
- **Krijoni kontakt me të kthyerin dhe familjen e tij sa më shpejt të jetë e mundur** në proces. Kyç mbetet ndërtimi i një marrëdhënieje me të kthyerit dhe familjet e tyre. Shumica e familjeve kanë nevojë të kuptojnë situatën, si mund ta kthejnë fëmijën sërish dhe çfarë ndodh pasi fëmija kthehet sërish në vend. Përfshirja duhet të kryhet nga pjesëtarë policie me aftësinë dhe ekspertizën e duhur, si p.sh. oficerët e kontakteve me policinë ose një oficer i besuar policie në komunitet. Megjithatë ata identifikohen si policë, detyra e tyre kryesore është të mbështesin familjen në çështjet e policisë.

Praktika në veprim: Një njësi policie lokale ka krijuar një “Shtyllë Kundër Terrorizmit dhe Radikalizimit Ekstrem” të ekspertëve të policisë, që mund të konsultohen me kolegë që nuk janë familjarizuar plotësisht me ekstremizmin dhe të kthyerit. Një oficer “shtyllë” është i disponueshëm për konsultim 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Një manual i brendshëm për të gjithë oficerët përmban udhëzime për t’u ndjekur nëse një individ duket se është subjekt i radikalizimit dhe dëshiron të bashkohet me lëvizjet terroriste. Një prej kapitujve titullohet “Çfarë duhet të bëni kur një i kthyer shfaqet në radar”, dhe përcakton se kush duhet kontaktuar dhe çfarë duhet regjistruar në sistemet e policisë.

Praktika në veprim: Modeli Aarhus rrotullohet rreth Info House dhe takimeve të rregullta multi-agjenci që përfshijnë shërbimet sociale, shkollat dhe përfaqësuesit e policisë. Për çështje të tilla si luftëtarët e huaj terroristë të kthyer, Aarhus ka përcaktuar një plan masash për çështjen e Sirisë që përfshin grupe pune për formë të ndryshme ndërhyrjeje, si p.sh. kontrole dhe vlerësime të rreziqeve, mentorim, rrjete të familjeve, punë sociale dhe punësim.

- Garantoni **bashkëpunimin mes shërbimeve të asistencës sociale dhe policisë** përpara se t’i afroheni një familjeje që ka pasur një të afërm që është nisur ose është kthyer nga një zonë konflikti.
- Ndërttoni një **marrëdhënieje me familjen**, ose t’i kërkohet një agjencie tjetër ta bëjë këtë.
- Fokusohuni te **vëllezërit dhe motrat** dhe anëtarë të tjerë të familjes që mund të bëhen vulnerabël ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
- Fëmijët shihen pikësëpari dhe më së shumti si viktima. Por, ngjarjet në Siri dhe Irak kanë treguar se **fëmijët që në moshën nëntë vjeçare mund të përbëjnë rrezik**, qoftë në planin afatshkurtër ose afatgjatë. Nëse babai ose nëna e kthyer janë të arrestuar ose në burg, hyjnë në skenë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve. Fëmija duhet të vlerësohet nga një numër perspektivash, dhe mund të kalojnë muaj ose edhe vite përpara se të paraqiten sjelljet e rrezikshme.

²² Ky koleksion këshillash dhe mësimesh vjen nga specialistët brenda RAN.

- Siguroni akses të shpejtë dhe të specializuar te **specialistët e shëndetit mendor**. Danish Dignity Institute, që punon për riintegrimin e personave të kthyer, thekson trajtimin e hershëm; 90 % e personave të kthyer në Danimarkë kanë ardhur nga familje ku të paktën një prej prindërve është traumatizuar.
- Në shumicën e shteteve, me ndryshimet në legjislacion udhëtimi në Siri dhe Irak është subjekt i **ligjeve të kundërterrorizmit**. Personat e kthyer në këto vende për këtë arsye mund të mbahen nën arrest, dhe disave mund t'u jepet dënim me burg. Kjo është një dritare mundësie për t'u afruar këtyre individëve.
- Vlerësimi në nivel lokal nuk duhet të fokusohet vetëm te rreziqet. Ai ka për qëllim të mbështesë vlerësimin e rrezikut, por duhet të ndihmojë në krijimin e planeve të personalizuar për individët. Prandaj, pjesë të caktuara të vlerësimit mund të jetë më të orientuara drejt **kujdesit dhe risocializimit**.
- Ekipi multi-agjenci mund të ketë nevojë të krijojë/menaxhojë marrëdhëniet me **OJQ-të** në terren. Në shumicën e vendeve, programet e daljes nga radikalizimi zhvillohen nga OJQ-të; OJQ-të janë në një pozicion më të mirë për të ndërtuar besimin dhe kredibilitetin me personin e kthyer. Duke qenë se bashkëpunimi me policinë mund ta shkelë këtë besim, duhet të ketë marrëveshje dhe procese të qarta në lidhje me ndarjen e informacionit. Është thelbësore transparenca mes agjencive të përfshira dhe drejt personit të kthyer. Koordinimi i programit të risocializimit është përgjegjësi e komunës ose e organizatës së daljes. Policia mund të përfshihet nëse ka shqetësime rreth sigurisë, qoftë nga ana e tyre ose nga një prej agjencive të tjera që përfshihen.
- Krijoni **plane masash të individualizuara dhe të orientuara drejt proceseve** për të garantuar koordinimin, vazhdimësinë dhe ndjekjen e çdo rasti. Këto plane masash janë të personalizuar dhe theksojnë opsionet për mentorimin, asistencën psikologjike dhe të traumës, rrjetet dhe këshillimin prindëror dhe ndoshta edhe programe të daljes nga radikalizimi. Ato përfshijnë jo vetëm personin e kthyer, por edhe mbështetjen më të afërt sociale (pra, familjen).



5 Rruga me ndjekje penale

Ky kapitull fokusohet te strategjia e reagimit pasi personi i kthyer ndiqet penalisht dhe bëhet pjesë e procesit të burgut dhe/ose të shërbimit të provës.

5.1.1 Përmbledhje e përgjithshme dhe çështje

Në Shtetet anëtare të BE-së, do të zhvillohet një hetim, si rregull i përgjithshëm, për të gjithë personat e kthyer që dyshohet se jetojnë me/marrin pjesë në grupe dhe aktivitete terroriste jashtë vendit, për të parë nëse personi i kthyer duhet të ndiqet penalisht bazuar në aktivitetet penale. Kur personi i kthyer dihet se është kthyer, ose kur ai/ajo kontakton vullnetarisht me autoritetet, zakonisht ndodh arrestimi dhe marrja në pyetje. Bazuar në provat e disponueshme, do të merren hapa të mëtejshëm brenda sistemit të drejtësisë penale.

Ndryshimet mes shkelësve të kthyer dhe shkelësve të tjerë të dhunshëm ekstremistë/terroristë

Brenda sistemit të drejtësisë penale ka shumë lloje të ndryshme kriminelësh të dhunshëm ekstremistë/terroristë. Këto ndryshime bazohen në personalitetin, përvojën, motivimin, aftësinë, qëllimin, zhgënjimin ose bindjen në kauzën e ISIS-it, shenjat ose traumat apo rezistencën, kohëzgjatjen e qëndrimit jashtë vendit, si dhe provat e sjelljes kriminale. E njëjta gjë aplikohet për personat e kthyer.

Rrethanat në të cilat kanë jetuar personat jashtë vendit kanë tendencën të jenë më të vështira për t'u përcaktuar se sa për personat që jetojnë në një mjedis ekstremist vendas. Megjithatë ky i fundit mund të ketë efekt psikologjik, ata që jetojnë në një zonë lufte (veçanërisht për shkak të mizorive të kryera nga lëvizjet xhihadiste) kanë më shumë të ngjarë të vuajnë nga PTSD.

Brenda një grupi me persona të kthyer, ka ndryshime bazuar në **llojin e krimit të kryer**: planifikimi/ekzekutimi i një sulmi terrorist, udhëtimi drejt një zone terroriste, dhënia e ndihmës për një organizatë terroriste me burime, rekrutim, përhapje të propagandës etj. Jo të gjithë personat e kthyer janë (ende) ekstremistë të dhunshëm dhe ata mund të ndiqen penalisht për krime të tjera që nuk kanë lidhje me aktivitetet terroriste. Disa nuk kanë qenë asnjëherë ekstremistë, dhe kanë shkuar në zonën e luftës për arsye të tjera. Disa kanë humbur besimin tek ideologjia për shkak të përjetimit të tyre.

Disa specialistë thonë se brezi i parë i personave të kthyer (në ditët e para të ISIS-it) ishin më të lehtë për t'u trajtuar sesa radikalët e tjerë sepse shumë u kthyen të zhgënjyer me ideologjinë, organizatën terroriste dhe/ose rrethanat në të cilat u është dashur të jetojnë. Personat që kthen sot janë më të paepur në bindjet e tyre, janë të stërvitur dhe të përgatitur se si të veprojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve (zyrtare dhe jozyrtare).

Ndryshon gjithashtu nëse personat e kthyer kanë **"status" në burg**. Për disa të burgosur të tjerë, të qenit person i kthyer jep njëfarë statusi "heroi"; për të tjerët ka efektin e kundërt: ata mund të shihen si tradhtarë që kanë dezertuar nga ISIS-i. Ata gjithashtu mund të vihen nën shënjestër nga shkelës të tjerë për bindjet e tyre, për shembull nga ekstremistët e djathtë.

5.1.2 Sfidat specifike për personat e kthyer

Rritja e parashikuar në numrin e të kthyerve do të sjellë një numër sfidash për sistemin e drejtësisë penale. Megjithatë fokusi i këtij kapitulli është te këndvështrimi i burgut dhe i shërbimit të provës, ai thekson gjithashtu sfidat për sektorin juridik.

- **Mungesa e një profili të qartë të luftëtarit të huaj terrorist të kthyer brenda kontekstit të burgut dhe shërbimit të provës:** Ekziston aktualisht një zonë gri për ata që kanë pasur si qëllim të udhëtojnë si luftëtar i huaj terrorist dhe janë ndaluar përpara ose gjatë udhëtimit, dhe ata që në fakt kanë qenë në një zonë me konflikt terrorist. Në shumë vende evropiane, ata u nënshtrohen të njëjtës përjasje gjyqësore (ligjet që ndalojnë përgatitjen, përpjekjet për të udhëtuar ose për t'u përfshirë me grupe

terroriste si ISIS-i ose për t'u bërë pjesë e një prej këtyre grupeve). Ata që janë ndaluar vlen të konsiderohen si grup i veçantë, sepse dështimi për të arritur destinacionin e synuar mund të rrisë ndjesinë se po trajtohen në mënyrë të padrejtë në përëndim, ndërsa imazhi tërheqës i jetës me ISIS-in nuk sfidohet nga horrori dhe realiteti i luftës dhe i gjakderdhjes.

- **Vështirësitë në mbledhjen e provave:** Një sfidë specifike për ata që punojnë me luftëtarët e huaj terroristë dhe personat e kthyer krahasuar p.sh. me ekstremistët e djathtë në vend, është aksesimi i informacionit dhe provat që mbështesin ndjekjen penale. Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer ka shumë mundësi të jenë përfshirë në aktivitete terroriste jashtë BE-së, në zona me legjislacion të ndryshëm me akses të kufizuar në informacione (të besueshme) në terren.
- **Dënime më të shkurtra dhe lirim para kohe:** Një mungesë në prova mbështetëse mund të rezultojë në dënime më të shkurtra, që do të thotë se personat e kthyer do të kthehen shumë më shpejt në shoqëri. Për shkak të ndryshimit në llojin e akuzave dhe kohëzgjatjen e dënimit, mund të ketë një numër shumë të madh shkelësish që lirohen brenda një kohe të shkurtër. Kjo do të linte më pak kohë për rehabilitimin dhe deradikalizimin në burg. Përgatitja për lirin e tyre për këtë arsye kërkon planifikim të kujdesshëm dhe një përqasje multi-agjenci për t'u garantuar që personat e kthyer të liruar nuk do të kthehen në rrugët dhe rrjetet e vjetra, që mund të sjellë sërish shkelje.

Rast studimor — personi i kthyer i liruar para kohe

Person i kthyer mashkull, i kthyer në qytetin A në vitin 2015. Është burgosur për një kohë të shkurtër dhe është liruar para kohe. Ka diplomë dhe ka dëshmi penaliteti të pastër dhe riintegrimi shkoi mirë. Një grup personash të kthyer (kundër të cilëve ai ka dëshmuar) do të kenë të drejtë gjithashtu të lirohen së shpejti. Kjo shkakton shumë stres dhe ankth për personin e kthyer sepse mundësia që ai t'i hasë ata është shumë e lartë. Gjithashtu, kunata e tij (e martuar me vëllanë e tij, që ka vdekur në betejë) është përpjekur ta kontaktojë sepse dëshiron të kthehet. Megjithatë është shumë bashkëpunues me autoritetet dhe ka ndarë këtë informacion, ai ka ende frikë se disi do të lidhet sërish me Sirinë.

Mësimet e nxjerra:

- Në një qytet relativisht të vogël, është shumë e vështirë të zbatohen kushtet e lirit si p.sh. shmangia e kontaktit me persona të caktuar nga rrjeti i vjetër dhe/ose marrja pjesë në një program deradikalizimi, sepse rrjetet janë të përqendruara dhe burimet janë të pakta. Mund të konsiderohet edhe zhvendosja që individit të mundë të respektojë kushtet e lirit. Kjo duhet të peshohet kundrejt efekteve të mundshme negative të zhvendosjes.
- Rastet ndonjëherë janë të lidhura; kjo mund të hapë derën për më shumë informacion dhe për një tablo më të plotë.
- Nevojitet një procedurë e qartë për ndarjen e informacionit sepse rastet e lidhura mund të nënkuptojnë rrezik për profesionistët që punojnë me ta, si edhe personat që janë pranë personave të kthyer, nëse informacioni bie në duart e gabuara.

- **Legjislacioni dhe dënimi:** Me miratimin e Direktivës së BE-së për luftimin e terrorizmit, ekziston një detyrim për Shtetet anëtare të BE-së që ta shtrijnë kriminalizimin deri te aktet përgatitore të terrorizmit. Kjo mund të rezultojë në ndjekjen penale të një numri të shtuar personash për një gamë më të gjerë krimesh të ndryshme të lidhura me terrorizmin. Grupi i të dënuarve terroristë do të jetë kështu më i shumëllojshëm, që duhet të merret parasysh gjatë dënimit (gjatësisë dhe kushteve të dënimit) dhe burgimit (nivelit të sigurisë).
- **Opinion i publik rreth personave të kthyer:** Imazhi i personave të kthyer në shoqëri dhe presioni politik e bëjnë të vështirë që personeli dhe menaxhimi të marrin vendime që përfshijnë siguri dhe barazi (sa strikt duhet të jeni krahasuar me të burgosurit e tjerë?) dhe si perceptohet kjo nga personat e kthyer (neve na kushtohet më shumë kujdes se të tjerëve).

- **Personat e kthyer femra dhe ata të mitur:** Shumë pak juridiksione deri më tani kanë përvojë me gratë që kthehen nga një zonë konflikti dhe bëhen pjesë e sistemit penal. Është më e vështirë të dënohen gratë sepse shpesh nuk ka prova të mjaftueshme nëse janë përfshirë në luftime apo kanë ndihmuar në të vërtetë për të organizuar sulme. Pak raste deri më tani sugjerojnë se do të lindin sfida të reja në këtë fushë, për shembull mbi mënyrën e trajtimit të të burgosurave femra në njësitë terroriste. Fëmijët dhe të miturit paraqesin gjithashtu sfida të veçanta, të cilat do të adresohen me më shumë intensitet në kapitullin 5 rreth fëmijëve të kthyer.

5.2 Parimet drejtuese nga perspektiva e burgut

Parimet drejtuese për punën me personat e kthyer në një mjedis burgu janë të ngjashme me ato për punën me shkelësit ekstremistë të dhunshëm/terroristë në përgjithësi. Grupi i punës RAN mbi Burgun dhe Shërbimin e provës (RAN P&P) i ka dokumentuar këto gjerësisht në dokumentin e punës të RAN P&P. Konkluzionet kryesore në trajtimin e të gjitha llojeve të shkelësve ekstremistë të dhunshëm janë:

- siguria e shoqërisë garantohej më mirë përmes promovimit të mirëqenies dhe rehabilitimit të shkelësve;
- krimet e terrorizmit mbulojnë një gamë aktivitetesh; individët e dënuar për akte terroriste nuk përbëjnë të njëjtin rrezik për shoqërinë;
- shkelësit janë në gjendje të ndryshojnë pozitivisht dhe kanë nevojë për mbështetje për t'u shkëputur nga ekstremizmi i dhunshëm;
- të drejtat universale të njeriut duhet të respektohen në çdo moment dhe në të gjitha rrethanat;
- promovimi i marrëdhënieve pozitive mes personelit dhe të burgosurit dhe klima e shëndetshme në burg janë kusht paraprak për reduktimin e rreziqeve që lidhen me radikalizimin dhe kontributin për rehabilitimin dhe riintegrimin;
- bashkëpunimi multi-agjenci është thelbësor për parandalimin e radikalizimit dhe mbështetjen e proceseve të distancimit.

Lexim i mëtejshëm: *Dokumenti i punës i RAN P&P i vitit 2016* ofron një përmbledhje të të gjitha problemeve me të cilat haset personeli i burgut dhe i shërbimit të provës në lidhje me shkelësit ekstremistë të dhunshëm dhe të ndërhyrjeve të zhvilluara brenda BE-së si reagim. Parimet drejtuese shpjegohen në këtë dokument, i cili ofron udhëzime shtesë mbi tendencat, sfidat, metodat dhe ndërhyrjet që lidhen me kontekstin e burgut dhe shërbimit të provës.

Uebfaqja i këshillit të Evropës mbi Sanksionet dhe Masat në Burgje dhe Komunitet ofron një pamje të përgjithshme të standardeve që përmbajnë konventat e ndryshme, rekomandime, protokolle dhe dokumente udhëzuese në lidhje me sanksionet në burgje dhe komunitet.

5.3 Metodatat konkrete dhe modelet e ndërhyrjes në një mjedis burgu

Pasi një person i kthyer është dënuar me burg, ekzistojnë dy mënyra kryesore në të cilat burgjet mund të aplikojnë metoda dhe ndërhyrje konkrete:

- siguria dhe sigurimi (për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e të burgosurit, popullata e burgut, anëtarët e personelit dhe shoqëria më e gjerë – ky mund të shihet si sigurim afatshkurtër, gjatë burgosjes);
- rehabilitimi dhe riintegrimi (për të mbështetur të burgosurin në distancimin nga rruga ekstremiste e dhunshme dhe përgatitja e tij për të bërë edhe një herë në shoqëri një jetë pa krime. Kjo do të ofronte gjithashtu sigurim afatgjatë, pas burgosjes).

Procesi, koordinimi kohor dhe vendimmarrja për këto tri metoda dhe ndërhyrje do të ndryshojnë në çdo juridiksion, bazuar në kuadrin ligjor dhe vendimet specifike të gjykatave, vlerësimin e rrezikut që paraqet personi i kthyer, disponueshmërinë e profesionistëve për të ofruar ndërhyrje, disponueshmërinë e (vendeve në) sektorë të veçantë, si dhe rregulla dhe rregullore specifike në burg.

Përgjithësisht, personi i kthyer do të hyjë në burg sapo të arrestohet dhe të fillojnë përgatitjet për gjyqin. Në disa raste, personat e kthyer nuk është nevoja të qëndrojnë në burg gjatë fazës përpara gjyqit, por mund të qëndrojnë në shtëpi (ndoshta me monitorim elektronik). Vlerësimi i rrezikut do të fillojë gjatë kësaj faze, dhe do të kryhet nga personeli i shërbimit të provës, psikologët ose punonjësit socialë (në varësi të infrastrukturës që ekziston), dhe rezultatet në shumicën e rasteve do të paraqiten në gjyq. Nuk ka të ngjarë që të fillojnë ndërhyrje të tjera gjatë kësaj faze sepse personat e kthyer nuk duan të inkriminojnë veten — sepse duke treguar se p.sh. radikalizimi mund të ndikojë negativisht në gjyq (ata do të këshillohen gjithashtu nga avokatët të mos marrin pjesë).

Pasi të përfundojë gjyqi dhe të jetë dhënë vendimi (me burg ose punë në komunitet), personi i kthyer do të vendoset në vendin përkatës. Juridiksione të ndryshme kanë rregulla të ndryshme mbi mënyrën se si kryhet **vendosja në një burg ose sektor burgu të caktuar** dhe se kush i marr këto vendime (p.sh. gjykatësi, Ministri i Drejtësisë, drejtori i burgut).

Vlerësimi fillestar i rrezikut që është kryer përpara gjyqit do të krijojë bazën për punën e burgut me shkelësin. **Vlerësimet e rrezikut duhet gjithmonë të përsëriten me kalimin e kohës** për të vlerësuar nëse profili i rrezikut të shkelësit po ndryshon. Ky vlerësim do të njoftojë gjithashtu ndërhyrjet (për sigurinë dhe për rehabilitimin) që do të aplikohen. Vendimet mbi këto ndërhyrje shpesh do të bëhen në ekipet që përfshijnë profesionistët e ndryshëm, si p.sh. personeli i burgut, drejtori i burgut, psikologët, personeli i burgut nga programet e rehabilitimit, policia etj. në varësi të infrastrukturës specifike kombëtare dhe lokale.

5.3.1 Metodat e sigurisë dhe ndërhyrjet

Personat e kthyer mund të paraqesin sfida specifike nëse kanë qëndruar në një zonë lufte për njëfarë kohe dhe kanë aftësi të caktuara konflikti (p.sh. aftësi manipuluese, aftësi luftuese, përdorimin e objekteve të përditshme si armë) që mund të vënë të tjerët në rrezik. Nëse ata janë shumë të traumatizuar dhe/ose vuajnë nga pengesa dhe sëmundje të tjera mendore, ata gjithashtu mund të jenë rrezik për veten dhe të tjerët rrotull tyre.

Duke qenë se popullata e personave të kthyer brenda sistemeve të drejtësisë penale në Evropë është ende e vogël, **nuk janë zhvilluar masa specifike të sigurisë dhe sigurimit për këtë target-grup**. Megjithatë, gjatë viteve të fundit, janë kanalizuar shumë përpjekje për të hartuar masa specifike të sigurisë dhe sigurimit për shkelësit ekstremistë të dhunshëm dhe terroristë në përgjithësi. Këto masa do të kenë vlerë të shtuar për punën me personat e kthyer:

- **Monitorimi i specializuar dhe grumbullimi i informacionit:** mjete specifike të monitorimit dhe ndarjes së informacionit janë projektuar brenda sistemit të burgjeve dhe/ose në bashkëpunim me policinë, shërbimin e provës dhe shërbimet e inteligjencës për të monitoruar proceset e mundshme të radikalizimit në burg. Jo të gjithë ata që dyshohet se po radikalizohen janë dënuar për aktivitete të lidhura me terrorizmin. Në disa raste të personave të kthyer, mund të jetë e vështirë të vërtetohen aktivitetet terroriste, por mund të jetë e mundur që të ndiqen penalisht për sjellje të tjera kriminale. Është e rëndësishme që të monitorohet më gjerësisht brenda popullatës së burgut nëse po ndodh radikalizim, ose nëse rekrutuesit janë aktivë. Shërbimi i burgut dhe Ministria e Drejtësisë në Itali kanë zhvilluar një sistem të specializuar monitorimi të quajtur Dhoma e Situatës, që përshkruhet në dokumentin e referuar më poshtë.

Lexim i mëtejshëm: *Dokumenti aktual i RAN P&P mbi vizitën studimore në sistemin italian të vuajtjes së dënimit* ofron një përmbledhje të përqasjes italiane për të trajtuar radikalizimin në burg dhe shkelësit terroristë. Në të shpjegohen metodat e sigurisë dhe të mbledhjes së informacionit, si edhe përqasja e tyre ndaj rehabilitimit.

- **Vlerësimet e specializuara të rrezikut:** Në shumë sisteme të drejtësisë penale në Evropë, vlerësimet e rrezikut përdoren për të kuptuar rrezikun e shkelësit p.sh. për recidivizëm ose sjellje të dhunshme. Së fundi, janë zhvilluar vlerësime të reja të rrezikut që fokusohen në mënyrë specifike mbi përcaktimin e rrezikut të ekstremizmit. Këto vlerësime të specializuara zakonisht përdoren përveç vlerësimeve “të rregullta” të rrezikut që nuk fokusohen në aspektin ideologjik. Ato mund të informojnë nivelin e masave të sigurisë dhe sigurimit që do të merren, por edhe planin e personalizuar të rehabilitimit për një shkelës. Mjetet ERG dhe VERA-2 (shikoni aneksin 1.) janë të dyja specifike për vlerësimin e rrezikut. Sipas specialistëve të burgjeve, këto vlerësime rreziku janë përdorur gjithashtu te rastet e personave të kthyer në të cilat kanë rezultuar të dobishme.
- **Regjimet e specializuara:** termi “regjim” i referohet një seti masash specifike sigurie dhe sigurimi të ndjekur për shkelësit e dhunshëm ekstremistë/terroristë, si edhe zgjedhjen e regjimit: shpërndarjen e këtyre shkelësve brenda popullatës së burgjeve ose grupimin e tyre në sektorë të veçantë. **Në shumicën e Shteteve anëtare të BE-së ekziston tashmë një protokoll që tregon se në cilin regjim sigurie duhet të vendosen shkelësit e dënuar për krime të lidhura me terrorizmin.** Për shembull, ata mund të vendosen gjithmonë në një ambient të sigurisë të mesme deri të lartë. Ndonjëherë vendosja e tyre përcaktohet nga faktorë gjeografikë, duke i dhënë prioritet afërsisë me gjykatat që trajtojnë këto çështje. Gjatë dekadës së fundit, disa vende kanë zhvilluar gjithashtu sektorë të veçantë në të cilët shkelësit terroristë vendosen bashkë. Tani këto janë të pranishme në Belgjikë, Francë dhe Holandë dhe janë duke u zhvilluar në Mbretërinë e Bashkuar. Grupi i punës RAN P&P zhvilloi një përmbledhje të këtyre zgjedhjeve të regjimeve dhe avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Shkelësit ekstremistë të dhunshëm referohen si SHED:

Zgjedhja e regjimit	Avantazhet e mundshme	Disavantazhet e mundshme
Izolimi	– Monitorimi nga afër	– Krijimi i lidhjeve të reja dhe më të forta mes të burgosurve
	– Efekti i kufizuar të popullata e përgjithshme	– Mungesa e besimit mes personelit dhe të burgosurve
	– Ndërhyrjet e fokusuara	– Mentaliteti i ngulitur kundërshtues
	– Personeli i specializuar	– Përforcimi i perceptimeve rreth padrejtësive
	– Garantimi i sigurisë publike	– Efektet e etiketimit, stigmatizimi
		– Statusi shoqërohet me të qenit në një njësi të veçantë
		– Të gjithë SHED presupozohen se kanë rrezik të barabartë
		– Vështirësi në gjetjen e personelit
		– Kosto e lartë financiare
Shpërndarja	– Më pak stigmatizim dhe marginalizim	– Personel i përgjithshëm, kosto për trajnimin
	– Vendosja në një njësi të veçantë nuk sjell status	– Vështirësi në sigurimin e cilësisë së lartë të inteligjencës
	– Mundësi për influencë pozitive nga të tjerët	– Sfida në njohjen e të burgosurve dhe sigurisë dinamike
		– SHED mund të ushtrojnë influencë te të tjerët
		– SHED mund të influencohen nga bandat kriminale
Kombinimi	– Reagim i personalizuar për nevojat/rreziqet individuale	– Kriteret e përzgjedhjes/vlerësimi i rrezikut është i pasaktë

Kjo tabelë paraqet një përmbledhje. Përmbajtja shpjegohet me më shumë detaje në dokumentin e punës të vitit 2016 të RAN P&P.

Përvoja e specialistit: Personat e kthyer në sektorë të veçantë

Sektorët e veçantë në burgje kanë njëfarë përvoje me personat e kthyer. Deri më sot, kjo përvojë sugjeron se ata nuk kanë asnjë ndryshim nga llojet e terroristëve të tjerë në këta sektorë. Një psikologe që punon në një sektor të veçantë për terroristët vëren se ajo e ka të vështirë të krijojë kontakt real me shumicën e personave të kthyer. Ata duket se janë të stërvitur në “sjelljen model” ndaj autoriteteve, dhe nuk i zbulojnë mendimet dhe emocionet e tyre reale. Megjithatë sjellja model dhe e mirë vlerësohet nga anëtarët e personelit, ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për motivet e fshehura dhe nuk duhet të ulin vigjilencën.

Lexim i mëtejshëm: Ky [dokument aktual i RAN P&P mbi sektorin holandez terrorist të burgut në Vught](#) ofron një përmbledhje të përjasjes holandeze ndaj shkelësve terroristë në përgjithësi, si edhe një përshkrim më të detajuar të regjimit të veçantë në burgun në Vught. Ai përfshin vlerësimin e rrezikut, avantazhet dhe disavantazhet e pasjes së një sektori të veçantë, mënyrën se si vepron regjimi dhe se si është zhvilluar me kalimin e kohës, si edhe çështjet e personelit.

- **Personeli i specializuar:** Qoftë kur në sektorët e veçantë janë vendosur apo jo ekstremistë të dhunshëm / shkelës terroristë, shumë vende të BE-së po investojnë në trajnimin e personelit të specializuar për të punuar me këta lloj shkelësish. Megjithatë nuk kufizohet me personat e kthyer, ka disa aspekte të shkelësve ekstremistë që mund të krijojnë situata sfiduese për personelin. Ata mund të përpiqen të manipulojnë ose të rekrutojnë personelin dhe t'i joshin ata në mentalitetin e tyre ekstremist. Nga ana tjetër, ata mund të jenë shumë përbuzës për personelin sipas bindjes së tyre ideologjike se ata nuk janë “njerëz” (p.sh. duke i quajtur qen). Incidentet e fundit në të cilat shkelësit terroristë kanë sulmuar personelin e burgjeve kanë rritur gjithashtu nivelet e stresit për ata që punojnë me këta shkelës. Siç tregojnë studimet e sigurisë dinamike, marrëdhëniet e përditshme mes personelit dhe shkelësve janë thelbësore në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të siguruar në burg. Me rritjen e pritshme në burg të numrit të personave të kthyer, është i rëndësishëm investimi në trajnimin e personelit të specializuar.

5.3.2 Rehabilitimi dhe integrimi: metodat dhe ndërhyrjet

Kohëzgjatja e dënimit me burg të një personi të kthyer do të ndikojë te sasia e kohës që mund të investohet në rehabilitimin dhe integrimin në ambientin e burgut. Duke qenë se publiku i gjerë ka tendencën t'i konsiderojë personat e kthyer si individë që nuk e meritojnë ndihmën, mund të jetë **e vështirë që të sigurohen burime të mjaftueshme** dhe programe pavarësisht rrezeve që krijohen për mosofrimin e këtyre shërbimeve. Ndërhyrjet rehabilituese vijnë në forma të ndryshme, dhe shpjegohen me detaje më poshtë. Deri më sot, nuk ekziston asnjë program specifik integrimi apo rehabilitimi për personat e kthyer.

Parimet drejtuese të Grupit të punës të RAN P&P mbështesin **personalizimin e rehabilitimit për shkelësin**. Shumica e planeve të rehabilitimit janë një miks ndërhyrjesh, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe nevojave të shkelësit. Planet janë hartuar nga një ekip me profesionistë të ndryshëm (rojet e burgut, drejtori i burgut, psikologët, personeli që zbaton ndërhyrjet rehabilituese) dhe do të diskutohen me shkelësin. Nëse pjesëmarrja në ndërhyrje është vullnetare ose e detyrueshme varet nga kushtet e dënimit dhe politikat e burgut. Në përgjithësi, specialistët besojnë se pjesëmarrja vullnetare do të sjellë rezultate më të mira sepse ka një motivim të brendshëm për të marrë pjesë.

Marrja në konsideratë e **nevojave dhe dëshirave të shprehura nga shkelësi** është gjithashtu thelbësore për planin e rehabilitimit. Nëse ata dëshirojnë, p.sh. të mësojnë një gjuhë të huaj ose një zanat specifik, është e dobishme që të shikohet nëse kjo mund të integrohet brenda planit të rehabilitimit sepse do të ndihmojë në krijimin e bashkëpunimit me shkelësin dhe do të garantojë që të ketë një fokus në të ardhmen.

Rasti studimor — rehabilitimi i personit të kthyer në burg

Person i kthyer mashkull i moshës 25-28 vjeçare, udhëtoi drejt Sirisë pas shpalljes së të ashtuquajturit “kalifat”. Ai vinte nga një familje e shtresës së mesme, kishte punë me pagë të mirë dhe kishte nivel të mirë arsimor. Ai qëndroi në Siri për tre muaj. Nuk ka prova të qarta për përfshirjen e tij në luftime. Ai arriti të kthehej duke thënë se do të merrte gruan e tij në kufirin me Turqinë. Por, disa muaj pas kthimit ai u arrestua dhe arrestimi i tij tërhoqi shumë vëmendjen e medias. Ai është ende në burg në këtë moment (pranverë 2017) dhe është në kontakt me një OJQ që ofron ndihmë. Duke qenë në burg dhe i izoluar për orë të tëra e bën atë të paqëndrueshëm dhe ndonjëherë refuzon kontaktin. Ai ka gjithashtu një mungesë të fortë besimi te sistemi dhe prandaj ngurron të marrë këshilla nga ata që përpiqen ta ndihmojnë atë. Influenca e politikës dhe e medias e rrit këtë mungesë besimi dhe e bën më të vështirë që të krijohet një marrëdhënie e besuar te besimi.

Mësimet e nxjerra:

- Personeli i OJQ-së duhet të përdorë emrat dhe biografitë e veta për të treguar autenticitet — duke vepruar kështu në këtë rast rritet konfidenca e personit të kthyer te sinjeriteti i OJQ-së.
- Këmbëngulja ndonjëherë sjell fryte. Në këtë rast, OJQ-ja mbajti kontakt edhe kur i burgosuri refuzonte t’i kontaktonte. Kjo bëri që personi i kthyer të ndihej i vlerësuar.
- Mund të jetë e dobishme që të mos bëhen pyetje direkte rreth qëndrimit të tij në Siri, por duke treguar interes kur hapet tema. OJQ-ja e përfshirë në këtë rast asnjëherë nuk e nxiti këtë bisedë.
- Paragjykimi dhe anësitë mund të shmangen duke mos lexuar dosjet dhe raportet e medias përpara takimit me individin.
- Është e dobishme që të garantohen kontakte të mira me administratën e burgut dhe autoritete të tjera.

Programet e daljes nga radikalizimi

Ky emër kolektiv u referohet programeve dhe ndërhyrjeve që synojnë shkëputjen dhe/ose deradikalizimin e shkelësve të dhunshëm ekstremistë/terroristë. Siç tregohet nga Grupi i punës së RAN EXIT në dokumentin e tyre aktual mbi “Kërkesat minimale metodologjike për ndërhyrjet e daljes”:

“Deradikalizimi është një term i zakonshëm në debatin publik, por nuk përqafohet gjithmonë nga shumica e personave që punojnë me të. Termi nuk reflekton gjithçka që përfshihet te personat që largohen nga një mjedis ekstremist dhe/ose që ndryshojnë mënyrën e tyre të të menduarit. Përveç ndryshimit të mentalitetit dhe të të menduarit, ky proces kërkon gjithashtu ndryshime të sjelljes (si largim nga dhuna) dhe ndryshime praktike (si puna, strehimi dhe shkolla). Shkëputja është termi që përdoret për këto ndryshime. “Dalja” kombinon deradikalizimin dhe shkëputjen. Terma të tjerë i referohen më shumë objektivit të një procesi, si p.sh. “rehabilitim” ose “risocializim”.

Në praktikë, **programet dhe planet e përshtatura të rehabilitimit për personat e kthyer përfshijnë elemente të deradikalizimit dhe të shkëputjes.** Se si duket plani i rehabilitimit varet shumë nga vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave që bëhet nga profesionistët brenda sistemit të vuajtjes së dënimit, disponueshmëria e ndërhyrjeve dhe gatishmëria ose detyrimi i shkelësit për të marrë pjesë në to.

- **Ofrimi i ndërhyrjeve të rregullta:** Çdo sistem burgu ka në zbatim ndërhyrje standarde për të mbështetur rehabilitimin e të burgosurve. Këto përfshijnë aksesin në punë, aktivitete të kohës së lirë dhe arsim. Këto lloje aktivitesh do të ndihmojnë që të burgosurit të përgatiten për lirin dhe riintegrimin në shoqëri. Siç ka shumë të ngjarë se shumica e personave të kthyer do të kthehen në shoqëri (ndonjëherë edhe brenda një ose dy muajve/viteve), është e rëndësishme që të vihen në dispozicionin e tyre këto aktivite-

te të rregullta. Ato mund të kenë gjithashtu një efekt normalizues pas përvojave të tyre të jetesës në një zonë konflikti. Këto aktivitete në vetvete mund të kenë efekt shkëputës dhe deradikalizues.

- **Puna në dimensionin ideologjik:** Nëse personat e kthyer të burgosur ruajnë apo jo një mentalitet të ideologjisë ekstremiste, varet pikësisht nga motivimet e tyre dhe faktorët nxitës për t'u bërë luftëtarë të huaj — dhe përvojat e tyre dhe ekspozimi ndaj këtij dimensionit gjatë qëndrimit të tyre me një grup terrorist. Vlerësimi fillestar është i nevojshëm për të përcaktuar shkallën e nevojshme të ndërhyrjes rehabilituese që synohet për të influencuar mentalitetin e personit të kthyer, ose nëse ndërhyrjet e tjera do të jenë më të përshtatshme për rreziqet dhe nevojat e personit të kthyer. Nëse vlerësimi tregon një nevojë për ndërhyrje në nivel ideologjik, ekzistojnë një numër formash në të cilat mund të bëhet kjo ndërhyrje:
 - **Këshillimi individualisht:** Në këto seanca, një profesionist me ekspertizë në ideologjinë, teologjinë, ekstremizmin ose fusha të ngjashme, do të flasë me personin e kthyer. Objektivi është të “hapet” botëkuptimi i personit të kthyer për këndvështrime dhe interpretime të ndryshme përmes bisedave. Disa vende kanë caktuar “ekspertë radikalizimi” specialë për të zhvilluar këtë lloj këshillimi. Rekomandohet pjesëmarrja vullnetare në këto seanca këshillimi; seancat krijojnë gjithashtu një hapësirë të sigurt për të ndarë mendimet dhe emocionet.
 - **Seanca dialogu në grup:** si mjet për të reflektuar situatat e jetës reale (në të cilat personat jetojnë shpesh mes të tjerëve) dhe për të përdorur ndryshimet në pikëpamje dhe opinione, seancat e dialogut në grup mund të jenë mjet efikas në aktivizimin e emocioneve dhe një proces mendimi mbi botëkuptimin. Është më mirë të kombinohet një përjasje në grup me një përjasje individuale. Duhet kushtuar konsideratë e kujdesshme:
 - kush mund të jetë pjesë e grupit (është e nevojshme përzgjedhja e kujdesshme, është më mirë që të mos vendosen bashkë shkelës që janë së bashku brenda burgut, është e dobishme që të ketë profile diverse);
 - një përjasje vullnetare ose e detyrueshme (rekomandohet vullnetare);
 - kush do ta drejtojë grupin (ky duhet të jetë dikush me përvojë mbi temën dhe me përvojë në dinamikën e grupit);
 - dinamika e grupit dhe krijimi i një hapësire të sigurt (për të garantuar që të mos ketë frikësim/bullizëm që shqetëson procesin e mësimi).
 - **Edukimi dhe reflektimi:** ekzistojnë disa mënyra sipas të cilave personi i kthyer mund reflektojë vetë rreth bindjeve dhe botëkuptimit. Ofrimi i një koleksioni divers librash, revistash dhe dokumentarësh që tregojnë një shumëllojshmëri perspektivash rreth p.sh. politikës së jashtme, standardeve të dyfishta dhe diskriminimit, mund të nxisë personat e kthyer të burgosur që të edukohen dhe të reflektojnë, veçanërisht gjatë orarit që kalojnë në qelinë e tyre.

Praktika në veprim: seancat e dialogut në grup

Organizata gjermane Rrjeti i Parandalimit të Dhunës ka krijuar programe trajnimi në grup të quajtura: Marrja e përgjegjësisë – Ndarja nga urrejtja dhe dhuna – Edukimi i përgjegjësisë. Ata punojnë veçanërisht me shkelësit e rinj ekstremistë. [Zbuloni më shumë informacion dhe të dhëna kontakti në Koleksionin e RAN.](#)

- **Ofrimi i mbështetjes fetare dhe shpirtërore:** Nga natyra, burgjet janë një kontekst në të cilin shumë shkelës në një pikë të caktuar e ndiejnë nevojën për udhëzim shpirtëror ose fetar. Një gamë faktorësh mund ta nxisin këtë nevojë: dëshira për të vazhduar praktikimin e një feje, për të marrë udhëzim dhe një kuptim për jetën, për të gjetur qetësi dhe paqe për mendjen, për të ndihmuar në rindërtimin e vetëbesimit, për të mbështetur ndryshimin e sjelljes, për të fituar mbrojtje nga grupe të caktuara, për të pasur mundësinë që të takohen me anëtarë të seksit të kundërt, për të fituar akses të lirë në burimet e veçanta etj. Është e rëndësishme që të kuptohet kjo shumëllojshmëri motivimesh sepse këto duhet të perceptohen si “normale” dhe jo direkt alarmuese në lidhje me ideologjinë ekstremiste fetare.

Praktika tregon se disa persona të kthyer të burgosur praktikojnë dhe janë të interesuar në fenë e tyre. Ofrimi i një **kujdesi fetar të përshtatshëm** përmes punonjësve fetarë të burgut (në këto raste shpesh janë imamë, por edhe figura nga fetë e tjera), do të ndihmojë në vjeljen e efekteve pozitive të një stili jetese fetare dhe do të ndihmojë që të burgosurit të largohen nga ideologjia ekstremiste duke diskutuar perspektiva dhe interpretime të ndryshme fetare.

Duke ofruar këtë kujdes, është e rëndësishme që punonjësit fetarë të jenë të kontrolluar dhe të trajnuar mirë për të punuar në ambientin e burgut. E njëjta vlen edhe për materialet fetare dhe burimet që ofrohen në ambientin e burgut. Vlen që të nënvizohet se **punonjësit fetarë duhet të jenë në gjendje të punojnë në një ambient konfidencial** (gjithashtu për të mbetur legjitimë edhe në sytë e të burgosurve) **dhe nuk duhet t'u ngarkohen automatikisht objektivat e deradikalizimit** (sepse për këtë do t'u duhej një trajnim i veçantë).

Lexim i mëtejshëm: Organizata Evropiane e Burgjeve dhe e Shërbimeve të Vuajtjes së Dënimit (EuroPris) ka një grup ekspertësh mbi radikalizimin në burgje që ka zhvilluar një [raport mbi punonjësit fetarë të burgjeve dhe deradikalizimin](#).

- **Rilidhja me familjen dhe mjedisin shoqëror:** Një karakteristikë kyçe e grupeve ekstremiste dhe terroriste është synimi i tyre për të izoluar personat vulnerabël nga mjedisi i tyre normal shoqëror që të mund t'i influencojnë dhe t'i rekrutojnë ata. Në shumë raste, rikthimi i marrëdhënieve pozitive me familjen dhe rrjetin social është një hap i rëndësishëm në rehabilitim. Kjo siguron gjithashtu një rrjet të sigurt pas liritimit nga burgu. Megjithatë, në disa raste rrjeti shoqëror dhe familja nuk kanë ndikim pozitiv ose mund të komplotojnë me shkelësin gjatë kohës që ai/ajo është në burg. Prandaj, është i nevojshëm një vlerësim i kujdesshëm përpara përfshirjes së familjes dhe rrjetit shoqëror në ndërhyrjet e rehabilitimit.
- Në disa raste, familja ndihet e turpëruar dhe e stigmatizuar nga lidhja e të afërmit të tyre me një grup terrorist dhe nuk duan që të jenë në kontakt. Nëse ndodh kështu, duhet kohë që të rindërtohen marrëdhëniet dhe besimi. Procesi i rilidhjes me familjen mund të rezultojë i vështirë kur bëhet fjalë për persona të konvertuar që janë bërë luftëtarë të huaj terroristë dhe janë kthyer. Në këto raste, familja dhe kontaktet shoqërore zakonisht nuk janë në gjendje të kuptojnë se pse anëtar i familjes u konvertua dhe nuk janë të sigurt se si të veprojnë me këtë gjë. Ndërsa afrohet data e liritimit, është e rëndësishme që të ketë një rrjet të sigurt për të shmangur kthimin sërish të shkelësit në rrugët e vjetra ose rekrutimin për së dyti menjëherë pas liritimit.

Praktika në veprim: Konferenca austriake e rrjetit shoqëror

Konferenca austriake e rrjetit shoqëror është një eksperiment interesant dhe shembull i përfshirjes së familjes dhe rrjetit shoqëror në përgatitjet për lirim të një shkelësi terrorist.

Për më shumë informacion, kontaktoni me [Neustart](#), shërbimin austriak të provës.

Rasti studimor — Përfshirja e familjes në rehabilitimin e personit të kthyer

Një djalosh i ri, udhëtoi drejt Sirisë për herë të parë në vitin 2012. Ai ishte atje për gjashtë javë dhe më pas u kthye. Gjatë vitit 2013 ai udhëtoi dy herë drejt Sirisë, duke kaluar gjashtë muaj atje secilën herë. Ai dyshohej se luftonte për grupin Jabhat al-Nusra të lidhur me Al-Kaedën. Megjithatë ai dyshohej për sjellje kriminale, nuk ishin të mjaftueshme arsyet për ndjekje penale. Ekipi partner multi-agjenci është përpjekur të krijojë kontakt me të që prej vitit 2010, por ka pasur vazhdimisht periudha shkëputjeje dhe rilidhjeje, në varësi të situatës së tij në atë moment.

Gjatë vitit 2015, personi i kthyer u martua dhe u bë me fëmijë. Në mars 2016 ai u arrestua dhe u burgos për një krim që përfshinte vjedhjen e një numri të madh pasaportash. Ekipi partner multi-agjenci e përdori këtë mundësi për të ndërtuar një marrëdhënie me rrethin më të gjerë familjar dhe në veçanti një marrëdhënie më të ngushtë me gruan dhe djalin e tij të vogël, duke u ofruar atyre ndihmë nga autoritetet. Në dhjetor 2016 ai u lirua nga burgu dhe në janar 2017 kontaktoi vullnetarisht autoritetet dhe kërkoi ndihmë për të risistemuar jetën e tij. Në shkurt ai hyri në programin Exit. Autoritetet mbetën të përfshira ngushtë me gruan dhe fëmijën dhe është caktuar një mentor për personin e kthyer për të forcuar jetën e tij dhe aftësitë arsimore.

Mësimet e nxjerra:

- Është e rëndësishme që të krijohen shumë pika lidhëse me personin e kthyer dhe familjen e tij/saj dhe të krijohet konfidenca dhe marrëdhëniet e mira.
- Përgatituni për durim dhe këmbëngulje gjatë afrimit me individin.

- **Ofrimi i mbështetjes psikologjike dhe i ndërhyrjes së traumës:** Kjo është ndërhyrja standarde për burgjet. Në përgjithësi, një vlerësim i shëndetit mendor të një shkelësi është pjesë e rrezikut të përgjithshëm dhe ka nevojë për vlerësim. Për personat e kthyer, duhet aplikuar e njëjta gjë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë problemeve psikologjike dhe traumave që mund të jenë zhvilluar për shkak të qëndrimit të tyre në zonën e konfliktit. Nëse zbulohen probleme të tjera të shëndetit mendor (si p.sh. sëmundje të personalitetit, autizëm etj.) duhet të ofrohet trajtim për këto probleme dhe duhen marrë në konsideratë kur personi i kthyer përfshihet në skema të tjera. Burgjet duhet të përmirësojnë kapacitetin dhe/ose aksesin e tyre në ekspertët e traumës për të punuar me këtë grup të veçantë.
- **Ofrimi i programeve të mentorimit:** programet e mentorimit për ekstremistët e dhunshëm dhe shkelësit terroristë ekzistojnë/kanë ekzistuar në disa vende, si p.sh. Mbretërinë e Bashkuar, Danimarkë dhe Norvegji. Programet mund të rregullohen për t'iu përshtatur profileve të personave të kthyer në burgje. Ideja bazë pas tyre është se një person specifik caktohet si mentor për shkelësin, dhe ata takohen rregullisht për të biseduar dhe në disa raste për të ndërmarrë aktivitete të caktuara. Mentorët mund të jenë anëtarë të personelit, anëtarë të komunitetit, profesionistë të OJQ-ve, liderë fetarë, ish-shkelës etj. Për të pasur një program efikas mentorimi, duhet të vihen në praktikë sa vijon:
 - Çfarëdo që të jetë prejardhja e tyre, kriteri më i rëndësishëm është që të ketë një lidhje ose “përshtatje” mes mentorit dhe personit nën mentorim mbi të cilën mund të ndërtohet një marrëdhënie besimi.
 - Një një ambient burgju është e rëndësishme që mentori të ketë kontakt të mirë me personelin e burgut të cilët punojnë me personin nën mentorim çdo ditë.
 - Mentorët duhet të zgjidhen me kujdes përpara se të vihen në kontakt me personin e mundshëm nën mentorim. Nëse një prej tyre nuk është komod me këtë përputhje, mentorimi nuk duhet të vazhdojë.
 - Është e rëndësishme që lidhja mentor-person nën mentorim nuk është për të arritur një objektiv apo për të sjellë një rezultat specifik, por është një prej ndërhyrjeve në procesin e rehabilitimit të shkelësit. Është gjithashtu e rëndësishme që të mos ushtrohet presion mbi marrëdhënien dhe të sigurohet që mentori të mos shihet si “pjesë e sistemit” (një sistem ku shumë shkelës ekstremistë të dhunshëm nuk kanë besim).

- Mentorët duhet të trajnohen përpara se të fillojë programi i mentorimit. Trajnimi duhet të fokusohet te rrethanat që mund të priten kur punohet me personin e kthyer, sinjalet që janë shkak shqetësues dhe nevoja për të raportuar te autoritetet e burgut, si të zhvillohen biseda të hapura dhe të ndërtohet besimi, dhe si të shpjegohen kufijtë dhe të menaxhohen pritshmëritë.
- Nëse e lejon kuadri i ndërhyrjes, është e këshillueshme që të mbahen mentorime të mira pas lirit dhe të sigurohet që i njëjti mentor të takohet me personin nën mentorim.
- Duhet të kihet parasysh në çdo kohë siguria e mentorëve dhe e familjeve/rrjeteve të tyre shoqërore. Mentorët duhet të kenë një vend ku të raportojnë sjelljet e dyshimta. Duke punuar vetëm me emrin (pa mbiemrin) dhe duke pasur një numër telefoni ose adresë emaili specifike për këtë kontakt mund të ndihmojë në mbrojtjen e mentorit kundër qëllimeve negative (nëse shfaqen të tilla).

Praktika në veprim: Rehabilitimi individual i shkelësve meshkuj dhe femra sipas Ligjit për Terrorizmin (TACT)

The Unity Initiative (TUI) është një qendër konsulence e specializuar për ndërhyrjet në Mbretërinë e Bashkuar. Ata kanë programe speciale për të rehabilituar (ideologjikisht) shkelësit terroristë dhe personat e kthyer nga ISIS-i. Lexoni më shumë rreth programit të tyre në [uebsajtin e tyre](#).

Back on track Danimarka ishte një prej Shteteve të para anëtare të BE-së që zhvilloi një program mentorimi për shkelësit e dhunshëm terroristë dhe ekstremistë. [Lexoni më shumë rreth programit në Koleksionin e RAN](#).

- Puna me ish-ekstremistët (shkelësit) / ish-ushtarët: Si pjesë e ndërhyrjeve të fokusuara te edukimi ose ideologjia, takimet me ish-ekstremistë ose ish-ushtarë (veteranë) (ata që kanë përjetuar gjithashtu luftën dhe situatat e konfliktit) mund të ndihmojnë për të sjellë një perspektivë të ndryshme mbi përvojat e personave të kthyer, ata mund të mësojnë dhe të reflektojnë bazuar në historitë që trajtojnë frikën, ankthin dhe traumën. Për shkak të përvojës së tyre, ish-ekstremistët dhe veteranët mund të kenë më shumë legjitimitet dhe respekt në sytë e personave të kthyer dhe do të jenë në gjendje të gjejnë më shumë ngjashmëri me ta, t'i kuptojnë dhe të lidhen me ta. Gjatë punës me ish-ekstremistë, është me rëndësi të veçantë që:
 - ata të jenë vërtet ish-ekstremistë, dhe të jenë distancuar hapur nga ideologjitë dhe grupet ekstremiste;
 - ata janë trajnuar dhe janë me përvojë në punën me ekstremistët dhe preferimisht edhe shkelës;
 - të ketë monitorim për t'u siguruar që të mos kenë një axhendë të fshehur për të influencuar ose për të rekrutuar ata me të cilët janë në kontakt ose për të marrë informacion. Duhet të jetë e garantuar gjithashtu siguria dhe sigurimi i ish-ekstremistëve, ata mund të shihen si tradhtarë.

Lexim i mëtejshëm: [Dokumenti aktual i RAN EXIT rreth mënyrës së konfigurimit të një ndërhyrjeje për dalje nga radikalizimi](#) paraqet informacion shtesë rreth mënyrës së punës me ish-ekstremistët.

5.4 Parimet drejtuese nga perspektiva e shërbimit të provës

Riintegrimi synon të parandalojë sjelljen e dhunshme dhe të mundësojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen në shoqëri. **Një sens përkatësie dhe pranimi e bën angazhimin ndaj dhunës më pak të qëndrueshëm.** Idetë radikale nuk janë të rrezikshme në vetvete, megjithëse ato mund të mbeten faktor rreziku për sjellje të dhunshme në disa rrethana. Ekzistojnë studime të kufizuara rreth shkelësve ekstremistë të dhunshëm (SHED) pas lirit të tyre dhe pak njihet se çfarë e ndihmon zhvendosjen. Megjithatë, Grupi i punës i RAN P&P ka dalluar disa parime të përgjithshme drejtuese për praktikën e mirë që gjithashtu drejtojnë punën me personat e kthyer:

- Planet e riintegritit duhet të përfshihen në axhendën e punës për shkelësin sa më herët gjatë dënimit që të jetë e mundur. Kjo do të thotë se planet e rehabilitimit marrin tashmë në llogari kohëzgjatjen e dënimit dhe mundësitë për vazhdimin e ndërhyrjeve pas lirit. Për shembull, kur një mentor është pjesë e një plani rehabilitimi, sigurohuni që mentori të qëndrojë i gatshëm pas lirit. Kjo është e rëndësishme edhe për këshillimin fetar dhe programet sepse ato mund të lidhen me organizatat fetare në komunitet.
- Vlerësimet e rreziqeve dhe nevojave ([siç shpjegohet në kapitullin 3](#)) janë kyçe për të hartuar programe efikase riintegriti. Shërbimet e provës (ose ekuivalentja sipas shtetit) duhet të bashkëpunojnë me këtë vlerësim gjatë fazës përfundimtare të dënimit me burg. Individualizimi i vlerësimeve është thelbësor; ato duhet të lehtësojnë distancimin dhe/ose procesin e deradikalizimit duke njohur një potencial për të kontribuar në shoqëri. Rekomandohet që ekipet multi-disiplinore të vlerësojnë nevojat dhe rreziqet individuale të shkelësit.
- Menaxhimi i tranzicionit është i rëndësishëm. Kjo përfshin bashkëpunimin mes organizatave të ndryshme (burgu, shërbimi i provës, policia, autoritetet lokale, organizatat mbështetëse etj.) për t'u garantuar që shkelësit të ketë një tranzicion të lehtë nga ambienti i burgut në komunitetin lokal. Duke qenë se periudhat e tranzicionit janë ato pika kur rreziku për recidivizëm është i lartë, është e rëndësishme që të keni plane përpara se të shërbehet dënimi i plotë.
- Besimi është pjesa më e rëndësishme për punë efikase të shërbimit të provës, dhe shpesh procesi i lidhjes së shkelësve ekstremistë me oficerë të shërbimit të provës kryhet duke pasur në mendje ndërtimin e besimit. Oficerët e shërbimit të provës që kanë të njëjtën prejardhje kulturore ose fetare me shkelësin mund të ndihmojnë në krijimin e besimit.
- Studimet rreth distancimit, se si individët ndalojnë ose distancohen nga krimi, sugjerojnë rëndësinë e bashkëprodhimit të një procesi me të tjerët. Këta "të tjerë" përfshijnë oficerë të vuajtjes së dënimit dhe persona shtesë në rrjetet shoqërore. Përfaqësuesit nga organizatat e tjera bashkëpunuese, duke përfshirë organizatat e komunitetit që ndihmojnë me kërkimin e punës ose udhëheqje fetare ose shpirtërore, mund të plotësojnë nevojat për mbështetje shoqërore dhe ulin burimet e rrezikut. Miqtë, anëtarët e familjes dhe marrëdhënie të tjera të rëndësishme janë thelbësore për trajektoret e distancimit dhe për përforcimin e një pikëpamjeje pozitive të sjelljes jo të dhunshme si edhe një identiteti pozitiv. Ky bashkëprodhim me të tjerët është kyç për riintegrimin sepse është jo vetëm përpjekja dhe vendimi i shkelësit që të dëshirojnë të riintegrohet në shoqëri, por është edhe shoqëria (veçanërisht ata që janë pranë shkelësit) që duhet ta pranojë atë dhe të jetë e gatshme që t'i ofrojë një shans të dytë.

5.5 Metodatat dhe modelet e ndërhyrjes në një mjedis shërbimi prove

Ambienti i burgut dhe i shërbimit të provës kanë si ngjashmëri ashtu dhe ndryshime. Të dyja kanë të përbashkët faktin se nuk janë zhvilluar ndërhyrje specifike për personat e kthyer. Prandaj metodatat dhe ndërhyrjet e përdorura për shkelësit terroristë në shërbimin e provës do të jenë të vlefshme edhe kur punohet me personat e kthyer. Ndërsa personat e kthyer kthehen në shoqëri pas një dënimi me burg, do të ketë sfida shtesë për vetë personin e kthyer si edhe për shërbimet e mbështetjes dhe komunitetin. Këto mund të pengojnë ndërhyrjet për riintegrim, siç shpjegohet në përmbledhjen e ndërhyrjeve të ndryshme që jepen në këtë paragraf.

Rast studimor — Mbështetja pas lirim 1

Person i kthyer mashkull, u nis për në Siri me të dashurën tij në vitin 2013 kur ishte në fillim të të 20-ave. Ai nuk kishte arsim të lartë dhe nuk gjente punë. Ai kishte qëndruar larg aktiviteteve kriminale dhe kishte dëshmi të pastër penaliteti përpara se të nisej. Ai u kthye në vitin 2014 dhe prandaj shihet si një prej brezit të parë të luftëtarëve të huaj terroristë. Ai kishte qëndruar në Siri për gjashtë muaj. Ai u dënua për pjesëmarrje në luftime përkrah ISIS-it, megjithëse e mohon pjesëmarrjen në ISIS. Duke qenë se kthimi i tij ishte në vitin 2014, nuk kishte shumë pengesa dhe ai thjesht kaloi kufirin. Ai u kthye së bashku me gruan e tij, e cila ishte shtatzënë në atë kohë (kjo ishte një arsye e rëndësishme për t'u larguar) dhe ajo lindi kur u kthyen në vendin e tyre në BE. Pas kthimit, ai u paraqit pranë autoriteteve lokale dhe policisë, por qëndroi në komunitet për disa muaj përpara se të arrestohej zyrtarisht nga një skuadër e madhe arrestimi. Duke qenë se ai ishte paraqitur tashmë vetë pranë autoriteteve, ai mendonte se shkalla e arrestimit ishte e panevojshme. A u ndoq penalisht dhe u dërgua në burg për dy vjet. Tani ai ka dalë me kusht prej rreth një viti dhe jeton me gruan dhe fëmijën dhe është transferuar në një qytet tjetër. Fillimisht u përfshinë shërbimet e provës, duke raportuar vlerësimet e tyre në gjykatë. Gjatë qëndrimit të tij në burg, shërbimet e provës kishin kontakte të kufizuara; pas lirim 1 u vendosën kontakte javore. Ai ishte konsistent dhe i besueshëm në vizitat e tij me shërbimin e provës, por ekipi kishte vërejtur se ai ishte bërë më i drejtpërdrejtë në simpatinë kundrejt ISIS-it dhe faktit se kishte qenë në luftime. Ai nuk është shumë i hapur për rrjetin e tij. Ai do të qëndrojë në shërbimin e detyrueshëm të provës për një vit tjetër.

Mësimet e nxjerra:

- Megjithëse shërbimet e provës kanë indicie se ai po lidhet me një pjesë të rrjetit të tij të vjetër, ata nuk mund të flasin me të në lidhje me këtë sepse kjo do t'i shkaktonte atij dyshime. Ata duhet të presin derisa ai të hapet me ta për t'u siguruar që besimi i tij të mos komprometohet.
- Qëndrimi dyvjeçar në burg ka lënë shenjat e veta te ky person i kthyer. Ai e ka përjetuar regjimin strikt si shumë të vështirë dhe poshtërues, dhe simpatia e tij për ideologjinë e ISIS-it është rritur. Kjo ndodh gjithashtu sepse ai u vendos në të njëjtin burg me terroristë të tjerë të dënuar, me mentalitete të ngjashme, që krijojnë më pak hapësirë për dhënien e mesazheve alternative dhe të kundërta. Ai mori njëfarë mbështetjeje nga anëtarët e personelit dhe një imam, por efektet e kësaj duken minimale. Specialistët e shërbimit të provës duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këtë historik, dhe dëmet e mundshme që mund të jenë shkaktuar nga burgimi.
- Ndërtimi i besimit ka rezultuar i pafrytshëm dhe ka kërkuar durim sepse ka shumë mungesë besimi. Duke pasur një qëndrim të hapur dhe transparent ndaj personit të kthyer rreth asaj që ai mund të presë nga oficeri i shërbimit të provës dhe se si ai do të raportojë rreth çështjes së tij, është e rëndësishme për të rifituar besimin.
- Specialistët e shërbimit të provës kanë detyrën që të mbështesin riintegrimin e shkelësve dhe në këto raste duhet të përgatiten për një trajektore të gjatë dhe komplekse. Në këtë rast, riintegrimi është shumë i vështirë. Personi i kthyer u përpoq të lidhej me një xhami, por ata nuk e mirëpritën atë. Ai është gjithashtu pjesë e një trajektoreje riintegrimi përmes punës që koordinohet nga autoritetet lokale, por ende nuk ka gjetur punë. Ai nuk dëshiron të jetë në kontakt me policinë. Ai është në kontakt vetëm me autoritetet lokale, shërbimin e provës dhe shërbimin e mbështetjes për familjen. Së fundi ai ka treguar gjithashtu interes për mbështetje psikologjike. Gruaja e tij nuk dëshiron të ketë kontakt me asnjë. Personi i kthyer duket gjithashtu se nuk ka asnjë dëshirë të riintegrohet në shoqëri në vendin e tij, si edhe ka dëshirë të jetojë në një vend islamik. Por ai e kupton se largimi për në vendin e prejardhjes nuk është opsion sepse do të arrestohej menjëherë, ai atje është i etiketuar si terrorist i dënuar.
- Duke qenë se në këtë çështje janë përfshirë shumë organizata të ndryshme, ka qenë e rëndësishme që shërbimet e provës të kenë bashkëpunim të mirë multi-agjenci. Ka qenë shumë e dobishme disponimi i një tavoline të partnerëve në të cilën organizata të ndryshme mund të flisnin rreth çështjes, kërkimi i mënyrave për të ndarë informacion dhe për të mësuar rreth interesave dhe objektivave të njëri-tjetrit.

- **Mbështetja e shërbimit të provës:** Në shumicën e rasteve, fundi i një dënimi (ose lirimi i parakohshëm) do të jetë i kushtëzuar dhe do të përfshijë vizita vijuese me shërbimin e provës për të mbështetur dhe monitoruar trajektoren e riintegrit të personit të kthyer. Profesionalistët e shërbimit të provës shërbejnë si “menaxherë të çështjeve” që prijnë rrugën për institucionet e tjera dhe agjencitë e mbështetjes si p.sh. autoritetet lokale, policinë, OJQ-të etj. Kohëzgjatja e mbështetjes së shërbimit të provës do të varet zakonisht nga vendimi i gjykatës. Specialistët kanë treguar se kjo është shpesh shumë e shkurtër, duke e bërë të rëndësishme pasjen e një plani më të gjerë mbështetjeje pas përfundimit të mbështetjes së detyruar përmes shërbimit të provës. Autoritetet lokale, që në shumë raste mbikëqyrin mbështetjen financiare dhe forma të tjera mbështetjeje për personin e kthyer, mund të luajnë një rol në këtë, si edhe OJQ-të ose organizatat e tjera të komunitetit dhe mentorët. Shumica e këtyre përpjekjeve duhet të jenë vullnetare. Autoritetet lokale mund të kenë njëfarë avantazhi për bashkëpunim për shkak të mbështetjes financiare. Duke qenë se puna me shkelësit terroristë në shërbimin e provës mund të jetë shumë stresuese (për shkak të ankthit publik dhe politik që shoqëron shkelësit terroristë), është e rëndësishme që personeli i shërbimit të provës të fuqizohet dhe të mbështetet në punën e tyre. Mbështetja duhet të përfshijë:
 - *Trajnimin e oficerëve të shërbimit të provës:* trajnim i specializuar mbi radikalizimin, ideologjinë, mënyrat e adresimit të shenjave shqetësuese etj. mund të ndihmojë oficerët e shërbimit të provës të ndihen më të sigurt në punën e tyre të përditshme.
 - *Puna në ekipe:* puna së bashku me oficerë të tjerë të shërbimit të provës që punojnë me të njëjtin grup shkelësish, dhe me specialistë / ekspertë me njohuri të gjera në fushën e terrorizmit, radikalizimit dhe fusha të ngjashme, mund të ndihmojë gjithashtu në krijimin e një hapësire të sigurt për oficerët e shërbimit të provës që të ndajnë sfidat dhe shqetësimet e tyre.

Praktika në veprim: Ekipe holandeze TER të shërbimit të provës

Shërbimi holandez i provës krijoi një ekip special për të punuar me terroristët, ekstremistët dhe radikalët (TER) në shërbimin e provës në vitin 2012. Ekipi përbëhet nga 13 oficerë të shërbimit të provës të trajnuar dhe të specializuar (në nivel ndërkombëtar). Lexoni më shumë në ***Koleksionin e RAN të përjasjeve dhe praktikave***.

Për më shumë informacion, kontaktoni me [*Shërbimin holandez të provës*](#).

- **Mbështetja praktike:** Si në çdo proces riintegrimi, do të ketë një numër çështjesh praktike për të organizuar për kthimin në shoqëri të një personi të kthyer të dënuar. Para së gjithash, atyre do t’u duhet një vend për të banuar. Përvoja tregon se duhet parë me kujdes fakti nëse personi i kthyer kthehet në qytetin e tij/saj fillestar apo zhvendoset diku tjetër. Kjo do të varet nga një numër faktorësh si p.sh.:
 - gatishmëria e autoriteteve lokale/rajonale për t’i pranuar sërish;
 - gatishmëria e pronarëve të shtëpive/shoqatave të shtëpive për të ofruar strehim;
 - gatishmëria e anëtarëve të familjes për të ofruar strehim;
 - lidhjet me rrjetin e vjetër (a janë ato pozitive ose negative, a e kufizojnë kushtet e lirit kontaktin me (disa) anëtarë të rrjetit të vjetër, cili është “statusi” i personit të kthyer në rrjetin e vjetër, p.sh. hero apo tradhtar);
 - nëse janë të disponueshme struktura të mbështetjes multi-agjenci në lokalitetin e parashikuar.
- Përveç strehimit, një formë mbështetjeje financiare do të merrej përmes sistemit të asistencës sociale sepse gjetja e punës do të ishte sfiduese. Punonjësit mund të kenë frikë të përfshijnë në personelin e tyre një terrorist të dënuar dhe person të kthyer. Shumica e vendeve gjithashtu do të kenë lista speciale të terroristëve të dënuar që do ta bëjnë më të vështirë për ta p.sh. hapjen e një llogarie bankare. Nevojitet mbështetja nga një autoritet kombëtar/lokal dhe zakonisht kushtëzohet me bashkëpunimin e personit të kthyer me autoritetet dhe madje me marrjen pjesë në programe rehabilituese. Gjithashtu, në lidhje me arsimin, personi i kthyer do të ketë nevojë të lidhet me institucionet arsimore.

Oficerët e shërbimit të provës, autoritetet lokale dhe profesionistët e tjerë të mbështetjes mund të mbështesin gjithashtu personin e kthyer në rindërtimin e një rrjeti pozitiv dhe në lidhjet me institucionet fetare, klubet sportive, organizatat e kohës së lirë, punën vullnetare etj. Megjithatë, në secilin prej këtyre rasteve imazhi publik i luftëtarëve të huaj terroristë dhe i personave të kthyer do ta bëjë shumë të vështirë pranimin në këto rrethe. Për shkak të vëmendjes së medias, mund të rezultojë e vështirë edhe ruajtja e një profili të ulët.

Rast studimor – Mbështetja pas lirimit 2

Mashkull, tani 24 vjeç. Pas udhëtimit drejt Sirisë në vitin 2012, ai kthehet në qytetin e tij në fillim të vitit 2012 me gruan dhe një fëmijë. Është e paqartë se si dhe pse u kthye. Kthimi i tij u vërejt nga oficeri i policisë së komunitetit dhe e raportoi te autoritetet. Ai më pas u arrestua, u ndoq penalisht dhe u dënua me tri vjet burg për pjesëmarrje në organizatë terroriste. Gjatë burgimit, kishte bashkëpunim të ngushtë me drejtorin e burgut, psikiatrin e burgut, oficerët e shërbimit të provës dhe menaxherin e çështjes në burg. Këto palë filluan të përgatiten për lirin e tij gjashtë muaj përpara lirimit të tij. Duke e pyetur atë “Çfarë të nevojitet kur të lirohesh?” ose “Si pret t’i kalosh ditët kur të lirohesh?”, ata e përfshinë atë në planifikim. U hartua një plan riintegrimi multi-agjenci. Fokusi i këtij plani është të reduktohet rreziku që paraqet ai duke e bërë të mundur riintegrimin e tij të shpejtë në shoqëri, dhe duke zgjatur trajtimin dhe monitorimin.

U formulua një set specifik kushtesh liri në bashkëpunim me shërbimin e provës. Tani ai jeton me gruan dhe fëmijën në qytetin e tij. Aktualisht është me asistencë sociale, por duhet ta kalojë ditën duke e fituar këtë mbështetje në një impiant pune të komunitetit për riintegrimin. Në këtë impiant ai monitorohet veçanërisht për sinjale të radikalizmit dhe/ose rekrutimit të të tjerëve që punojnë në të njëjtin impiant. Ai merr gjithashtu trajtim dhe mentorim për shëndetin mendor. Kontakti mes tij dhe mentorit, që është gjithashtu menaxheri lokal i çështjes, është i qëndrueshëm. Ata zhvillojnë sesione javore mentorimi dhe sa herë që atë e “kap paniku” ose ka “mendime ekstreme” ai kontakton me mentorin.

Në këtë moment ekipi multi-agjenci i përfshirë në riintegrimin e tij, përbëhet nga koordinatori lokal dhe menaxheri i çështjes, një profesionist i shëndetit mendor (terapist), një menaxher i çështjes nga organizata e asistencës sociale, policia, shërbimi i provës, një punonjës i mbështetjes për familjet, dhe një punonjës për daljen nga radikalizimi.

Bashkëpunimi me psikiatrin e burgut dhe oficerët e shërbimit të provës dhe më pas me koordinatorin lokal të çështjes, ka vazhduar dhe diskutimet rreth çështjes zhvillohen rregullisht. Përshtypjet e përgjithshme të specialistëve të përfshirë janë se personi do të ketë nevojë për mentorim dhe trajtim për një periudhë të paspecifikuar.

Mësimet e nxjerra:

- Është e rëndësishme që t’i njihni luftëtarët e huaj terroristë në qytetin tuaj me emër, si edhe familjet e tyre dhe ambientin e mëparshëm. Duke vepruar kështu rriten shanset që të informoheni kur luftëtari i huaj terrorist të kthehet.
- Përdorimi i dëshirës së familjes për t’i mbajtur fëmijët në familje, mund të përdoret si avantazh për të kontaktuar me personin e kthyer. Në këtë rast personi i kthyer mund të dojë që fëmija i tij të jetojë me prindërit e tij dhe jo në kujdes birësimi. Duke folur me familjen dhe më pas me personin e kthyer rreth kësaj, autoritetet lokale mund të krijojnë kontakt me personin e kthyer.
- Bashkëpunimi me personelin e burgut dhe oficerët e shërbimit të provës dhe përfshirja e personit të kthyer në planin e tij/saj të riintegrimit është thelbësor kur përgatitet kthimi në shoqëri.
- Nisja e ndërtimit të një marrëdhënieje me personin e kthyer gjatë kohës që ai është në burg mund të jetë investim i vlefshëm. Ky person i kthyer deklaroi se mentori kishte ndikim vetëm sepse mentori e kishte kontaktuar kur ai ishte ende në burg.

- Nëse personi i kthyer është në listën e terroristëve të OKB-së, asetet e tij/saj ngrihen. Për të filluar një procedurë për heqjen nga kjo listë, ju duhet të kontaktoni me qeverinë e vendit. Nëse kjo nuk bëhet përpara lirimit të tij/saj, personi nuk do të jetë në gjendje të fitojë para, të hapë llogari bankare apo të ketë akses në një llogari ekzistuese. Procedura e heqjes zgjat disa muaj.
- Është e dobishme që të bëhen marrëveshje të qarta dhe të përcaktohen objektiva konkretë për procesin e riintegrit, me partnerë në ekipin multi-agjenci, por edhe me personin e kthyer. Nëse kjo nuk bëhet siç duhet, i gjithë procesi i integrit rrezikon të bëhet një lloj “leukoplasti”.
- Kontakti i shpeshtë individual me personin e kthyer është i domosdoshëm për të vlerësuar se si po ecën personi i kthyer.
- Është i rëndësishëm monitorimi i aktiviteteve të personit të kthyer duke monitoruar llogaritë e tij/saj në median sociale. Në këtë rast, një analist nga komuna monitoron komunikimin (publik) në median sociale të personit të kthyer dhe ia kalon informacionin mentorit. Mentori ia tregon atij/asaj deklaratat ose veprimet personit të kthyer në median sociale gjatë seancave të mentorimit.
- Riintegrimi kërkon kohë. Është një proces shumë i ngadaltë dhe kompleks. Pasi të filloni, përgatituni që të jenë pjesë e saj për një kohë të gjatë.

- **Mbështetja psikologjike:** Praktika tregon se është shumë e vështirë të përcaktohet gjendja psikologjike dhe niveli i traumës mes personave të kthyer sepse ata zakonisht ngurren të tregojnë historitë e asaj që kanë përjetuar jashtë vendit, edhe pasi janë dënuar dhe kanë vuajtur dënimin. Kjo paraqet gjithashtu një sfidë për shërbimet e provës, që kanë detyrën që t’i drejtojnë personat e kthyer te mbështetja psikologjike e përshtatshme, si edhe të krijojnë një marrëdhënie të hapur dhe të bazuar te besimi. Në shumicën e rasteve, duhet të krijohet një hapje nga vetë personi i kthyer për të folur rreth problemeve psikologjike, duke lejuar punonjësit e shërbimit të provës dhe profesionistët e tjerë të ofrojnë ndihmë në sigurimin e ndihmës. Përvoja e specialistëve tregon se nëse personat e kthyer detyrohen që të flasin rreth përvojave të tyre, kjo do të ketë efekt negativ.
- **Mbështetja për familjen dhe komunitetin:** Familja dhe rrjeti shoqëror rreth personit të kthyer luajnë një rol të rëndësishëm në rehabilitim dhe riintegrim. Ka shumë skenarë të ndryshëm: **familje që janë lënë pas të shkatërruara, familje që mendojnë se i afërmi i tyre është hero, familje që kanë udhëtuar dhe janë kthyer bashkë** (dhe janë dënuar vetëm disa anëtarë të familjes), familje që janë krijuar jashtë vendit etj. Ky rrjet më i gjerë duhet të merret parasysh kur ofrohet mbështetje. Oficerët e shërbimit të provës gjithmonë duhet të jenë të ndërgjegjshëm se askush nuk e di vërtet se çfarë ndodh pas dyerve të mbyllura dhe sa të forta mund të jenë lidhjet familjare. Nëse familja dhe rrjeti shoqëror duket se kanë efekt negativ te personi i kthyer (p.sh. duke përforcuar mendimet ekstremiste), oficerët e shërbimit të provës dhe partnerët e tjerë duhet të fokusohen te sjellja e personave të rinj në rrethin shoqëror për të ofruar një kundër-balancë. Këta mund të jenë udhëheqës fetarë, mentorë të komunitetit ose profesionistë të OJQ-ve (*shikoni gjithashtu edhe opinionet rreth programeve të mentorimit dhe punën me ish-ekstremistë në seksionin e mjedisit të burgut, ato aplikohen edhe për shërbimin e provës*). Nëse familja dhe rrjeti shoqëror duket se janë një forcë pozitive për ndryshim, oficerët e shërbimit të provës dhe partnerët e tjerë duhet të shfrytëzojnë atë potencial dhe të shikojnë nëse mund të përfshijnë anëtarët e familjes në elemente të procesit të rehabilitimit, për shembull, përmes sesioneve të përbashkëta të ndërmjetësimit ose duke zhvilluar së bashku aktivitete të kohës së lirë. Objektivi kryesor do të ishte të forcoheshin sërish lidhjet familjare dhe të shmangej izolimi i personit të kthyer.
- **Mbështetja ideologjike:** rezultati i vlerësimit të rrezikut dhe nevojave do të jetë një tregues i shkallës në të cilën personi i kthyer është ende i motivuar ideologjikisht dhe nëse është ende me karakter ekstremist. Oficerët e shërbimit të provës si edhe profesionistët e tjerë të mbështetjes kanë treguar se përvoja e të qenit në **burg në disa raste ka pasur efekt negativ në zhvillimin ideologjik**, që do të thotë se ka përforcuar bindjet e personit të kthyer. Kjo mund të shkaktohet nga rrethanat në burg që personi i kthyer i ka konsideruar si poshtëruese dhe çnjerëzore (p.sh. mbingarkesë në burgje, vizitat, oraret e

zgjatura brenda në qeli) ose përmes kontaktit me të burgosur të tjerë që kanë ideologji të njëjtë me të. Rezultati është mungesa e besimit dhe dyshimi ndaj “sistemit” dhe autoriteteve. Megjithëse gjithnjë e më shumë burgje ofrojnë programe dhe aktivitete rehabilituese, ata mund të jenë në kontrast të fortë me kushtet e rregullta për të burgosurit. Kur kjo është pikënisja e punës së një oficeri të shërbimit të provës me një preson të kthyer, është e vështirë të ndërtohet një marrëdhënie e bazuar te besimi, dhe në këtë marrëdhënie duhet investuar shumë kohë dhe përpjekje. Pjesëmarrja në nismat e hartuar për të influencuar mentalitetin mund të jetë e detyrueshme (pjesë e kushteve të lirimit) ose vullnetare (një ofertë nga shërbimi i provës ose organizata të tjera mbështetëse me të cilën personi i kthyer duhet të bjerë dakord). Këto lloje programesh mbështetjeje mund të marrin të njëjtat forma siç përshkruhet në ndërhyrjet në burg (këshillim individual, dialog në grup, edukim dhe reflektim), por në kontekstin e komunitetit.

Praktika në veprim: Programi holandez i shërbimit të provës “Përfshirja”

“Përfshirja” është një program i individualizuar dhe i personalizuar që krijohet kur një person është në shërbimin e provës. Qëllimi kryesor i nismës është të shkëputen myslimanët e radikalizuar (kryesisht xhihadistët me rrënjë brenda vendit) nga lëvizjet radikale.

Lexoni më shumë rreth programit në [Koleksionin e RAN të përjasjeve dhe praktikave](#)

Për informacion shtesë, kontaktoni me [Shërbimin holandez të provës](#).

Programi “Healthy Identity II”

Programi “Healthy Identity II” është hartuar nga Shërbimi Britanik i Provës dhe Burgjeve. Qëllimi i tij është të përpiqet të parandalojë që individët të bëjnë shkelje të ardhshme terroriste. Për të arritur këtë, ai inkurajon dhe fuqizon pjesëmarrësit të shkëputen nga një grup, kauzë apo ideologji ekstremiste.

Lexoni më shumë rreth programit “Health Identity II”UM

Rast studimor — Mbështetja pas lirimit 3

Një person i kthyer, mashkull, në mes të të 20-ave, fëmija më i vogël i një familjeje të varfër. Ai mendonte gjatë gjithë jetës se duhej ta “vërtetonte” atë që besonte. Ai shkoi në Siri pas shpalljes së të ashtuquajturit “kalifat” për t’u bërë sulmues vetëvrasës. Megjithatë, nuk ka prova të qarta se ai ka marrë pjesë vërtet në luftime gjatë qëndrimit të tij tremujor. Ai raportoi te autoritetet 3-4 muaj pas kthimit. Megjithëse në atë pikë nuk u morën masa, disa muaj më vonë ai u arrestua me helikopterë dhe një numër të lartë policësh të armatosur në apartament. Ai kaloi 26 muaj në burg. Gjatë kësaj kohe, atë e vizitonin prindërit, por krahasuar me vëllezërit dhe motrat ai merrte shumë pak vëmendje. Rasti mori shumë vëmendje nga media dhe politikanët. Kjo bëri që personi i kthyer të kishte ankth të madh përpara lirimit. Ai mendonte se i gjithë sistemi ishte kundër tij, të gjithë e njohin dhe mbahet në vëzhgim gjatë gjithë kohës. Ai mendonte se askush nuk donte që ai të riintegrohej.

Mësimet e nxjerra:

- nevojitet mbështetje 24-orëshe që personi i kthyer të përballojë ankthin, në këtë rast kjo u ofrua nga një OJQ;
- ofrimi i aksesit te një teolog për këshillim mund të rezultojë i dobishëm nëse feja luan rol të rëndësishëm në jetën e individit;
- rifitimi dhe ritrajnimi i një stili jetese të strukturuar mund të jetë i rëndësishëm. Në këtë rast, një OJQ mbështet përpjekjet për të krijuar atë strukturë përmes strehimit, edukimit, aktiviteteve sociale etj.



6 Rruga pa ndjekje penale / risocializimi

Fokusi i këtij kapitulli të manualit është te risocializimi i personave të kthyer. Këta mund të jenë burra dhe gra të kthyer që nuk janë ndjekur (ende) penalisht, por janë gjetur fajtorë, dhe burra e gra që kanë qenë tashmë në burg dhe tani janë liruar dhe nuk janë në shërbimin e provës.

6.1 Hyrje

Ky kapitull trajton opsionet e reagimit në lidhje me risocializimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të kthyer në tri tema:

1. mbështetja e familjes;
2. mentorimi dhe këshillimi;
3. shëndeti mendor;
4. vaspektet praktike.

Secili paragraf shikon një prej këtyre temave dhe jep, pranë një përmbledhjeje të shkurtër të përgjithshme, elementet që duhen marrë në konsideratë kur hartohen metoda dhe ndërhyrje, shembuj, këshilla dhe raste.

Për reagimet e shërbimit të provës, shikoni kapitullin 5. Për reagimet e risocializimit specifike për fëmijët, shikoni kapitullin 7.

6.1.1 Përmbledhje e përgjithshme

Kur personat e kthyer kthehen, fillimisht policia e shtetit dhe/ose shërbimet e inteligjencës do t'i marrin në pyetje për të **përcaktuar rrezikun** që paraqet personi i kthyer dhe nëse duhet të ndiqet penalisht. Kur personat e kthyer nuk janë ndjekur (ende) penalisht, ose kur ndodh ndjekja penale dhe individ nuk është i burgosur ose nuk është më i burgosur, ai ose ajo do të kthehen në shoqëri. Ideja e përgjithshme është se siguria e shoqërisë garantohet më mirë përmes promovimit të mirëqenies dhe rehabilitimit të personave të kthyer. Ata persona që janë dhe ndihen pjesë e shoqërisë kanë më pak të ngjarë të kthehen dhe të kenë tërheqje (sërish) ndaj grupeve terroriste ose ekstremiste të dhunshme. **Procesi i risocializimit duhet të përshtatet sipas situatës së një individi.** Gjatë mbështetjes së një personi të kthyer në procesin e tij të risocializimit, është e nevojshme të konsiderohen arsyet që qëndrojnë pas kthimit të tij, situata e tij personale sociale, gjendja mendore dhe bindjet e tij ideologjike.

6.1.2 Katër parimet drejtuese për risocializimin dhe riintegrimin e personave të kthyer

1. **Risocializimi, riintegrimi dhe rehabilitimi** janë të rëndësishme për të parandaluar që personat e kthyer të dëmtojnë shoqërinë.
2. Është e nevojshme **një përqasje e personalizuar dhe e diferencuar** bazuar në profilin e rrezikut të secilit person të kthyer. Personat e kthyer janë të gjithë të ndryshëm dhe kanë nevojë për përqasje të veçanta dhe ndërhyrje e mjete të ndryshme.
3. Janë të rëndësishme **një përqasje multidisiplinore dhe një përfshirje në nivel lokal**, si për vlerësimin e rrezikut ashtu dhe rehabilitimin / riintegrimin. Të gjitha organizatat përkatëse duhet të përfshihen në përpjekje gjithëpërfshirëse për të risocializuar dhe riintegruar personin e kthyer. Autoritetet lokale ose rajonale janë në pozicionin më të mirë për të koordinuar këtë përqasje për një person specifik të kthyer në nivel lokal.
4. Gjatë punës me personat e kthyer, është jashtëzakonisht i rëndësishëm **shkëmbimi i informacionit** mes shërbimeve të inteligjencës, policisë dhe organizatave sociale nga nivelet kombëtare dhe rajonale. Duhet të merren në konsideratë gjithashtu investimet shtesë në shkëmbimin e informacioneve mes nivelit kombëtar dhe lokal, dhe mes organizatave të ndryshme.²³

²³ Këto parime drejtuese janë pranuar në të gjitha komunikimet e BE-së rreth luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer. Për shembull, shikoni Koordinatorin e BE-së të Antiterrorizmit, "Luftëtarët e huaj terroristë të kthyer: Opsionet e politikës", Bruksel, 29 nëntor 2016 14799/16.

Specialistët e vijës së parë si p.sh. punonjësit socialë, punonjësit e daljes nga radikalizimi, punonjësit e familjeve dhe këshilluesit e shëndetit mendor përdorin programe të shumta, metoda dhe ndërhyrje që kanë rezultuar të suksesshme për risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e (ish) personave të radikalizuar brenda shoqërisë.²⁴ Këto nisma mund të përdoren gjithashtu edhe për personat e kthyer për sa kohë ato janë të përshtatura për personin e kthyer, dhe nëse janë marrë në konsideratë ndryshimet mes personit të kthyer dhe (ish) personave të tjerë të radikalizuar.

Për specialistët që mbështesin personat e kthyer në risocializimin e tyre, qofshin punonjës socialë, profesionistë të shëndetit mendor apo punonjës të mbështetjes së familjeve, është e rëndësishme të merren parasysh tetë aspektet e mëposhtme gjatë hartimit dhe ofrimit të ndërhyrjeve veçanërisht për personat e kthyer:

- **Hartoni ndërhyrje në bazë të një vlerësimi të rrezikut dhe nevojave:** Një person i kthyer mund të paraqesë rrezik për shoqërinë. Është i detyrueshëm të kryhet një vlerësim i rrezikut të kërcënimeve afatshkurtra (sulme, rekrutime) dhe afatgjata (psikoza, sjellje e dhunshme) që paraqet personi i kthyer. Nëse nuk është bërë një vlerësim i rrezikut, kërkojeni këtë përmes policisë lokale ose personit të kontaktit të personit të kthyer, jo për ta stigmatizuar por për të përcaktuar rreziqet dhe faktet. Ky informacion (pjesët e paklasifikuara) është gjithashtu i rëndësishëm për ta ndarë me organizatat dhe personat e tjerë që luajnë rol në risocializimin e personit të kthyer. Për më shumë detaje rreth vlerësimit të rrezikut shikoni kapitullin 2.
- **Përgatituni për një nivel të shtuar të ndarjes së informacionit:** Duke qenë se personat e kthyer mund të paraqesin kërcënim për shoqërinë, ata janë subjekt i një vëmendjeje më të lartë nga qeveria kombëtare dhe lokale, policia dhe shërbimet e inteligjencës. Prandaj përgatituni të ndani informacionin dhe të siguroheni që të jenë përgatitur dhe gati mekanizmat e nevojshëm për ndarjen e informacionit. Diskutoni flukset e informacionit brenda ekipit lokal ose rajonal të koordinimit multi-agjenci. Diskutoni specifikisht se çfarë informacioni ju nevojitet, çfarë informacioni nevojitet të ndahet dhe me kë, dhe kur do ta shkëmbeni informacionin rreth personit të kthyer. Më e mira është që kjo të bëhet në momentin që fillojnë përgatitjet për kthimin e individit në komunitetin lokal. Është mirë të ketë një ose dy oficerë ndërlidhjeje të përcaktuar në nivel lokal dhe një pjesë të ekipit multi-agjenci që garantojnë që informacioni përkatës rreth personit të kthyer të qarkullojë nga nivel lokal në atë kombëtar dhe anasjelltas.

Këshilla nga një koordinator lokal që ka përvojë me personat e kthyer: “Që herët duhet të ketë një sqarim të qartë të roleve mes policisë së shtetit, agjencisë së inteligjencës, policisë lokale dhe autoriteteve lokale. Rolet do të varen nga lloji i personit të kthyer, prejardhja e tij, kapaciteti, qëllimi dhe kapaciteti (niveli i kërcënimit) i luftëtarit dhe gjendja mendore psikologjike.”

- **Përdorni mjete dhe metoda që “përshtaten” për personat me bindje të forta:** Shumica e të kthyerve ende kanë ose kanë një bindje të fortë ideologjike. Ata kanë qenë subjekt i një indoktrinimi të thellë. Kjo do të thotë jo vetëm angazhim ndaj xhihadizmit-selafizmit dhe luftës së tyre kundër të pafeve, por edhe ide të forta për shembull, rreth demokracisë, orientimit seksual, rolit të grave.²⁵ Gjatë mentorimit të tyre, përgatituni të përdorni metoda dhe ndërhyrje që përdoren gjatë përballjes me bindje të forta. Adresoju këtyre “bindjeve” kur mentoroni dhe këshilloni (shikoni kapitullin 6.2.2 rreth *Reagimeve të mentorimit dhe këshillimit* për detaje).
- **Mungesa e gatishmërisë për t’u riintegruar:** Do të ketë persona të kthyer që nuk duan të riintegrohen në shoqëri. Nëse ndodh kështu, diskutoni me ekipin lokal të koordinimit multi-agjenci dhe vlerësoni se kush ka marrëdhëniet më të mira me personin e kthyer. A është ky punonjësi i familjes përmes anëtarëve të familjes së personit të kthyer? Punonjësi social? Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve? Ose policia? Ky

²⁴ Për shembuj frymëzues, shikoni Koleksionin e RAN të përjasjeve dhe praktikave, https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices_en.

²⁵ Elementi i ideologjisë dhe i indoktrinimit luan një rol edhe më të madh te fëmijët e kthyer, veçanërisht kur kthehen nga qëndrimi pranë ISIS-it (shikoni kapitullin 7 “Fëmijët”).

person/organizatë duhet t'ia bëjë të qartë personit të kthyer se ai/ajo mund të monitorohet për shkak se ka qenë pjesë ose është përpjekur të jetë pjesë e një organizate terroriste. Ndoshta ky person mund të bindë personin e kthyer që të bashkëpunojë. Nëse personi nuk ka absolutisht gatishmëri, diskutoni minimumin e bashkëpunimit që nevojitet (bazuar në rregulloret kombëtare) me ekipin lokal multi-agjenci dhe autoritetet kombëtare. Bëjeni këtë të detyrueshme për personin e kthyer. Policia (lokale) mund t'i imponojë këto detyrime. Mentorimi i një personi të kthyer për ta shkëputur ose për ta deradikalizuar, nuk do të ketë asnjë dobi nëse personi i kthyer merr pjesë me detyrim. Nëse përballeni me një person të kthyer që nuk ka gatishmëri, konsideroni të kontaktoni oficerët e shërbimit të provës që të diskutoni mjete dhe ndërhyrje specifike bindëse.

Praktika në veprim: Këshillimi sistematik i daljes OJQ-ja gjermane Legato në Hamburg është e specializuar në këshillimin sistematik të daljes dhe ka zhvilluar një program special për këshillimin e personave të kthyer. Kjo merr në konsideratë rrezikun e mundshëm që mund të paraqesë një person i kthyer, pikëpamjet e tij të mundshme dogmatike dhe sfidat specifike të daljes nga një grup terrorist. Për më shumë informacion kontaktoni me [Legato](#).

- **Vendosni një fokus të veçantë të sigurisë së kontakteve të afërta sociale të personit të kthyer:** Duke qenë se personat e kthyer kanë kryer ose kanë qenë rregullisht dëshmitarë të një dhune ekstreme, rritet mundësia për veprime ekstreme dhe/ose të dhunshme nga ana e tyre. Kushtojini vëmendje të veçantë sigurisë së personave rrotull personit të kthyer, si edhe të specialistëve të vijës së parë që punojnë me individin. Merrni parasysh vlerësimin e rrezikut të personit të kthyer dhe diskutoni rrezikun e sjelljes së dhunshme dhe mënyrën e trajtimit të këtij rreziku brenda ekipit të koordinimit multi-agjenci (shikoni paragrafin 6.2.2 rreth Reagimeve të mentorimit dhe këshillimit për më shumë detaje).
- **Kryeni vlerësime për shëndetin mendor dhe fizik:** Jeta në territorin e kontrolluar nga terroristët dhe një zonë lufte do të thotë se ka mundësi që personat e kthyer të vuajnë nga traumat dhe probleme të tjera të shëndetit mendor; ata mund të kenë kryer vepra shumë të dhunshme, të kenë qenë dëshmitarë të dhunës ekstreme, vdekjes së të afërmeve, ose mund të kenë qenë viktimë të dhunës (përdhunim, rrahje etj.) dhe mund të kenë jetuar në një mjedis shumë të pasigurt për një kohë të gjatë. Vlerësoni gjendjen mendore të personit të kthyer kur punoni me të (për më shumë detaje shikoni seksionin 6.2.3, Reagimet për shëndetin mendor). Kushtet e jetesës në territorin e terroristëve janë të tmerrshme dhe të pasigurta. Tregohuni të vëmendshëm për nevojat fizike mjekësore si rezultat i lëndimeve, plagëve të luftës, kequshqimit dhe sëmundjeve. Përgatituni të ofroni trajtim ose ta referoni përkatësisht nëse është e nevojshme (shikoni paragrafin 6.2.4 *Reagime praktike* për më shumë detaje).
- **Tregoni kujdes për profilin e lartë të çështjeve të personave të kthyer:** Të gjitha çështjet e personave të kthyer marrin vëmendje shumë të lartë nga media dhe politika. Duket sikur e gjithë shoqëria po shikon personin e kthyer dhe mënyrën se si ai ose ajo trajtohet nga qeveria dhe organizatat e punës sociale. Përfitimet shtesë që marrin, ku do të jetojnë, kush do të paguajë për ta dhe shkallën e kërcënimit që ata paraqesin ende, të gjitha këto do të ndiqen nga afër. Kontaktoni me ekspertët e komunikimeve nga organizata juaj dhe (përmes tyre) ekspertët e komunikimit brenda autoriteteve lokale dhe përgatitni një strategji komunikimi rreth personave të kthyer me të cilët punoni ose po përgatiteni të punoni. Shikoni kapitullin 8 Çështjet që mbulojnë disa fusha për këshilla në lidhje me strategjinë e komunikimit.
- **Tregoni kujdes për rrezikun e izolimit dhe stigmatizimit gjatë përpjekjeve për risocializim:** Shumica e njerëzve janë shumë në dijeni të mizorive nga ISIS-i, Al Qaeda dhe grupe të tjera të dhunshme ekstremiste. Personat që kthehen nga këto organizata terroriste do të trajtohen me mungesë besimi dhe armiqësi. Personat e kthyer do të stigmatizohen dhe izoloohen nga komuniteti lokal ku ata do të kthehen. Kjo do të paraqesë një sfidë më shumë në risocializimin dhe riintegrimin e personave të kthyer. Mund t'ju duhet të bëni më shumë përpjekje për të informuar komunitetin lokal rreth arsyeve pse do të integrohet personi i kthyer dhe si. Zhvendosja e personit të kthyer në një qytet tjetër mund të jetë opsion për t'u konsideruar. Merrni parasysh mundësinë e ndarjeve sektare. Disa Shtete anëtare kanë raportuar incidente mes grupeve kurde, ish-luftëtarëve të ushtrisë siriane dhe luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer të ISIS-it.

6.2 Metodat konkrete dhe modelet e ndërhyrjes


6.2.1 Reagimet e mbështetjes së familjeve

Anëtarët e familjes së personit të kthyer mund të luajnë një rol të rëndësishëm në periudhën sfiduese të risocializimit dhe riintegritimit në shoqëri. Shumica e personave i shkëpusin kontaktet me rrjetin e tyre shoqëror përpara se të udhëtojnë drejt territorit të terroristëve dhe janë në kontakt të rrallë me nënën dhe/ose të atin e tyre dhe vëllezërit dhe motrat. Kur kthehen, anëtarët e familjes janë shpesh të vetmet kontakte shoqërore të mbetura. Është e rëndësishme që të ndërtohet një marrëdhënie me familjen e luftëtarit të huaj terrorist, kontaktet e forta me familjen do të mbështesin bashkëpunimin kur kthehet luftëtari i huaj terrorist.

Anëtarët e familjes mund të ofrojnë një **rrugë për t'u kthyer sërish në shoqëri**. Është e rëndësishme që të vlerësohet se deri në çfarë shkalle familja e mbështet personin e kthyer dhe, nëse aplikohet, bashkëshortja dhe fëmijët. Është e dobishme mbështetja për ata që kanë influencë pozitive te personi i kthyer. Megjithatë, jo të gjithë anëtarët e familjes dhe miqtë janë shoqërues të mirë gjatë risocializimit sepse mund të jenë mbështetës ose pjesë e lëvizjes terroriste ekstremiste ose të dhunshme. Kjo duhet të vlerësohet përpara se t'i përfshini ata.

Lexim i mëtejshëm: Familjet e luftëtarëve të huaj terroristë nga ISIS-i: Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizimit dhe Dhunës Politike studioi 46 raste publike të “familjeve të ISIS-it” nga 17 vende për të vlerësuar nëse ndajnë përvoja dhe emocione të caktuara. Rezultatet mund t'i gjeni në këtë [dokument](#).

RAN zhvilloi një **përjasje me 10 hapa për të punuar me familjet**. Hapat janë përshkruar në grafikon e mëposhtëm dhe tregohen si rreth ndërsa influencojnë njëri-tjetrin. Hapat kanë aplikim të gjerë si edhe aplikim sipas rastit. Në dokumentin aktual të RAN, *Puna me familjet dhe mbrojtja e fëmijëve nga radikalizimi; Dokument udhëzues me hapa për specialistët dhe politikëbërësit* 10 hapat shpjegohen dhe ilustrohen me shembuj praktikë. Në këtë dokument të RAN janë ndarë edhe parimet themelore që formojnë themelin e një përjasjeje të mirë për mbështetjen e familjes.²⁶



Hapi 1: Identifikimi i një rasti (të mundshëm) radikalizimi brenda familjes

²⁶ Shikoni Radicalisation Awareness Network (RAN). (2016). Dokument aktual, RAN YF&C dhe RAN H&SC: 'Working with families and safeguarding children from radicalisation'. Marrë nga https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-hand-sc/docs/ran_yf-c_h-sc_working_with_families_safeguarding_children_en.pdf.

Lexim i mëtejshëm: Puna me familjet dhe mbrojtja e fëmijëve nga radikalizimi: Ky [dokument aktual i RAN ofron një përjasje me 10 hapa ndaj mbështetjes së familjeve](#) që aplikohet gjithashtu edhe për familjet e luftëtarëve të huaj terroristë dhe luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer.

Metodat e mbështetjes së familjeve: Për këshilla rreth ndërtimit të kapaciteteve dhe metodat në mbështetjen e familjeve shikoni këtë [dokument aktual të RAN: Mbështetja e familjes: çfarë funksionon?](#)

Përmbledhje e praktikave: Për më shumë shembuj të ndërhyrjeve dhe proceseve në lidhje me mbështetjen e familjeve shikoni kapitullin mbi mbështetjen e familjeve në Koleksionin e [RAN \(BE\) të përjasjeve dhe ndërhyrjeve](#).

Elementet shtesë që duhen marrë në konsideratë gjatë përfshirjes dhe/ose mbështetjes së familjes së një personi të kthyer:

- 1. Vlerësoni marrëdhënien mes personit të kthyer dhe familjes së tij dhe rrjetit social:** Marrëdhënia ka pësuar një tension të lartë. Personi i kthyer është larguar nga familja, mund të jetë izoluar përpara se të largohej, dhe ka qenë i larguar ndoshta me shumë pak kontakte. Gjithashtu, anëtarët e familjes mund të jenë zemëruar me presonin e kthyer dhe me faktin se ai/ajo është bashkuar me një organizatë terroriste dhe mund të ketë hasur vështirësi ose është mohuar prej tyre si rezultat i këtij vendimi. Anasjelltas, anëtarët e familjes mund ta mbështesin shumë të afërmin e tyre dhe e shohin atë si hero që ka bërë zgjedhjen e duhur. **Specialistët që punojnë me këto familje duhet të vlerësojnë marrëdhënien mes personit të kthyer dhe anëtarëve të familjes së tij/saj. A ka ende mes tyre marrëdhënie? Dhe nëse po, e çfarë natyre është ajo?** A është familja e gatshme të mbështesë personin e kthyer edhe nëse kjo nënkupton se të tjerët në komunitet do ta izolojnë ose dënojnë familjen për këtë veprim? A e mbështesin anëtarët e familjes grupin terrorist dhe vazhdimin e radikalizimit? Kini parasysh se situata e familjes mund të sjellë pikësëpari arsyet e lindjes së radikalizimit të personi i kthyer. Nëse familja nuk është opion kontakti, provoni të krijoni kontakt me persona të tjerë me të cilët personi i kthyer ka qenë i afërt më parë.

Këshillë nga një punonjës me përvojë i daljes: “Mbështetja e familjeve të luftëtarëve të huaj do të sjellë përfitime pasi luftëtarët të kthehen. Nëse këto familje kanë besim te organizata e daljes, ata mund të bëhen partnerë të rëndësishëm dhe të motivojnë personin e kthyer që të bashkëpunojë me programin.”

- 2. Tregohuni transparent rreth informacionit të grumbulluar dhe të ndarë me autoriteteve:** Ata që udhëtojnë drejt një territori terrorist zakonisht kanë njëfarë kontakti me anëtarët e familjes gjatë kohës që janë larguar. Kontakti është edhe më i mundur kur dikush provon të kthehet ose planifikon të kthehet. Prandaj është me vend që të kontaktohen anëtarët e familjes së atyre që janë larguar, dhe që të investohet në krijimin e një marrëdhënieje. Ata mund të kenë nevojë dhe mund të duan mbështetjen tuaj. **Kjo marrëdhënie mund të sjellë informacione të vlefshme** si dhe një mundësi për t’u përgatitur për një kthim relativisht të lehtë. Informacioni nga familja duhet të ndahet me policinë (lokale) dhe/ose autoritetet (lokale). Tregohuni i qartë me familjen se informacioni do të ndahet me autoritetet (lokale), dhe çfarë informacioni do të ndahet saktësisht. Kjo duhet të jetë transparente. Ju po punoni me një person që është bashkuar me një organizatë terroriste, dhe familja duhet të përballet me këtë fakt dhe pasojat e tij.

Rast studimor — lidhja me familjen e një personi që mund të kthehet

Vajza 17 vjeçare, u largua nga qyteti A drejt Sirisë në vitin 2013. U martua me një luftëtar të ISIS-it nga qyteti i saj gjatë kohës që ishte në Siri, megjithëse më parë nuk ishin të lidhur. Ata kanë tre fëmijë. Struktura e mbështetjes lokale është shumë e përfshirë me familjen. Kishte shqetësime specifike rreth motrës së vogël, që dukej vulnerabël. Situata është përmirësuar. Për shkak të kohëzgjatjes dhe intensitetit të përfshirjes me familjen, ka një lidhje të mirë. Vajza ka qenë në kontakt me prindërit e saj dhe ka tre-guar se dëshiron të kthehet. Megjithatë, ajo është kërcënuar rreth kësaj, duke përfshirë edhe nga bashkëshorti. Për shkak se familja e bashkëshortit jeton në të njëjtin qytet, ka tensione mes dy familjeve.

Mësimet e nxjerra:

- Është thelbësor menaxhimi i kujdesshëm i bashkëpunimit mes specialistëve. Në këtë rast, të dyja familjet mbështeten nga struktura e mbështetjes lokale. Megjithatë, ndarja e informacionit mes specialistëve të mbështetjes është sfiduese dhe nënkupton rreziqe.
- Rekomandohet që të mbështeten familjet me informacion rreth shkallës që mund të lehtësohet kthimi. Këtu, vajza u ka kërkuar prindërve para për t'u kthyer. Kuadri ligjor nuk është i qartë rreth pasojave të këtij veprimi (do të shihet si ndihmë për fëmijën apo si mbështetje për një grup terrorist?). Prindërit duan që veprimet e tyre “nën vëzhgim” të mos rrezikojnë fëmijën e tyre. Megjithatë, specialistët kanë këshilluar që të dokumentohet i gjithë komunikimi dhe transaksionet e tyre. Pas këshillimit me qeverinë kombëtare, familjes i janë dërguar udhëzime shumë specifike se si të transferojnë paratë.
- Informacioni duhet të menaxhohet me shumë kujdes. Në këtë rast, policia do të donte më shumë informacion nga kontakti për të vlerësuar situatën dhe rrezikun. Prindërit kanë frikë se komunikimi me vajzën e tyre po monitorohet dhe nuk duan të rrezikojnë atë apo nipërit e mbesat. Familja e burrit po përhap fjalë se vajza është ende në një pozicion drejtues brenda forcës policore të grave të ISIS-it. Nuk është e qartë nëse ky informacion është i vërtetë.
- Fëmijët mund të mbrohen nëse ka një marrëveshje se ku do të jetojnë ata përpara se të kthehen. Nëse vajza në këtë rast kthehet me fëmijët, ka shqetësime rreth kujdestarisë sepse familja e burrit mund të dojë të ketë kujdestarinë. Përveç rrezikut të një lufte rreth kujdestarisë, tensionet mes familjeve mund të kenë ndikim negativ te fëmijët.
- Ka një nevojë të fortë për një kuadër ligjor më të qartë, edhe në nivel specialistësh. Duhet të përcaktohen këshilla dhe mbështetje ligjore për të mbështetur dhe mbrojtur specialistët nëse ata përfshihen në çështje gjyqësore, dhe kur u kërkohet specialistëve të këshillojnë familjet rreth situatave me pasoja ligjore. Kjo bëhet për të shmangur që specialistët të kenë përgjegjësi individuale ligjore.
- Rastet e personave të kthyer janë bërë shumë më konkrete. Ndërkohë që më parë disa familje dorëzoheshin dhe thoshin “të ndodhë ç’të ndodhë”, tani ato kërkojnë që t’i kthejnë anëtarët e familjes, dhe ka më shumë të ngjarë që të kthehen.

- 3. Informoni familjet rreth pasojave ligjore të ofrimit të ndihmës për fëmijët:** Prindërit dhe anëtarët e familjes zakonisht janë shumë të përfshirë në përpjekjet për të kthyer fëmijën e tyre (edhe nëse ai/ajo është i rritur). Ata kanë tendencën të kërkojnë mënyra të ndryshme për të ndihmuar dhe për të përshpejtuar kthimin, për shembull duke dërguar para dhe duke udhëtuar vetë në Turqi dhe Siri. Kuadri ligjor dhe jurisprudenca rreth këtyre veprimeve ndryshon sipas shtetit. Prandaj, specialistët e mbështetjes së familjeve do të trajnohen dhe informohen rreth pasojave ligjore të këtyre veprimeve në shtetet e tyre në mënyrë që t’i këshillojnë familjet përkatësisht. Është i detyrueshëm bashkëpunimi i ngushtë mes specialistëve dhe qeverisë rreth temës së ofrimit të ndihmës për t’u kthyer dhe/ose dërgimit të parave.

Rast studimor — pagesë për kthim të paligjshëm?

Një grua nga qyteti B udhëtoi drejt Sirisë dhe u martua me një burrë nga qyteti A. Ajo u mohua nga familja e vet në qytetin B, por vjehrra e saj që jeton në qytetin A ka lidhje të forta me të. Burri i saj vdiq në luftë. Gruaja është shprehur se dëshiron të kthehet. Ajo ka edhe fëmijë dhe vjehrra është shprehur se dëshiron të ofrojë kujdesin e nevojshëm për fëmijët. Vjehrra e di gjithashtu se familja e një gruaje tjetër nga qyteti B ka udhëtuar drejt Sirisë. Familja e kësaj gruaje tjetër mori të njëjtat udhëzime për të dërguar para njësoj si informacioni që mori vjehrra. Por, ky informacion nuk mund të ndahet me familjet për arsye sigurie. Ka shqetësime rreth ligjshmërisë së kërkesës, a do ajo vërtet të kthehet apo thjesht do paratë? Gruaja nga qyteti B ndërkohë ka gjetur strehim pranë një familjeje siriane që kujdeset për të dhe fëmijët e saj. Ajo është shprehur se madje dëshiron që t'i çojë fëmijët përpara në Turqi që të jenë të sigurt. Vjehrra është gati të udhëtojë drejt Turqisë për t'i marrë fëmijët.

Mësimet e nxjerra:

Është e rëndësishme që të theksohen avantazhet e kthimit të organizuar dhe e menaxhimit të pritshmërive. Në shtetin nga vjen kjo familje, metoda e përdorur është që personat që dëshirojnë të kthehen nga Siria ose Iraku me fëmijë që të regjistrohen pranë konsullatës së atij shteti. Fëmijëve u testohet ADN-ja për të përcaktuar lidhjen biologjike me prindërit përpara se familja të jetë në gjendje të udhëtojë. Duke qenë se duhet kohë që të dalin këto rezultate, familjet mund të mos jenë të gatshme të presin dhe rritet rreziku i marrjes së situatës në dorën e tyre. Familja e personit të kthyer dhe anëtarët e tjerë të familjes duhet të informohen rreth pritjes, që të jenë të përgatitur. Përfitimet e kthimit të organizuar përfshijnë udhëtimin e mbrojtur dhe më pak të rrezikshëm, mbështetjen e menjëhershme për fëmijët, përgatitjen më të mirë për qëndrimin e fëmijëve brenda familjes.

4. Kini kujdes për rreziqet shtesë ndaj të cilave ekspozohen personat e kthyer dhe familjet e tyre:

- personi i kthyer mund të jetë i paqëndrueshëm mendërisht, i traumatizuar ose ende i zemëruar me familjen dhe mund të përpiqet t'i dëmtojë ata;
- organizata terroriste mund të dojë të hakmerret ndaj personit të kthyer që po largohet dhe kërcënon personin e kthyer dhe familjen e tij/saj;
- ISIS-i i konsideron fëmijët e (ish) luftëtarëve të ISIS-it si pronën e vet dhe ka kërcënuar personin e kthyer dhe familjen e tij/saj, duke kërkuar që t'i detyrojë të kthejnë fëmijët në disa raste.
- komuniteti mund të dojë të hakmerret kundër personit të kthyer që është bërë pjesë e një organizate terroriste, dhe/ose familjes për të mbështetur personin e kthyer.

Këto rreziqe duhet të diskutohen në ekipin lokal të ndërhyrjes multi-agjenci dhe nëse nevojitet me qeverinë. Policia e shtetit dhe ajo lokale dhe profesionistët e shëndetit mendor mund të ndihmojnë në vlerësimin e situatës dhe në zbutjen e rreziqeve.

- 5. Merrni në konsideratë pozicionin e familjes në komunitetin më të gjerë:** Në varësi të situatës në komunitet, familja e personit të kthyer mund të izolohet ose ndaj tyre mund të ketë mosbesim të thellë, duke qenë se i afërmi i tyre është pjesë e një organizate terroriste. Nëse është kështu, mbështeteni familjen në integrimin e tyre duke zhvilluar një plan specifik riintegrimi për ta. Mos harroni se kjo ka nevojë për bashkëpunim multi-agjenci dhe mundësisht një ekspert komunikimi për të ndihmuar komunikimin e situatës së familjes në një shkallë më të gjerë (por ende lokale).

Praktika në veprim:

Mbështetja në parandalim: Përmes një linje telefonike ndihme falas, qeveria franceze ofron mbështetje të menjëhershme për prindërit, të afërmit ose personat e afërt të individëve që përpigën të udhëtojnë drejt Sirisë ose Irakut, ose që kthehen nga ISIS-i. Linja e ndihmës mund të telefonohet për ndihmë ose për informacion të menjëhershëm. Telefonuesi, nëse është e nevojshme, do të lidhet me një ekip rajonal veprimi. Kjo linjë ndihme mund të kontaktohet gjithashtu për informacion ose mbështetje në rastin e sinjaleve rreth personave (që mund të jenë) të radikalizuar në përgjithësi.

Mbështetja për prindërit e luftëtarëve të huaj terroristë: Rrjeti i Parandalimit të Dhunës (Gjermani), ka këshillim familjar për të ofruar mbështetje për prindërit e të rinjve dhe/ose luftëtarëve të huaj të radikalizuar. Shikoni: Këshillimi për familjen - Mbështetja për prindërit e "luftëtarëve të huaj" ose të rinjve në rrezik për t'u radikalizuar.

Mentorimi dhe këshillimi i prindërve: Ky manual danez rreth implementimit të përpjekjeve lokale në fushën e mentorimit, këshillimit të prindërve dhe mbështetjes së të afërmeve ofron një përshkrim praktik dhe të zgjeruar të disa ndërhyrjeve dhe mjeteve të vlerësimit. Shikoni Qendrën Daneze për Parandalimin e Ekstremizmit, Përpjekjet e mentorimit dhe këshillimit të prindërve dhe të afërmeve dhe rrjetet e kujdestarëve Puna e fokusuar te zgjidhja mbi aftësitë bazë të jetës.

Trajnimi për rezistencën: Qeveria belge, e financuar nga BE-ja, zhvilloi një program trajnimi për rezistencën për të rinjtë në rrezik dhe anëtarët e familjeve të tyre. Ai quhet Bounce. Programi mund të përdoret nga çdo shtet dhe përfshin udhëzime për "trajnimin e trajnuesve".

Qendra e Mbështetjes së Familjes: Qendra Holandeze e Mbështetjes së Familjesë shembull se si të mbështeten familjet e personave të radikalizuar (duke përfshirë luftëtarët e huaj terroristë)

Shërbimi i këshillimit rreth radikalizimit: Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF) ofron mbështetje për anëtarët e familjeve dhe miqtë e personave që janë radikalizuar ose janë në procesin e radikalizimit. Që prej vitit 2012, qendra e këshillimit ka shërbyer si pika e parë e kontaktit, duke u dhënë familjeve njohuri të përgjithshme mbi islamizmin, duke u dhënë këshilla individëve dhe madje duke ndihmuar prindërit ose të afërm të tjerë të të rinjve që janë nisur për në Siri ose Irak, ose që janë kthyer nga këto vende. Këshillimi jepet nga partnerë me përvojë të shoqërisë civile në nivel lokal. Së bashku me shtetet federale, është ndërtuar një rrjet mbarëkombëtar, që zgjerohet dhe përmirësohet vazhdimisht.

Lexim i mëtejshëm: Parimet për riintegrimin: Për më shumë informacion në lidhje me riintegrimin e personave të kthyer, shikoni: Parimet e Maltës për riintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer.

6.2.2 Mentorimi dhe këshillimi

Kur personi i kthyer është i gatshëm të riintegrohet, janë thelbësorë gjatë këtij procesi mentorimi dhe këshillimi. Ai ose ajo ka nevojë të integrohet dhe të riprezantohet në komunitet, të fqinjët, punëdhënësit dhe ndoshta madje edhe të shumë agjenci dhe organizata tregtare (bankat, kompanitë e sigurimit etj.). Në këtë pjesë do të shohim reagimet e mentorimit dhe të këshillimit ndaj personave të kthyer.

Rasti studimor – roli i mentorimit

Një 18-vjeçar frekuenton shkollën e mesme dhe xhaminë lokale. Ai bëhet anëtar i një grupi radikal të rinjsh selafistë. Ndërsa ai bëhet gjithnjë e më i radikalizuar, në sjelljen e tij ka ndryshime dramatike. Ai ndryshon nga një person i drejtpërdrejtë, i këndshëm dhe i dedikuar në një person të mbyllur dhe të tërhequr. Ai është parë disa herë si spektator mbështetës gjatë një gjyqi për terrorizmin. Ai lë shkollën dhe punën në një supermarket lokal. Në maj 2013 ai largohet për në Siri me një shok. Familja lihet e shokuar dhe ndihet shumë e pasigurt. Fillojnë bisedimet mes një koordinatori lokal të luftës kundër terrorizmit të dhunshëm dhe prindërve. Prindërit ftohen që të marrin pjesë në rrjetin e prindërve lokalë, dhe i frekuentojnë shpesh takimet. Gjashtë muaj pas nisjes, 18-vjeçari kthehet. I ati kontakton menjëherë koordinatori lokal. Të nesërmen, koordinatori lokal takohet me personin e kthyer dhe të atin e tij. Ai duket i lodhur fizikisht dhe emocionalisht. Personi i kthyer është i hapur, miqësor dhe i gatshëm dhe deklaron se “do që të ketë sërish jetën që kishte”. Personi i kthyer është jashtëzakonisht mirënjohës për pritjen pas kthimit dhe të gjitha shenjat e radikalizimit janë zhdukur. Pak javë më vonë personi i kthyer prezantohet me mentorin e tij. Ai lejohet gjithashtu që të kthehet në shkollë me kushtin e mentorimit dhe këshillimit. Kjo ishte shumë e suksesshme, dhe në verën e vitit 2016, ai diplomohet si nxënës i shkëlqyer.

Mësimet e nxjerra:

- Përgatituni të investoni në marrëdhëniet me familjen dhe personin e kthyer në mënyrë që të adresohen temat ideologjike dhe teologjike brenda një skeme mentorimi.
- Ky rast ilustron rëndësinë e krijimit të kontaktit me familjen dhe përfshirjen e tyre herët në këtë proces. Kjo sjell fryte më vonë.
- Mentorimi është thelbësor në drejtimin e personit të kthyer dhe për të siguruar që ai plotëson angazhimet e marra

Mentorimi dhe këshillimi i një personi të kthyer ndërsa ai ose ajo kthehet në shoqëri quhet edhe punë për daljen nga radikalizimi. Ndërrhyrjet e daljes dhe mjetet e përdorura gjatë ofrimit të ndihmës për personat e radikalizuar që duan të dalin nga organizata e dhunshme ekstremiste ku ata bënë pjesë, janë gjithashtu të dobishme gjatë punës me një person të kthyer. Shikoni kapitullin 5 për më shumë informacion rreth programeve të mentorimit.

Praktika në veprim:

Programi i daljes me katër hapa për personat e kthyer: Aarhus, ka zhvilluar një program daljeje me katër hapa për personat e kthyer. Një përshkrim i programit jepet në fq. 8 të [Dokumentit aktual të RAN, Hartimi i një ndërhyrjeje për daljen](#).

Këshillimi dhe deradikalizimi: Organizata gjermane Hayat ofron programe këshillimi për personat e përfshirë në grupet radikale selafiste ose në rrugën drejt radikalizimit të dhunshëm xhihadist, duke përfshirë ata që udhëtojnë drejt Sirisë dhe zonave të tjera të luftimeve. Shikoni [uebsajtin](#) e tyre për më shumë informacion.

Këshillimi në rastin e ekstremizmit: Qendra Austriake për Informacion rreth Ekstremizmit ofron këshillim individual, ekspertizë si edhe seminare dhe leksione për të ndihmuar të afërmit, punonjësit socialë, mësuesit ose çdo person tjetër që shqetësohet se dikush mund të jetë bashkuar me një grup ekstremist. Shërbimi këshillues është falas, anonim dhe konfidencial. Më shumë informacion në këtë [uebsajt](#).

Puna në rrugë dhe këshillimi: Kitab, një ekip në VAJA e.V në Bremen (Gjermani), punon për të luftuar proceset e radikalizimit që ndikojnë te të rinjtë në kontekstin e islamizmit fundamentalist dhe sefalizmit. Ata ofrojnë këshillim për personin e radikalizuar dhe prindërit e tij/saj, të afërmit ose persona të tjerë që i përkasin rrethit të tyre shoqëror. Për më shumë informacion, [kontaktoni me VAJA](#).

Së bashku me tetë aspektet që duhen marrë në konsideratë gjatë hartimit dhe ofrimit të ndërhyrjeve specifike për personat e kthyer në paragrafin 6.1, ka dy elementë të tjerë që duhen konsideruar gjatë mentorimit të një personi të kthyer.

- **Tregohuni të qartë rreth objektivave dhe qëllimeve:** Përpara se të filloni një projekt mentorimi me një person të kthyer, formuloni objektiva dhe qëllime të qarta për këtë mentorim. Një numër specialistësh vërejtën se është e vështirë të përcaktohet nëse dhe kur është arritur objektivi i mentorimit për personat e kthyer. Ata kanë raportuar se nevojat për mentorim janë të pafundme. Duhet të formulohen objektiva dhe qëllime të qarta për të parandaluar një situatë në të cilën mentorimi mbetet tepër i cekët dhe jo sfidues sa duhet për personin e kthyer. Kjo nuk do të mbështesë riintegrimin e duhur në shoqëri.

Rast studimor - person i kthyer shtatzënë me një luftëtar të huaj terrorist të njohur

Një grua në të 20-at ndoqi të shoqi në Siri në vitin 2015 për të qëndruar me të në territoret e pretenduara nga ISIS-i. Gjashtë muaj pasi mbërriti, i shoqi i saj vdiq. Me ndihmën e një anëtarit të familjes që udhëtoi për në Turqi dhe përdori kontaktet e tij atje, ajo u kthye në vendin e saj shtatzënë. Ajo pretendonte se nuk kishte luftuar. Ajo u largua pasi i shoqi vdiq dhe nuk donte të martohej me një burrë tjetër nga ISIS-i. Pas kthimit, ajo u arrestua për një kohë të shkurtër dhe iu konfiskua pasaporta. Kur u kthye në qytetin e saj, kontaktoi me të një punonjëse sociale nga komuna, e informuar paraprakisht nga qeveria për kthimin e saj. Kjo specialiste e vijës së parë kontrolloi nëse gruaja ishte mendërisht e gatshme të bëhej nënë. Ajo dukej e gatshme, por kishte shenja depresioni dhe traume. Specialistja kishte frikë se gruaja do të kthehej te ISIS-i në momentin që do të lindte fëmija. Për këtë grua u përgatit këshillim individual. Familja e saj dhe ish-shoqet e mbështetën atë gjatë gjithë kohës. Në vitin 2016 gruaja lindi. Në të njëjtën kohë, ISIS-i njoftoi se fëmija ishte i tyre. Ata e kërcënuan gruan dhe familjen e saj. Në vitin 2017 duket se gruaja ka për qëllim të qëndrojë, po planifikon të kthehet në shkollë dhe të përshtypje më të mirë dhe me më pak depresion. Rreziku që ISIS-i të rrëmbejë fëmijën duket se është reduktuar. Por, i ati i fëmijës është i njohur mes ndjekësve të ISIS-it, ai kishte një funksion goxha të lartë te ISIS-i përpara se të vdiste dhe admirohej, prandaj fëmija mund të marrë vëmendje të madhe.

Mësimet e nxjerra:

1. Mbështetja nga anëtarët e familjes është thelbësore gjatë riintegrit në shoqëri. Kjo grua u kthye në një mjedis të hapur ku gjeti falje, dhe ishte shumë e dobishme që shoqet e saj e mirëpritën kthimin e saj.
2. Rreziku i sigurisë është çështje thelbësore. Është e dobishme që të merret vëmendje dhe mbështetje financiare, por kjo e bën ndarjen e informacionit shumë të vështirë. Shërbimet e inteligjencës dhe policia nuk i japin lehtë informacionet sepse shumica janë të klasifikuara. Kjo e bën shumë të vështirë vlerësimin e një çështjeje. Në këtë rast, kërcënimi ISIS-it dhe pretendimi për fëmijën rritën rrezikun e sigurisë edhe më shumë. Do të ishte e dobishme nëse ndarja e informacionit mund të ishte më transparente dhe më e shpejtë.
3. Kur duhet ndaluar mentorimi? Me rastet e personave të kthyer është e vështirë të vlerësohet se kur një individ është integruar brenda shoqërisë. Për sa kohë që ata mund të udhëtojnë drejt ISIS-it ose të kontaktohen nga ISIS-i, është mirë që të tregohet shumë kujdes.

Siguria: Mentorimi dhe këshillimi për një person të kthyer që të largohet nga organizata terroriste ku ai/ajo ishte pjesë, nënkupton se do të punoni me individë që janë mësuar me dhunën dhe krimet. Rreziku i dhunës kundër specialistit të përfshirë është shumë real dhe duhet të merret seriozisht. Rreziku do të ndryshojë sipas rastit dhe organizatës. Përmbledhja në Figurën 6 përshkruan masat e sigurisë që do të implementohen nëse situata e kërkon.



Zyra

- Mos e komunikoni adresën e zyrës suaj në internet ose fizikisht (me tabelë).
- Mbajini dokumentet dhe dosjet delikate të siguruara në zyrë.
- Punësoni personel sigurie.



Komunikimi

- Rregulloni informacionin. Mos i ndani informacionet delikate me mjete të pasigurta.
- Mos përdorni telefona privatë për punë.
- Kontrolloni informacionin: Kush di çfarë?



Mbajtja e personelit

- Fshini adresat e shtëpisë së anëtarëve të personelit.
- Mbajini kolegët të informuar rreth takimeve dhe vendndodhjeve të njëri-tjetrit.



Rastet me rrezikshmëri të lartë

- Bashkëpunoni me agjencitë e sigurisë.
- Krijoni disinformacion për të ngatërruar grupet e mëparshme.
- Formoni plane emergjence dhe struktura kontakti.



Menaxhimi i çështjes

- **Analizoni kërcënimet:** grupet, personat, rolet, njohuritë e rrezikshme, historikun.
- **Mbrojtja:** përgatitni një plani informues dhe masat për procedurën e daljes.



Mbrojtja e individit

- I thoni individit të mbajë shënim të gjitha kërcënimet.
- Jepini atij një ditar.
- Zhvendosini ata në një mjedis të ri.
- Krijoni një mjedis të sigurt ku klienti mund të ndajë historinë e tij/saj.

Figura 6: Mbajtja e të gjithëve të sigurt

Këshillë nga një specialist me përvojë: “Siguria e specialistëve të vijës së parë të përfshirë në rastet e personave të kthyer duhet të rivlerësohet. Ata kanë nevojë gjithashtu të marrin trajnim, informacion dhe shpjegime nga ekspertët kompetentë. Ata që kanë më shumë njohuri dhe ekspertizë janë zakonisht nga shërbimet e sigurisë dhe institucionet e arsimit ushtarak. Megjithatë, ata që takohen shpesh ballë për ballë me personat e kthyer, si specialistët, zakonisht nuk kanë njohuri rreth sfidave dhe dilemave të sigurisë.”

- **Bindjet e forta:** Shumica e personave të kthyer ende kanë ose kanë pasur një bindje të fortë ideologjike, duke përfshirë pikëpamje rreth mënyrës se si duhet të funksionojë shoqëria, dhe bindje shumë dogmatike, për shembull, rreth demokracisë, orientimit seksual, rolit të grave dhe arsimit. Për t’u integruar me sukses brenda shoqërisë ai/a jo duhet të jetë i ndërgjegjshëm për faktin se opinioni që ka mund të mos jetë i njëjtë me atë të shumicës së komunitetit në të cilin ai/a jo po integrohet. Gjatë mentorimit të tyre, përgatituni të përdorni teknika dhe ndërhyrje deradikalizimi që përdoren gjatë përbaljes me bindje të forta. Nëse është nevoja, mund të nxirren mësim nga ato organizata që mbështesin ekstremistët e djathtë në riintegrimin e tyre, ose ndërhyrjet që janë përdorur për të riintegruar anëtarët e IRA-s ose ETA-s.²⁷

Më shumë informacion rreth mentorimit dhe këshillimit [në paragrafin 5.5](#).

²⁷ Për shembull, Exit Germany, një organizatë që mbështet ekstremistët e djathtë që duan të largohen nga grupi i tyre i ekstremit të djathtë <http://www.exit-deutschland.de/english/> ose për më shumë informacion rreth shkëputjes së anëtarëve të IRA-s, shikoni Fergusson, D.M., Swain-Cambell, N.R. dhe Horwood, J. (2001) Deviant Peer Affiliations, Crime and Substance Use: A Fixed Effects Regression Analysis. Journal of Abnormal Child Psychology, vol.30 (4) fq. 419–430.

Lexim i mëtejshëm: Programet e mentorimit: ky manual danez rreth implementimit të përpjekjeve lokale në fushën e mentorimit, këshillimit të prindërve dhe mbështetjes së të afërmeve ofron një përshkrim praktik dhe të zgjeruar të disa programeve të mentorimit. Shikoni Qendrën Daneze për Parandalimin e Ekstremizmit, **Përpjekjet e mentorimit dhe këshillimit të prindërve dhe të afërmeve dhe rrjetet e kujdestarëve Puna e fokusuar te zgjidhja mbi aftësitë bazë të jetës.**

Praktika shitesë: Për më shumë shembuj të ndërhyrjeve dhe proceseve mbi mentorimin dhe punën e daljes, shikoni **kapitullin rreth strategjive të daljes** në Koleksionin e RAN të përjasjeve dhe praktikave.

6.2.3 Reagimet për shëndetin mendor

Personat e kthyer kanë më shumë mundësi që të vuajnë nga probleme të shëndetit mendor sesa një person mesatar. Qëndrimi për periudha të gjata kohe në territoret e kontrolluara nga terroristët dhe në zonat e konflikteve, mund të lënë gjurmë të konsiderueshme psikologjike. Shumë prej njohurive tona rreth kësaj vijnë nga traumat e shkaktuara nga konfliktet që vuajnë forcat e rregullta të armatosura.²⁸ Ekziston rreziku i çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD) mes atyre që kthehen nga zonat e konflikteve, qoftë kur kanë luftuar ose jo, që mund t'i lërë ata të traumatizuar, vulnerabël ndaj radikalizimit dhe ndoshta mund t'i bëjë rrezik për veten ose shoqërinë. **Ndërkohë që PTSD është në fund të spektrit, ata që kthehen nga zonat e konflikteve mund të jenë gjithashtu subjekt i një game të gjerë problemesh të shkaktuara nga traumat²⁹:**

- **Fizike:** vështirësi për të fjetur, lodhje e madhe; shqetësime të stomakut; dhimbje koke dhe djersitje kur mendojnë rreth luftës; rrahje zemre ose frymëmarrje e shpejtë; përkeqësim i problemeve ekzistuese shëndetësore; ndjenja shoku, mpirje, pamundësi për t'u ndier i lumtur.
- **Reagimet e zakonshme mendore dhe emocionale:** ëndrra të këqija, makthe; përjetime të ngjarjeve të së kaluarës ose kujtime të shpeshta të padëshiruara; zemërim; nervozizëm, mungesë shprese ose frikë; ndjenja faji për veten, turp; mërzitje, ndjesi refuzimi apo braktisjeje; acarim dhe zemërim i menjëhershëm; mungesë shprese për të ardhmen.
- **Reagimet e sjelljes:** vështirësi në përqendrim; acarim i menjëhershëm; gjithmonë vigjilentë, shqetësim i tepruar rreth sigurisë; shmangia e vendeve ose personave që lidhen me traumën; konsumim i lartë i alkoolit, ose i duhanit apo drogave; dietë ose higjienë personale të keqe; vështirësi në kryerjen e detyrave të zakonshme në punë ose shkollë; drejtimi i makinës me agresivitet.

Psikologët që punojnë me personat e kthyer raportojnë gjithashtu se disa vuajnë më shumë nga “dëmtimi moral” sesa nga PTSD: sistemi i tyre i bindjeve është ndryshuar nga ajo që kanë parë në Siri/Irak ose zona të tjera konfliktit, që bën që ata të vënë në dyshim **imazhin moral që kanë rreth botës dhe sistemit të bindjeve**. Ata mund të kenë gjithashtu një ndjesi tradhtie pasi janë ekspozuar ndaj realitetit të konfliktit, ose janë zhgënjyer me vetë kauzën radikale. Këto reagime janë në një farë sensi diçka e mirë; ato ofrojnë një mundësi për ndërhyrje. Por nëse nuk mbështeten, këta persona janë gjithashtu edhe vulnerabël.³⁰

Përveç problemeve psikologjike që shkaktohen nga qëndrimi në territoret e kontrolluara nga terroristët, studimet tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e luftëtarëve të huaj terroristë vuajnë nga **probleme të shëndetit mendor**. Të dhëna nga tre Shtete anëtare të BE-së tregojnë se deri në 20% të luftëtarëve të huaj terroristë vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Zvicra konstaton se mes 15 dhe 20% të tyre kanë probleme të shëndetit mendor, ndërsa në Holandë, studimet tregojnë se 60% e individëve që njihen ose dyshohen si radikalë xhihadistë vuajnë nga probleme të shëndetit mendor.³¹

²⁸ Briggs Obe, R., Silverman, T. (2014), Foreign Fighters Innovations in Responding to the Threat, Institute for Strategic Dialogue.

²⁹ US Department of Veterans Affairs (2010), Returning from the War Zone: A guide for military personnel.

³⁰ Briggs Obe, R., Silverman, T. (2014), Foreign Fighters Innovations in Responding to the Threat, Institute for Strategic Dialogue.

³¹ Paulussen C., Nijman, J. and Lismont, K., (2017), Mental Health and the Foreign Fighter Phenomenon: A Case Study from the Netherlands, ICCT Report and Mehra, T., (2016), Foreign Terrorist Fighters: Trends, Dynamics and Policy Responses, ICCT Policy Brief.

Praktika në veprim: Këshillimi në shumë nivele: Organizata franceze **CAPRI** ka zhvilluar ndërhyrje për të shkëputur personat e radikalizuar. Ajo ofron programe mentorimi, familje mbështetëse, ofron këshillim psikologjik dhe punë me ekspertë teologë. Ndërhyrjet përshtaten sipas nevojave të personit të radikalizuar.

Duke marrë në konsideratë mundësinë e lartë të problemeve të shëndetit mendor, është thelbësor që të kryhet kontrolli për gjendjen mendore.

Kontrolli i shëndetit mendor për personat e kthyer³²

1. Sociale:

- a) Cila është situata e tij/saj aktuale në lidhje me anëtarët e familjes, miqtë, arsimin, aktivitetet e përditshme, gjendjen e jetesës, gjendjen financiare dhe fenë ose ideologjinë?
- b) Cila ishte situata gjatë kohës që ata ishin larguar, në lidhje me anëtarët e familjes, miqtë, arsimin, aktivitetet e përditshme, fenë ose ideologjinë?

2. Somatike: cili është statusi aktual i shëndetit? A ka ankesa mjekësore? (lodhje, dhimbje në krahë, dhimbje koke, shikim i turbullt etj.).

3. Psikiatrike: cila është gjendja aktuale mendore? (irritim, luhajtje të humorit, vështirësi në të fjetur, shqetësime, agresivitet etj.). Kontrolloni gjithashtu për vartësi dhe testoni IQ-në e personit të kthyer.

4. Analizoni: peshoni të gjitha faktet dhe arrini një draft-konkluzion të parë.

5. Kontrolloni për së dyti: kërkojini një kolegu të analizojë këtë çështje dhe kombinoni konkluzionet.

6. Diskutoni konkluzionet në një ekip lokal të ndërhyrjes multi-agjenci, ata mund t'ju japin input të vlefshëm në lidhje me personin e kthyer dhe risocializimit të tij/saj. Gjithashtu diskutoni ndërhyrjet dhe trajtimet e mundshme.

7. Hartoni një konkluzion përfundimtar dhe, nëse nevojitet, zhvilloni ndërhyrjen dhe filloni trajtimin.

Kur zhvillohet një reagim për shëndetin mendor të personave të kthyer, është e rëndësishme që të merren në konsideratë pesë aspektet e mëposhtme³³:

- Mos supozoni se e kuptoni personin e kthyer. Motivet ndryshojnë dhe disa persona të kthyer mund të mos i kenë kuptuar thellë vetë motivet e tyre. Supozimet mund të formojnë barriera në ndërtimin e marrëdhënieve me personin e kthyer.
- Gjendjet traumatike mund të jenë të vështira të vlerësohen dhe shpesh neglizhohen, keqinterpretohen ose nuk zbulohen. Gjithashtu, trauma nuk vetëmanifestohet menjëherë. Prandaj, mënyrat për të dalluar dhe vlerësuar traumën duhet të përfshihen në trajtimin për personat e kthyer. Profesioni i shëndetit mendor që do të punojë me personin e kthyer mund të përgatitet duke kontaktuar një ekspert të traumës.
- Disa persona të kthyer do të kenë nevojë për trajtim dhe/ose mjekim profesionist afatgjatë. Organizojeni këtë nëse nevojitet; mungesa e trajtimit ose trajtimi i pamjaftueshëm rrit rrezikun.
- Për të trajtuar me sukses një person të kthyer, nevojitet një përqasje e koordinuar dhe holistike që targeton aspekte të ndryshme. Nëse trajtimi nuk koordinohet me kujdes, ai mund të krijojë konfuzion dhe irritim te personi i kthyer si edhe mund të pengojë efektet e ndërhyrjes. Diskutoni trajtimin brenda ekipit lokal multi-agjenci.
- Nevojitet durim dhe kohë. Proceset psikologjike shpesh janë të vështira, duan kohë dhe nevojat mund të luhaten. Prandaj, aksesit të shërbimit duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i lehtë.

³² Elementet e mjetit të kontrollit të shëndetit mendor për personat e kthyer bazohen në intervistat me specialistët e shëndetit mendor.

³³ Këto opinione vijnë nga një profesionist me përvojë i shëndetit mendor që ka punuar me një numër personash të kthyer.

Rast studimor, luftëtar i huaj terrorist me çrregullim personaliteti shmangës

Mashkull, lindur në vitin 1993. Babai i varur ndaj drogës (kokainë, shkelës serial) dhe i rritur nga nënë e vetme. Babai ka abuzuar fizikisht me të ëmën, që solli kontaktin e parë me ofruesit e shëndetit mendor (këshillim për shkak të abuzimit). Nëna kishte shumë borxhe, filloi të jetojë me punëdhënësin e saj, u martua me të. Personi ndihej xheloz dhe i shpërfillur, filloi të pijë, të tymosë kanabis, krijoi shumë probleme në shkollë. Zemërimi i tij u kanalizua te grupet e gabuara. Në përgjithësi filloi të mos çojë asgjë deri në fund (shkollën, kurset, punët etj.) Ai u vendos nën përkujdesje (duke jetuar në një institucion) në moshën 16 vjeçare, u largua drejt një ambienti më të hapur në moshën 17 vjeçare dhe u konvertua në mysliman në moshën 18 vjeçare. Kur ishte me pushime me të ëmën, njohu një vajzë të konvertuar dhe të ëmën e saj dhe u martua brenda një viti. Disa muaj më vonë, kur sapo ishte bërë baba, ai udhëtoi drejt Sirisë (dhjetor 2012). Historia e tij, siç e tregon ai, është si vijon:

Ai shkoi në Siri duke besuar se do të niste një jetë të re në një vend islamik, me çmime ekonomike dhe të sistemuar mirë. Gruaja dhe fëmija e ndoqën pas pak pasi ai ishte sistemuar. Kur pa Sirinë në realitet (veçanërisht vendndodhjen e dytë), atë e zuri një ankth i madh për shkak të zhvillimit të shpejtë të luftës dhe luftimeve të vazhdueshme; ai u tha “eprorëve” në Siri se donte të kthehej në vendin e tij. Ai u mor në pyetje nga këta “eprorë” çdo ditë për shumë javë. Ata dyshoni se ai ishte informator për shërbimin e inteligjencës së vendit të tij. Pasi u mor në pyetje për 2 muaj e gjysmë, ai mori leje për t’u larguar. Në total, ai qëndroi katër muaj në Siri në vitet 2012 – 2013 si pjesë e “brezit të parë” të atyre që shkuan në Siri. Nuk ka detaje se si u kthye. Në vendin e tij ai u ndoq penalisht dhe u dënua për pjesëmarrje aktive në një rrjet terrorist dhe u burgos për një periudhë të shkurtër. Kur ai u kthye ai mori trajtim mendor për PTSD, por i ndaloi ilaçet pas dy ditësh sepse “kishin shije të keqe”. Më pas ai u referua te kujdesi i specializuar i traumës (EMDR), por nuk i pëlqeu lista e pritjes dhe nuk ndoqi trajtim të mëtejshëm. Që prej vitit 2016 ai ka jetuar me gruan dhe dy fëmijët në një apartament me qira. Atij i janë ofruar shumë vende pune, por ai nuk i mban për më shumë se dy javë. Ai është gjithashtu shumë i dhënë pas medias, u ka dhënë gazetarëve shumë intervista dhe gjithashtu dëshiron të publikojë librin e vet. Gjithashtu, ai pretendon se është kërcënuar nga një tjetër person i kthyer. Trajtimi i tij aktual mjekoligjor fokusohet te “ndërtimi i karakterit/identitetit”, gruaja trajtohet për anoreksi nervore dhe të dy fëmijët janë nën mbikëqyrje nga shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve. Pak javë më parë, shërbimet e inteligjencës kontaktuan me specialistin e shëndetit mendor që koordinon trajtimin e burrit. Ai po shoqërohet me një djalë më të ri, shumë të radikalizuar, dhe tani monitorohet nga qeveria dhe po zhvillohet një vlerësim i ri i rrezikut.

Mësimet e nxjerra:

- Disa persona të radikalizuar, kanë nevojë për mentorim gjatë gjithë jetës. Në këtë rast, një çrregullim personaliteti shmangës do të thotë se çdo lëvizje që bën ky person është “radikale” ose “drastike”; konkluzioni i përgjithshëm është se ky motiv reagues dhe një nivel i caktuar varësie (nga institucionet) do të qëndrojnë me të gjatë gjithë jetës, në kombinim me tendencën e fortë për të shprehur ndjenjat e këqija dhe për të manipuluar. Duke qenë se atij i mungon rezistenca ose identiteti vetjak, kjo do të mbetet një pikë e vazhdueshme fokusimi në trajtimin e tij, bashkë me të mësuarit për të parë pasojat e “vendimeve radikale”.
- Është e rëndësishme që t’u kushtohet vëmendje qëndrimeve cinike në lidhje me trajtimin dhe për të ricaktuar specialistët/menaxherët e çështjes. Një pjesë e problemit/çrregullimit të këtij personi është se ai i bën vazhdimisht të tjerët përgjegjës për rregullimin e problemeve të tij. Ai asnjëherë nuk merr përsipër përgjegjësitë dhe manipulon. Një moment “jeta e tij e re” i dorëzohet në dorë, dhe një moment më vonë ai bën një lëvizje tjetër drastike dhe krijon një sërë problemesh të reja. Kjo ka rezultuar në një qëndrim cinik mes të gjithë profesionistëve të përfshirë. Atë nuk e merr më asnjë seriozisht, gjë që krijon në vetvete rrezik.

6.2.4 Reagimet praktike


Personat e kthyer shpesh i ndalojnë të gjitha marrëdhëniet zyrtare dhe jozyrtare përpara se të udhëtojnë drejt territoreve të kontrolluara nga terroristët. Puna, strehimi, siguracioni dhe mirëqenia e tyre kanë ndaluar të gjitha sepse ata nuk janë të pranishëm ose nuk kanë paguar për një kohë të gjatë. Shumica e tyre nuk janë më të regjistruar si qytetarë në qytetin e tyre. Gjatë riintegritimit në shoqëri ata kanë nevojë për ndihmë që t'i organizojnë këto gjëra praktike dhe që ta bëjnë këtë proces sa më të shpejtë të jetë e mundur.

Këshillë nga një specialist me përvojë të vijës së parë: “Shpesh, personave të kthyer u mungon regjistrimi i duhur/i përditësuar në sistemin publik dhe prandaj nuk mund të marrin mbështetje dhe trajtim. Koha që duhet për të kaluar përmes një procesi të rregullt është tepër e gjatë, dhe kërkesat mund të refuzohen për shkak të mungesës së referimeve ose informacionit të pamjaftueshëm.”

Për çdo person të kthyer, duhet të hartohet një përmbledhje e nevojave më praktike. Shpesh personi që këshillon ose ofron mentorim për personin e kthyer do të ketë përmbledhjen më të mirë të asaj që nevojitet. Diskutoni fillimisht me këtë specialist dhe hartoni një përmbledhje të asaj që nevojitet. Kjo përmbledhje duhet të jetë në axhendë për takimin me ekipin lokal të ndërhyrjes multi-agjenci rreth këtij personi të kthyer.

Ana praktike

- Aspektet praktike kryesisht ndahen në tetë kategori.
- **Nisja:** nisuni duke u siguruar që personi i kthyer të regjistrohet në databazat e nevojshme kombëtare dhe lokale të qytetarëve.
- **Trajtimi i menjëhershëm:** vlerësoni nevojën për trajtim mjekësor për shkak të lëndimeve të luftës, sëmundjet ngjitëse ose çrregullimet mendore dhe referojeni përkatësisht. Trajtimet mund të jenë ofruar në momentin që personi i kthyer ka hyrë në vend.
- **Strehimi:** sigurohuni që vendndodhja në të cilën do të jetojë personi i kthyer është e sigurt për të dhe lagjen. Nëse është nevoja, siguroni strehim anonim për të shmangur çështjet e sigurisë duke përfshirë edhe shqetësimet e fqinjëve.
- **Financat:** ndihmoheni personin e kthyer të aplikojë, nëse është nevoja, për mbështetje financiare nga qeveria lokale ose kombëtare. Gjithashtu, ndihmoheni të hapë një llogari bankare, nëse nevojitet. Personat e kthyer mund të jenë në Listën e terroristëve të OKB-së si shumica e luftëtarëve të huaj terroristë. Nëse është kështu, asetet e tij/saj janë ngrirë. Ju duhet të kontaktoni me qeverinë për të nisur një procedurë të ashtuquajtur të heqjes nga lista. Kjo zgjat disa muaj. Ndërkohë, personi nuk do të jetë në gjendje të fitojë para, të hapë llogari bankare ose të ketë akses në llogarinë e tij/saj bankare.
- **Punësimi/arsimi:** ndihmoheni personin e kthyer të marrë pjesë në aktivitete të strukturuar të përditshme. Ai ose ajo duhet të punësohet ose të fillojë një kurs arsimor sa më shpejt të jetë e mundur.
- **Trajtimi mjekësor:** vendoseni personin e kthyer në kontakt me specialistin e tij ose të saj (të ri) të përgjithshëm. Ai / ajo duhet të jenë në gjendje të kontaktojnë me mjekun kur të jetë nevoja. Personi i kthyer mund të ketë marrë trajtim mjekësor të organizuar nga qeveria kur ka mbërritur dhe është arrestuar. Nëse është kështu, duhet të njoftohet specialisti i përgjithshëm.
- **Trajtimi i shëndetit mendor:** nëse nuk është bërë tashmë, ndihmoni personin e kthyer të kontaktojë me shërbimet lokale të shëndetit mendor nëse është nevoja.
- **Çështjet ligjore:** mund të ketë çështje specifike ligjore, si p.sh. njohja zyrtare e fëmijëve të personave të kthyer, pagesa e gjobave nga përpara se të largoheshin drejt territoreve të kontrolluara nga terroristët, ose si të ribashkohen me anëtarët e familjes me një kombësi tjetër. Merrni këshilla ligjore për personin e kthyer duke u lidhur me një avokat (ndoshta pa pagesë) ose përmes një koordinatori lokal nëse nevojitet.



7 Fëmijët e kthyer

Në hyrje të këtij manual jepej një përmbledhje e sfidave komplekse me të cilat përballen fëmijët e kthyer bazuar në përjetimet e tyre jashtë vendit. Ky kapitull fokusohet te mënyra e reagimit ndaj këtyre sfidave, duke marrë në konsideratë si sigurinë e fëmijës dhe ambientit të tij, ashtu edhe nevojës për ta risocializuar fëmijën sa më shpejt të jetë e mundur në një mjedis të ri.

7.1 Përmbledhje e përgjithshme

Sfidat me të cilat përballen fëmijët që kanë përjetuar ekstremizmin dhe terrorizmin do të kërkojnë masa të menjëhershme dhe përqasje afatgjatë, duke qenë se shumë prej efekteve të mundshme anësore mund të bëhen të dukshme në një fazë shumë më të vonshme.

Çfarë nënkuptojmë ne me “fëmijë”? Siç përcaktohet në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare. Parimet e përcaktuara në Konventën e OKB-së rreth të drejtave të fëmijëve janë ratifikuar nga të gjitha vendet e BE-së. Nga perspektiva ligjore, Shtetet anëtare të BE-së ndryshojnë në juridiksionet e tyre kur bëhet fjalë për përcaktimin nëse dikush nën 18 vjeç i përket legjislacionit të të miturve apo legjislacionit të të rriturve. Shpesh kjo do të varet gjithashtu nga natyra e krimit.

Fëmijët e kthyer: përkufizimi në këtë manual

Në këtë manual ka tre grupe që duhen marrë në konsideratë kur flasim për fëmijët e kthyer:

- fëmijët që janë larguar nga BE-ja (me familjet e tyre ose vetëm) për të jetuar brenda një organizate terroriste jashtë vendit dhe ata që janë kthyer (me familjet e tyre ose vetëm);
- fëmijët që kanë lindur në zonat e konfliktit terrorist dhe që kanë udhëtuar më pas drejt Evropës;
- fëmijët që kanë lindur në BE me nënë dhe/ose baba të përfshirë në një organizatë terroriste jashtë vendit (një luftëtare e huaj terroriste grua e kthyer ndërsa ishte shtatzënë me fëmijën). Në këtë rast, fëmija nuk ka jetuar brenda BE-së më parë dhe gjithashtu nuk ka jetuar në një zonë të konfliktit terrorist. Edhe kjo kategori përfshihet gjithashtu në manual sepse statusi si person i kthyer i prindërve mund të ketë efekt te fëmija në një fazë të mëvonshme në jetën e tij/saj.

Reagimet nuk do të ndryshojnë detyrimisht sipas grupit, por do të varen nga: niveli i traumës dhe indoktrinimit, karakteri dhe personaliteti, mjedisi direkt i fëmijës etj.

Fëmijët e moshave të ndryshme

Megjithëse është e qartë se mosha ka rëndësi kur bëhet fjalë për fëmijët e kthyer (si p.sh. koha sa ata kanë qenë të ekspozuar ndaj situatës së konfliktit dhe niveli i përfshirjes), nuk ka udhëzime të qarta mbi grupmoshat kur bëhet fjalë për reagimet. Në lidhje me ndërhyrjet me fëmijët, duhet të ndiqen udhëzimet psikologjike dhe psikiatrike. Kjo do të thotë se fëmijët kategorizohen në **fëmijë / para-adoleshentë dhe adoleshentë**. Vendimet rreth vijave ndarëse të secilës kategori duhet të merren nga profesionistët, dhe të merren në konsideratë ndryshimet në zhvillim dhe aspektet kulturore; por si udhëzim i përgjithshëm, nën moshën 12/13 vjeçare konsiderohen si para-adoleshentë dhe mbi këtë moshë janë adoleshentë. Ndërhyrjet gjatë adoleshencës janë të mundshme vetëm nëse fëmija ka arritur njëfarë niveli të caktuar konjitiv.³⁴

Nga momenti i ngjizjes dhe gjatë shtatzënisë, fëmijët mund të vuajnë nga rrethanat në të cilat jeton nëna e tyre; këto mund të sjellin gjithashtu efekte afatgjata pas lindjes. Këtu ka rëndësi të veçantë ndikimi i periudhave të stresit në fëmijën që zhvillohet³⁵ **Nëse nëna pëson rregullisht reagime të stresit fiziologjik, kjo ka ndikim dëmtes te fetusit që zhvillohet.** Kërcënimet në zhvillimin e trurit në 3,5 vitet e para (1000 ditët e

³⁴ Theodore, L. (2016) Handbook of Evidence-Based Interventions for Children and Adolescents. Springer, Nju-Jork.

³⁵ Mulder, E. J., De Medina, P. R., Huizink, A. C., Van den Bergh, B. R., Buitelaar, J. K., & Visser, G. H. (2002). Prenatal maternal stress: effects on pregnancy and the (unborn) child. Early human development, vol. 70(1), pp. 3-14.

para) konsiderohen gjithashtu se kanë ndikim të madh te aftësia e fëmijës për t'u përfshirë me botën rreth tyre.³⁶ Si pasojë, kjo duhet të merret në konsideratë kur punohet me fëmijë të vegjël që janë ekspozuar ndaj një situatë konflikti për një kohë relativisht të gjatë krahasuar me moshën e tyre.

Në rastet kur fëmijë të rritur (12 vjeç e lart) janë kthyer nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i dhe presupozohet se kanë qenë dëshmitarë ose pjesëmarrës në dhunën ekstreme, shqetësimi kryesor është se këta fëmijë janë më pak të hapur ndaj ndërhyrjes dhe më pak të aftë të ndryshojnë. Gjithashtu, dhe e mbështetur nga literatura e kriminalistikës që tregon influencat e personave të afërt në kryerjen e krimeve,³⁷ duhet të ketë shqetësime të konsiderueshme rreth përhapjes së ideve radikale mes personave të afërt. Përveç kësaj, është e rëndësishme që fëmijët më të rritur të trajtohen me shërbimet kyçe (p.sh. psikologjike, edukative, pastorale) të përshtatura për nivelin e tyre të zhvillimit. Ata nuk duhet të përfshihen në shërbimet e të rriturve.

Pavarësisht nga mosha e fëmijës, mbeten kyçe zhvillimi i aftësive ndërpersonale, menaxhimi i emocioneve, pasja e një jete familjare të qëndrueshme etj. për të garantuar mundësinë që këta fëmijë të bëhen anëtarë kontribuues në shoqëri.

Përvoja në punën me fëmijët që janë kthyer nga Siria dhe Iraku, është ende shumë e kufizuar brenda BE-së. Megjithatë, ekziston një sasi e madhe përvoja dhe studimesh në punën me fëmijët që janë ekspozuar ndaj situatave të luftimeve (p.sh. fëmijët ushtarë) si edhe ndaj traumës së rëndë dhe ideologjisë ekstremiste në përgjithësi. Përveç kësaj, ekzistojnë konventa dhe korniza ndërkombëtare që u japin formë politikave që përcaktojnë të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në situata vulnerabël, dhe që mund të ofrojnë direktiva gjatë hartimit të politikave dhe ndërhyrjeve në këtë fushë.

Bazuar në këtë përvojë, specialistët që punojnë me fëmijët e kthyer, qofshin këta policë, profesionistë të shëndetit mendor, punonjës social apo mësues, duhet të marrin në konsideratë sa vijon gjatë hartimit dhe aplikimit të ndërhyrjeve:

- Fëmijët që jetojnë/rriten në zonat e konflikteve janë në veçanti vulnerabël për shkak të abuzimeve me të cilat përballen, si edhe dhunës që mund të dëshmojnë, dhe për shkak të faktit se zhvillimi i tyre normal social, moral, emocional dhe konjitiv ndërpritet dhe dëmtohet nga përjetimi i luftës.³⁸ Përveç traumatizimit që lidhet me jetën në një zonë konflikti, **edhe procesi i rivendosjes (kthimit në BE) mund të jetë shkak për trauma të mëtejshme.** Kjo është edhe më e theksuar kur familjet ndahen, ose kur fëmijët udhëtojnë vetëm.
- Fëmijët e ekspozuar ndaj konfliktit të armatosur ka shumë mundësi të përballen me **trauma të shumta dhe të vazhdueshme**³⁹ që lidhen me dhunën ndërpersonale/ndërfamiljare, abuzimin seksual, urinë, kequshqyerjen, neglizhimin dhe braktisjen. Ekspozimi ndaj traumave të shumta dhe të përsëritura përbën një rrezik të konsiderueshëm për zhvillimin e fëmijës dhe funksionimin e përgjithshëm.⁴⁰ Gjithashtu, një mundësi tjetër është traumatizimi i mëtejshëm si rezultat i proceseve të zhvendosjes dhe të riintegritetit.⁴¹ Kjo mund të shkaktohet nga diskriminimi, përjashtimi social, mungesa e stabilitetit, papunësia e prindërve dhe mungesa e rrjeteve të personave të afërt për mbështetje.
- Kur fëmijët janë përfshirë në dhunë, provat psikologjike tregojnë paaftësinë për të miratuar në mënyrë të mjaftueshme përfshirjen e tyre në aktivitete të dhunshme dhe mungesën e aftësisë së tyre për të kup-

³⁶ Hair, N. L., Hanson, J. L., Wolfe, B. L., & Pollak, S. D. (2015). Association of child poverty, brain development, and academic achievement. *JAMA pediatrics*, vol. 169(9), fq. 822-829.

³⁷ Fergusson, D.M., Swain-Cambell, N.R. dhe Horwood, J. (2001) Deviant Peer Affiliations, Crime and Substance Use: A Fixed Effects Regression Analysis. *Journal of Abnormal Child Psychology*, vol.30 (4) fq. 419-430.

³⁸ Kohrt, BA., Jordans, MJD., Koirala, S. et al (2014). Designing Mental Health Interventions Informed by Child Development and Human Biology Theory: A Social Ecology Intervention for Child Soldiers in Nepal. *American Journal of Human Biology*, vol. 27, fq. 27-40.

³⁹ Ibid.

⁴⁰ Ibid

⁴¹ Fazel, M., Reed, R. V., Panter-Brick, C., & Stein, A. (2012). Mental health of displaced and refugee children resettled in high-income countries: risk and protective factors. *The Lancet*, vol. 379(9812), fq. 266-282.

tuar plotësisht pasojat e kësaj përfshirjeje. Mënyra se si rritet një fëmijë, si edhe zhvillimi i tyre biologjik, do të përcaktojë se në cilën moshë mund të pritët që ai ose ajo të kuptojë dhe të kontrollojë pasojat e veprimeve të tij/saj. **Ashtu si fëmijët ushtarë, fëmijët e kthyer mund të shihen si viktimë dhe në disa raste si autorë të krimeve në të njëjtën kohë.**

- Megjithatë janë në Evropë dhe larg zonës së konfliktit, specialistët duhet të jenë të ndërgjegjshëm se fëmijët ende mund të jenë në një **mjedis tranzicioni**. Kjo ndodh veçanërisht kur prindërit e tyre janë burgosur dhe ata, për shembull, jetojnë në kujdes birësues. Kjo mund të jetë penguese në punën me traumën dhe rindërtimin e rezistencës⁴².
- Ideologjia e ISIS-it dhe infrastruktura e komunitetit të tyre e orkestruar me kujdes, kanë krijuar bazat e një identiteti për fëmijët që shërben gjithashtu si faktor mbrojtës, duke u lejuar të qëndrojnë rezistentë ndërkohë që jetojnë në ato rrethana. Në ndërhyrjet që synojnë t'i adresohen ideologjisë/botëkuptimit të fëmijëve të kthyer duhet të merret parasysh se **dekonstruktimi i themeleve të identitetit të tyre dhe tranzicioni drejt një identiteti të ri është një proces kompleks dhe afatgjatë**. Prandaj, këto ndërhyrje duhet të zhvillohen në kontekstin e proceseve dhe/ose masave më të gjera të riintegritimit dhe rehabilitimit.
- Pas kthimit, **mjedisi shoqëror** i fëmijës (familja, komuniteti dhe grupet e personave të afërt) do të kenë ndikim të lartë te suksesi i rehabilitimit dhe risocializimit. Specialistët duhet të jenë të ndërgjegjshëm se disa persona të kthyer kanë qenë në qendër të vëmendjes publike/lokale dhe prandaj janë stigmatizuar ose janë kthyer në personazhe të famshëm në komunitete dhe grupe të caktuara. Fëmijët e moshave të ndryshme mund të bëhen objektiva të ardhshme të bullizmit dhe frikësimit ose, nga ana tjetër, do të rekrutohen sërish në rrethet ekstremiste.

Lexim i mëtejshëm: Manuali i ardhshëm i UNODC: Që prej vitit 2015, UNODC ka ofruar asistencë teknike për vendet që përballen me rekrutimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve nga grupet terroriste dhe ekstremiste të dhunshme. Në vitin 2017, UNODC do të publikojë një manual që fokusohet te trajtimi i fëmijëve të rekrutuar dhe shfrytëzuar nga grupet terroriste. Manuali, i cili synon të ketë si audiencë pikësepari ligjvënësit dhe politikëbërësit, si edhe specialistët, do të fokusohet në rolet e ndryshme të faktorëve të drejtësisë, në koordinim me sisteme të tjera, duke reaguar ndaj tri seteve të sfidave: i) parandalimi i rekrutimit të fëmijëve nga grupet terroriste dhe ekstremiste të dhunshme; ii) identifikimi i reagimeve efikase të drejtësisë ndaj fëmijëve të rekrutuar dhe shfrytëzuar nga këto grupe, iii) promovimi i rehabilitimit dhe riintegritimit të këtyre fëmijëve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet situatës specifike dhe nevojës së vazhdueshme.

7.3 Strategjia e reagimit ndaj fëmijëve të kthyer

Supozimet kyçe për një strategji reagimi:

Siç tregohet në **Dokumentin e RAN mbi fëmijët e kthyer nga zonat e konflikteve**⁴³, kur aplikohen politikat dhe strategjitë për të reaguar ndaj fëmijëve të kthyer, duhet supozuar se:

- *Të gjithë* fëmijët që kthehen nga Iraku dhe Siria janë ekspozuar ndaj një niveli dhune dhe kanë nevojë për ndërhyrje.
- Bazuar në programet intensive të indoktrinimit të ISIS-it, *të gjithë* fëmijët duhet të supozohen se janë përfshirë në njëfarë niveli dhe janë ekspozuar ndaj ideologjisë ekstremiste të ISIS-it.

Këto supozime nuk nënkuptojnë se të gjithë fëmijët janë ose do të bëhen ekstremistë të dhunshëm ose terroristë të mundshëm. Megjithatë, mund të ketë pasojë mosnjohja e ndikimit të kësaj ideologjie në potencialin për (ri)integrim në shoqërinë evropiane.

⁴² Rezistenca i referohet aftësisë së një fëmije për t'u përballur dhe për të reaguar si ndaj sfidave normale ashtu edhe ndaj atyre të jashtëzakonshme që ndodhin gjatë zhvillimit të tij.

⁴³ Radicalisation Awareness Network (RAN) (2016). Raport: 'Child returnees from conflict zones'. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_child_returnees_from_conflict_zones_112016_en.pdf.

Strategjinë për ndërhyrjet e reagimit duhet t'i drejtojnë tre kushte paraprake:

- 1. Një fokusim te ndërhyrja e hershme dhe normalizimi:** për rezultatet më të mira të mundshme në risocializimin e fëmijëve të kthyer në shoqërinë perëndimore, *filloni* sa më shpejt të jetë e mundur pas kthimit të tyre me normalizimin e jetës së përditshme të fëmijëve dhe socializimin e tyre në rrjetin e duhur shoqëror. Fëmijët do të përfitojnë nga një mjedis i strukturuar “normal” dhe i sigurt në të cilin ata mund të bashkëveprojnë në kopsht ose në shkollë me shokët. Gjithashtu, bazuar në konstatimet nga kriminologjia në përgjithësi, njihet se fëmijët që kryejnë krime përpara moshës 12 vjeçare, ka më shumë të ngjarë të jenë shkelës të vazhdueshëm.⁴⁴ Megjithëse këto konstatime nuk lidhen detyrimisht me dhunën por me deviancat më në përgjithësi dhe nuk ka studime deri më tani për fëmijët e rritur në territoret e kontrolluara nga terroristët, duhet të konsiderohet si një shtysë për t'u fokusuar te ndërhyrja e hershme (që do të thotë sa më shpejt që të jetë e mundur pas kthimit të fëmijës).
- 2. Një përjasje holistike multi-agjenci:** asnjë shërbim individual nuk mund të ofrojë reagimin e nevojshëm holistik ndaj fëmijëve të kthyer kur janë në izolim. Kur hartohet një reagim kombëtar dhe lokal ndaj fëmijëve të kthyer, nevojitet një përjasje multi-agjenci për t'iu adresuar nevojave personale, familjare dhe shoqërore të fëmijës. Në përgjithësi, ka të ngjarë që të përfshihen palët e mëposhtme në këtë përjasje: agjencitë e zbatimit të ligjit, shërbimet e fëmijëve, shërbimet e kujdesit social, autoritetet lokale, shkollat, shërbimet shëndetësore, shërbimet e lidhura me burgun dhe shërbimin e provës (p.sh. kur prindërit janë në burg), shërbimet e punësimit, organizatat sportive dhe të kohës së lirë, organizatat fetare dhe bamirëse etj.
- 3. Një përjasje e personalizuar bazuar në vlerësimin individual të rrezikut dhe nevojave:** secili rast do të ketë sfondin e vet, dinamikën, rreziqet dhe mundësitë për rehabilitim, që duhet të reflektohet në një vlerësim të rrezikut dhe të nevojave. Prandaj këto raste kërkojnë një përjasje të personalizuar, që përfshin faktorë të rëndësishëm që përmenden më lart. Të gjithë fëmijët kanë nevojë për një vlerësim të individualizuar të situatës, nevojave të tyre, madje edhe të rreziqeve, që të arrini të hartoni një ndërhyrje të përshtatshme për fëmijën.

Këto kushte paraprake janë jo vetëm specifike për fëmijët e kthyer, dhe ato bazohen në praktikën më të mirë të përgjithshme në punën me individët e radikalizuar që përfshihen në ekstremizëm dhe terrorizëm të dhunshëm.

Strategjia e reagimit mund të përbëhet nga një shumëllojshmëri ndërhyrjesh të ndryshme që shërbejnë për të garantuar sigurinë e vetë fëmijës, si edhe ato brenda rrethit të tyre shoqëror. Gjithashtu, do të ketë ndërhyrje që fokusohen në rehabilitimin dhe risocializimin e fëmijës në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm (p.sh. kthimi në shkollë, marrja e këshillimit, pjesëmarrja në aktivitete të kohës së lirë), që i adresohen mirëqenies së fëmijës dhe rrezikut që fëmija të bëhet i dhunshëm dhe/ose i radikalizuar në të ardhmen. Metodot dhe ndërhyrjet që mund të përdorin specialistët për të punuar me fëmijët e kthyer shpjegohen me më shumë detaje në paragrafin tjetër.

⁴⁴ Loeber, R., Farrington, D.P. dhe Petechuk, D. (2003), Child Delinquency: Early Intervention and Prevention. Child Delinquency, Bulletin Series (Maj). E disponueshme në <http://www.forensiccounselor.org/images/file/Child%20Delinquency%20Early%20Intervention%20and%20Prevention.pdf>.

Praktika në veprim: Udhëzime rreth mënyrës së punës me fëmijët e kthyer në Francë

Në 23 mars 2017, kryeministri francez prezantoi një **udhëzim për autoritetet franceze dhe specialistët mbi menaxhimin e** minorenëve francezë dhe të huaj që ktheheshin në territorin francez pas një qëndrimi në Irak ose Siri.

Përqasja thekson se si çdo situatë do të vlerësohet nga prokuroria kompetente, që do të vendosë nëse do të ndiqet rruga e ndjekjes penale. Prokuroria do t'ia referojë çështjen gjykatësit të të miturve për çdo masë mbrojtëse që gjykohet e nevojshme.

Qëllimi është të sigurohet që çdo fëmijë të marrë kujdesin e duhur (pas një vlerësimi somatik dhe psikologjik pas mbërritjes) dhe shkollimin që i korrespondon nevojave të tij, ndërkohë që e mbron nga rreziku i stigmatizimit që lidhet me historikun e familjeve të tyre.

Shkollimi është nën përgjegjësinë e drejtorit akademik të shërbimeve kombëtare të arsimit, i cili krijon koordinimin mes shërbimeve të departamenteve të ndryshme që përbëjnë sistemin kombëtar arsimor, qendrat e arsimit dhe të gjithë faktorët e tjerë përgjegjës për ndjekjen e këtyre minorenëve. Respektohet natyra konfidenciale e të gjithë informacionit të ndarë.

Njësitë lokale për parandalimin e krimit dhe radikalizimit dhe për mbështetjen e familjeve, të drejtuara nga prefektët në bashkëpunim të ngushtë me prokurorinë publike, garantojnë ndjekjen e përgjithshme të këtyre fëmijëve dhe prindërve të tyre (qoftë kur janë ose jo subjekte të masave gjyqësore).

Ky udhëzim thekson nevojën për të trajnuar siç duhet të gjithë individët përgjegjës për shoqërimin e këtyre minorenëve dhe bën thirrje për ngritjen e një komisioni, brenda Ministrisë së Drejtësisë, për të vlerësuar kujdesin social dhe arsimor të fëmijëve të kthyer.


Grafiku i mëposhtëm jep një përmbledhje të qarkut të koordinimit të informacionit që do të përdoret për fëmijët e kthyer.

Më shumë informacion mund ta gjeni në internet


CIRCUIT D'INFORMATION / RRJETI I INFORMACIONIT

Annexe 3 from 'Instruction relative à la prise en charge des mineurs à leur retour de zone irako-syrienne' — përkthime nga RAN CoE

Udhëzime rreth mbështetjes së minorenëve pas kthimit të tyre nga zona Irak-Siri



Entrée clandestine / Hyrje e paligjshme



7.4 Metodat dhe ndërhyrjet

7.4.1 Reagimi ligjor dhe mbrojtja e fëmijës

Kur një fëmijë kthehet në BE pasi ai (ose prindërit e tij) kanë qëndruar në një zonë me konflikt terrorist, bëhen të rëndësishme një numër çështjesh ligjore. Specialistët që punojnë me këta fëmijë duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këto, si edhe efektet që mund të kenë te rehabilitimi dhe risocializimi i fëmijëve.

- **Kombësia e fëmijës:** kombësia e fëmijës dhe, e lidhur me të, nënshtetësia e tij, do të varen nga gjykimet ligjore brenda secilit vend të BE-së. Vështirësitë më shpesh lindin kur fëmija ka lindur në zonën e konfliktit dhe nuk ka dokumente që konfirmojnë lidhjen biologjike të fëmijës me prindërit e tij/saj. Megjithatë, për të garantuar riintegrimin e fëmijës, është e rëndësishme të përcaktohet statusi i tij ose i saj ligjor. Në raste pasigurie, testi i ADN-së mund vërtetojë lidhjen biologjike. Aty ku nuk ka prova të ADN-së për lidhje biologjike, do të varet nga legjislacioni dhe jurisprudenca e zbatueshme në vendin përkatës nëse fëmija do të lejohet ose jo në BE dhe me çfarë statusi.
- **Kujdestaria e fëmijës:** mund të lindin pyetje se kush ka kujdestari mbi fëmijën. Ashtu si me kombësinë, përcaktimet specifike ligjore do të jenë specifike sipas vendit. Në shumicën e rasteve, nëse prindërit ende janë bashkë ose një prej prindërve shihet si në gjendje të kujdeset për fëmijën, ata do të kenë kujdestari (të përbashkët). Është më sfiduese kur prindi/prindërit nuk janë të përshtatshëm të kujdesen për fëmijën sepse ata janë p.sh. në burg, janë të paqëndrueshëm fizikisht/mendërisht ose janë rrezik potencial për fëmijën. Në ato raste, të afërmit si p.sh. gjyshërit mund të duan të kërkojnë kujdestarinë. Nëse nuk mund të gjendet një zgjidhje në mjedisin shoqëror të fëmijës, një kujdestar do të marrë kujdestarinë dhe fëmija mund të vendoset në një institucion ose në kujdes birësimi. Specialistët duhet të përballen me betejat për kujdestarinë e fëmijës, si edhe efektin destabilizues që mund të ketë kjo te fëmija dhe ata që janë rrotull tij/saj. Praktika tregon se fëmijët shpesh qëndrojnë me nënën sepse gratë e kthyerat ndiqen më rrallë penalisht se meshkujt.
- **Ndjekja penale e fëmijës:** ndërsa dalin në dritë gjithnjë e më shumë raportime shqetësuese rreth rolit të fëmijëve në luftë me grupet terroriste (p.sh. si sulmues vetëvrasës, si ushtarë, si ekzekutues), shtohen gjithashtu edhe pyetjet nëse këta fëmijë janë ligjërisht përgjegjës për veprimet e tyre. Siç specifikohet në raportin e vitit 2016 nga United Nations Interregional Crime and Justice Research Institute (UNICRI) rreth "Fëmijëve dhe antiterrorizmit", kuadri aktual ligjor në lidhje me fëmijët që janë rekrutuar nga grupe të armatosura ose terroriste, është kompleks. Në lidhje me rekrutimin në grupe ose forca të armatosura, ligji ndërkombëtar, traktatet dhe protokollet mbështesin linjën e mendimit se fëmijët nën 18 vjeç nuk duhet të ndiqen penalisht për këto veprime, por duhet të riintegrohen dhe të rehabilitohen, qoftë kur janë rekrutuar me detyrim ose me dëshirë, dhe qoftë kur kanë qenë luftëtarë aktivë ose kanë pasur rol mbështetës. Por, kur bëhet fjalë për grupet terroriste, situata bëhet shumë më komplekse. Shtetet anëtare të BE-së përcaktojnë kuadrin e tyre ligjor mbi grupet dhe aktivitetet terroriste, si edhe moshën në të cilën fëmijët mund të gjykojnë si të rritur, të udhëzuar nga kuadri ligjor i BE-së dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare. Sipas UNICRI, deri më tani duket se nuk ka asnjë kuadër specifik ligjor kur bëhet fjalë për fëmijë të rekrutuar nga një grup i armatosur ose terrorist. Jurisprudenca e fundit ka treguar se për akuzat për terrorizëm janë aplikuar dispozitat e drejtësisë për të miturit. Raporti i UNICRI rekomandon se, "rastet me fëmijë të përfshirë në aktivitete terroriste duhet të gjykojnë në përputhje me procedurën e të miturve dhe gjykatat e të miturve. Shkeljet terroriste nuk duhet të trajtohen ndryshe nga shkeljet e tjera penale që përfshijnë fëmijët."
- **Të drejtat e fëmijës dhe mbrojtja e fëmijës:** të gjitha Shtetet anëtare të BE-së kanë ratifikuar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), dhe kanë detyrimin ta zbatojnë këtë sipas ligjit ndërkombëtar. Parimi bazë pas kësaj konvente është se të gjitha shtetet veprojnë sipas interesave më të mira të fëmijës. Gjithashtu, ajo mbulon pajtueshmërinë me ligjet e kujdestarisë së fëmijës për të garantuar që çdo fëmijë të ketë të drejta bazë si e drejta për të jetuar, për të pasur emrin dhe identitetin e tij, për t'u rritur nga prindërit e tij brenda një një familjeje ose grupimi kulturor, dhe të ketë lidhje me të dy prindërit, edhe nëse ata janë të ndarë. Ekziston detyrimi që shtetet të lejojnë prindërit të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre prindërore. Ekziston gjithashtu detyrimi që të ofrohet përfaqësim i veçantë ligjor për një fëmijë në

çdo mosmarrëveshje gjyqësore në lidhje me kujdesin e tij dhe për t'u siguruar që të dëgjohet opinioni i fëmijës në këto raste. Gjithashtu, Konventa deklaron se palët duhet *“të marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, shoqërore dhe arsimore për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore.”* BE-ja e merr këtë konventë si pikënisjen për të drejtat e fëmijës dhe ka ndër-tuar politikat dhe veprimet e saj në përputhje me CRC. Kur bëhet fjalë për fëmijët e kthyer, veçanërisht ata që mendohet se janë përfshirë në aktivitete terroriste, raporti i UNICRI konkludon se:

“Në përgjithësi, parimet përkatëse të UNCRC, duke përfshirë të drejtën që për fëmijën konsiderata kryesore t'i jepet interesit të tij më të mirë, nuk duket se implementohen në lidhje me fëmijët e përfshirë në aktivitet terrorist, as në lidhje me masat e vendosura për anëtarët e tyre të familjes. Gjithashtu, nuk duket qartë se neni (3)(b) [i UNCRC], që kërkon nga shtetet të prezantojnë masa për të punuar me fëmijët pa iu drejtuar procedimeve gjyqësore, ose neni 37 (b) që kërkon që heqja e lirisë duhet të jetë masa e fundit për periudhën më të shkurtër të kohës, implementohen në ndonjë mënyrë kuptimplotë kur bëhet fjalë për fëmijë të përfshirë në aktivitete terroriste.”

Në përputhje me këto konstatime dhe konkluzione, një prej rekomandimeve kryesore të UNICRI është se: *“Shtetet duhet të inkurajohen të garantojnë që fëmijët të adresohen në mënyrë specifike në legjislacionin që lidhet me terrorizimin dhe që atyre u garantohen të drejtat e fëmijës sipas traktateve ndërkombëtare. Kjo mund të kërkojë dispozita speciale legjislative në lidhje me fëmijët nga pika e burgimit deri në pikën e dënimit dhe riintegrimin në legjislacionin vendas.”*

Për më shumë informacion rreth kësaj teme, shikoni [*Neuchatel Memorandum on Good Practices for Juvenile Justice in a Counterterrorism Context*](#)

- **Përqasja multi-agjenci dhe ndarja e informacioneve:** të gjitha Shtetet anëtare të BE-së kanë struktura dhe procedura për të punuar me fëmijët vulnerabël. Megjithatë, fëmijët e kthyer formojnë një grup të ri që kërkon përshtatjen e strukturave ekzistuese me realitetin aktual në lidhje me bashkëpunimin, përcaktimin e përgjegjësisë, koordinimin dhe ndarjen e informacionit. Për të punuar me efikasitet, shpejtësi dhe efikasitet në një përqasje multi-agjenci dhe për ta përshtatur atë me fëmijët e kthyer, është e nevojshme sa më poshtë:
 - Rregulla dhe rregullore të qarta ligjore rreth ndarjes së informacioneve, veçanërisht kur bëhet fjalë për trajtimin e fëmijëve në pozicione vulnerabël (si p.sh. abuzim me drogën nga prindërit, dhunë në familje, abuzim seksual). Praktika tregon se ndarja e informacionit të grumbulluar për qëllime sigurie është veçanërisht e vështirë, megjithëse ndonjëherë është e nevojshme për shërbimet e fëmijëve ose punën sociale për të kryer një vlerësim të shëndoshë të nevojave të fëmijës. Kjo kërkon vend për leje sigurie në disa raste. Nga ana tjetër, profesionistët e mbështetjes së familjeve mund të mësojnë diçka rreth historikut të fëmijës ose rrethanave që mund të ndikojnë në sigurinë dhe sigurimin e fëmijës. Ky lloj informacioni duhet të ndahet në mënyrë të strukturuar me policinë dhe shërbimet e inteligjencës.
 - Pjesë e strategjisë së reagimit duhet të jetë rishikimi i kuadrit aktual ligjor për bashkëpunim mes shërbimeve në mënyrë që të garantohet siguria, të mbrohet mirëqenia e fëmijës dhe të zhvillohet legjislacioni përkatës që lejon ndarjen e nevojshme të informacionit.
 - Sjellja e ekspertizës së ndryshme në tavolinat e partneritetit ose në njësitë e ekspertizës. Për fëmijët e kthyer, duhet të ketë ekspertizë për traumat (zhvillimin dhe reagimin), zhvillimin e fëmijës në përgjithësi, mbledhjen e informacionit të inteligjencës, sistemin gjyqësor, mbështetjen e familjeve, arsimin etj. Këto njësi ekspertize multi-agjenci mund të ndihmojnë me raste specifike, gjatë hartimit të trajnimit të përgjithshëm për specialistët e vijës së parë dhe vlerësimit të rreziqeve dhe nevojave.
- **Udhëzime ligjore për specialistët:** specialistët si p.sh. profesionistët e mbështetjes së familjeve dhe punonjësit socialë në kontakt me fëmijën dhe personat e tjerë të kthyer përballen me shumë pyetje nga familja dhe kontaktet shoqërore të familjes së personit të kthyer, duke përfshirë disa pyetje të natyrës ligjore. Këto mund të kenë lidhje me kujdestarinë, mbështetjen për të dërguar para, kombësinë,

nënshtetësinë etj. Specialistët gjithashtu flasin rreth një numri në rritje të çështjeve gjyqësore rreth këtyre çështjeve. Për të ofruar informacion të saktë për individët dhe familjet, si edhe për të mbrojtur specialistët që mund të përfshihen në çështjet gjyqësore, është shumë i rekomandueshëm krijimi i strukturës mbështetëse ligjore. Ky do të ishte një vend (qoftë fizik ose përmes një shërbimi online) ku punonjësit socialë ose profesionistët e mbështetjes së familjes mund të kërkojnë këshilla juridike rreth pyetjeve që ata marrin nga familjet e personave të kthyer. Mund të merret në konsideratë trajnimi i përshtatshëm ligjor për specialistët që punojnë me fëmijët. Qëllimi i këtij trajnimi mund të ishte zgjerimi dhe përfshirja e një fokusi të përgjithshëm mbi të drejtat e fëmijëve, dhe në veçanti të drejtat e fëmijëve që janë viktimë të dhunës, si dhe të drejtat e fëmijëve që janë në kontakt me sistemin e drejtësisë.

Rast studimor — Barrierat në punën me fëmijët e kthyer

Një grua 35-vjeçare me tre fëmijë të vegjël u kthye nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i pas qëndrimit atje për dy vjet. Shërbimet e sigurisë e takuan gruan në aeroport por ajo nuk u arrestua dhe nuk u ndoq penalisht. Shërbimet e sigurisë vazhduan ta kontaktojnë dhe ta vizitojnë atë rregullisht. Shërbimet sociale nuk u informuan, por mësuan pas disa muajsh se ajo ishte kthyer. Kur shërbimet sociale vizituan gruan, ajo nuk donte të diskutonte përvojën e saj apo se ku kishte qenë. Ajo pretendonte se kishte jetuar jashtë territorit të kontrolluar nga ISIS-i dhe nuk kishte marrë pjesë në aktivitetet e ISIS-it. Përmes të afërmeve, shërbimet sociale mësuan se gruaja dhe fëmijët e saj kishin jetuar në fakt në territorin e ISIS-it dhe kishin simpati të fortë për organizatën. Djali i saj më i madh kishte marrë pjesë në një kamp indoktrinimi/stërvitor. Ajo tani është gruaja e dytë e një ekstremisti dhe ka shkëputur krejtësisht kontaktet me autoritetet. Shërbimet sociale nuk janë në gjendje të hetojnë apo t'i marrin asaj fëmijët. Për shkak të kufizimeve në ndarjen e informacionit, nuk i është kaluar asnjë informacion shkollës që frekuentohet nga fëmijët.

Mësimet e nxjerra:

- Periudha e parë pas kthimit në shtëpi është më e rëndësishmja në lidhje me krijimin e kontaktit dhe ofrimin e ndërhyrjeve, duke qenë se shumica e personave të kthyer do të jenë më të gatshëm të flasin dhe të bashkëpunojnë në atë moment.
- Nëse informacioni nuk ndahet, ndërhyrjet mund të bëhen të vështira. Në këtë rast, moskalimi i informacionit të shërbimit socialë ose të shkollës do të thotë se ka qenë e vështirë që të kontaktohet gruaja ose fëmijët e saj.
- Është e rëndësishme që fëmijët të përfshihen nga fillimi dhe t'u ofrohet kujdes për shëndetin mendor për të trajtuar traumat.

7.4.2 Vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave

Rehabilitimi dhe risocializimi i fëmijëve varet shumë nga vlerësimet e rrezikut dhe nevojave. Këto duhet t'i adresohen mirëqenies fizike dhe mendore të fëmijës, nivelit të traumës, nivelit të indoktrinimit/mendimit ekstremist, qëndrimit ndaj dhunës etj. Për momentin, nuk janë zhvilluar vlerësime specifike rreziku për fëmijët e kthyer. Megjithatë, specialistët mund të përdorin mjetet ekzistuese psikometrike që vlerësojnë për shembull multikulturalizmin, identitetin e grupit, fleksibilitetin konjitiv dhe përkatësinë fetare.⁴⁵ Duke qenë se vlerësimet e specializuara ekzistuese për rrezikun mbi radikalizimin janë hartuar për të rriturit dhe ende janë në fazat e para kur bëhet fjalë për bazën e provave, ato nuk janë të përshtatshme për fëmijët e kthyer. Duke marrë parasysh faktin se fëmijët janë ende në zhvillim, një mjet më i përshtatshëm mund të ishte përdorimi i vlerësimeve individuale që përfshijnë vlerësimin e rreziqeve, por që fokusohet në situatën dhe nevojat e përgjithshme të fëmijës, dhe në mënyrën më të përshtatshme të veprimit në interesin e tij ose të saj më të mirë. Është e rëndësishme që të dallohet mes vajzave dhe djemve të kthyer, sepse ata mund të jenë ekspozuar

⁴⁵ Saklofske, D. H. Schwan, V. L., Reynolds, C. R. (2013) The Oxford Handbook of Child Psychological Assessment. Oxford University Press.

zuar ndaj formave të ndryshme të dhunës/traumës, dhe sepse mund të kërkojnë ndërhyrje të specializuara. Prandaj Shtetet anëtare duhet të investojnë në hartimin e vlerësimeve të specializuara për fëmijët e kthyer.

Praktika në veprim: Mjeti i kontrollit i Aarhus për familjet dhe fëmijët (në zhvillim).

Shërbimet sociale dhe Infohouse në Aarhus po zhvillojnë aktualisht një mjet kontrolli që do të përdoret nga specialistët që fokusohen në procesin e radikalizimit. Eventualisht, mjeti i kontrollit do të ketë katër kategori:

- 9 muaj - 1 vjeç
- 1-6 vjeç
- 6-12 vjeç
- 12-18 vjeç

Për më shumë informacion rreth këtij mjeti në zhvillim, kontaktoni me Aarhus Infohouse nëpërmjet: Christina Lehtinen — cle@aarhus.dk.

7.4.3 Vendosja dhe kushtet e jetesës

Procedura e kujdestarisë do të përcaktojë se ku jeton një fëmijë. Ky vend mund të jetë me prindërit e tij/saj, gjyshërit ose anëtarë të tjerë të familjes. Ky vend mund të jetë gjithashtu një institucion ose kujdes birësues me një familje tjetër nëse familja biologjike konsiderohet e papërshtatshme ose ndoshta edhe rrezik për rehabilitimin e fëmijës. Ky duhet të jetë opsioni i fundit sepse ndikimi të fëmija do të jetë i konsiderueshëm dhe i paparashikueshëm. Fëmija mund të kthehet në qytetin e tij/saj ose të prindërve, ose mund të fillojë një jetë të re diku tjetër. Bashkë me procedimet ligjore dhe (në disa raste) kufizimet, është e rëndësishme që të theksohet rëndësia e situatës së re të jetesës në procesin e rehabilitimit. Për qëllimet e rehabilitimit, normalizimi duhet të ndodhë sa më shpejt të jetë e mundur, por mund të influencohet nga faktorë si:

- punësimi i prindërve;
- pasja e një jete të përditshme të strukturuar;
- aksesin në një hapësirë private jetese;
- aksesin në arsim dhe aktivitete të kohës së lirë;
- jeta në një komunitet të përshtatshëm;
- aksesin te grupet e përafërta;
- shembujt për t'u ndjekur;
- një ndjesi vetëvendosjeje.

Ata që janë përgjegjës për të vendosur rreth kushteve të jetesës së fëmijës (kjo ndryshon sipas Shtetit anëtar, por kryesisht influencohet nga prindërit/familja e drejtpërdrejtë, autoritetet lokale, mbrojtja e fëmijëve, gjykatat e të miturve) nëse këta faktorë merren në konsideratë.

Rasti studimor: Grua e kthyer me tre fëmijë

Grua e kthyer, mosha 30 vjeçare, shkoi në Siri për 8 muaj me të shoqin dhe dy fëmijët. Ajo u kthye në fazat e fundit të shtatzënisë me një fëmijë të tretë dhe me dy fëmijët e tjerë. Presupozohet se i shoqi vdiq. Ajo nuk u arrestua, në pritje të hetimit, dhe tani jeton vetëm me tre fëmijët e saj dhe po përpiqet të gjejë punë. Që prej kthimit, janë përfshirë shumë organizata. Fillimisht u përfshinë shumë shërbime sociale, për shkak të shqetësimeve rreth fëmijëve të saj dhe gjendjes së saj mendore (fëmijët ishin të kequshqyer kur u kthyen) dhe janë ende duke monitoruar mirëqenien e fëmijëve. Policia dhe komuna janë përfshirë gjithashtu dhe e kanë vizituar rregullisht. Një menaxher çështjeje është caktuar të koordinojë të gjithë kujdesin e nevojshëm. Në rrjetin e saj jozyrtar, motra e saj është aktive dhe e ndihmon nëse ka nevojë të shkojë nëpër takime ose të flasë me zyrtarët. Ajo është gjithashtu në kontakt me familjen e saj dhe njerëzit e burrit, por në një shkallë më të vogël.

Mësimet e nxjerra:

- Është e rëndësishme që të vlerësohet mundësia që një person i kthyer të rikthehet në territoret e kontrolluara nga terroristët, për shembull për t'u bashkuar me bashkëshortin ose bashkëshorten. Në këtë rast, kjo fillimisht duket shumë e mundshme, prandaj janë diskutuar mundësitë për të parandaluar largimin e saj drejt Sirisë, p.sh. duke i marrë pasaportën. Është e rëndësishme që të ketë rrjete zyrtare dhe jozyrtare që mund të ofrojnë informacion rreth personave të kthyer.
- Arritja e një marrëveshjeje mes shërbimeve sociale dhe personit të kthyer mund ta mbajë një familje bashkë. Këtu, kishte shqetësime rreth sigurisë së fëmijëve. Por, personi i kthyer punoi me shërbimet sociale, duke iu përmbajtur asaj që u ra dakord, dhe fëmijët nuk i morën.
- Është e rëndësishme që të shikohet rrjeti më i gjerë rreth personave të kthyer. Një prej sfidave në këtë rast është se nuk dihet çfarë influence kanë njerëzit e burrit të saj, sepse edhe djali i tyre i dytë është nisur drejt Sirisë. Ekzistonte frika se mund të kishin influencë të keqe tek ajo dhe te fëmijët e saj.
- Investimi në lloje të ndryshme mbështetjeje dhe ndërtimi i një marrëdhënieje i ndihmon specialistët të vlerësojnë rrezikun dhe të gjejnë mundësi për shkëputje dhe deradikalizim. Ky person i kthyer u kontrollua për probleme të shëndetit mendor dhe tani merr ndihmë psikologjike. Ajo tani merr gjithashtu asistencë ndërsa kërkon punë dhe aplikon për përfitimet që i nevojiten për të stabilizuar jetën e saj.

7.4.4 Mbështetja e familjes

Qoftë me familjen biologjike ose në kujdes birësues, mjedisi i drejtpërdrejtë shoqëror luan një rol kyç në procesin e rehabilitimit. Duke qenë se në rastin e fëmijëve të kthyer, e gjithë familja biologjike mund të ketë përjetuar konflikte dhe trauma, ky është një rrezik i konsiderueshëm për mirëqenien dhe stabilitetin e fëmijës. Prandaj, duhet të ofrohet mbështetje dhe udhëzime nga ekspertë (p.sh. ekspertizë psikologjike, për traumë, teologjike, pedagogjike) për këto familje për t'i ndihmuar të përballojnë traumën dhe rrethanat e tanishme, si edhe që të kuptojnë se si të krijojnë një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm ku fëmija të rritet. (Shikoni kapitullin 4 për më shumë mbi mbështetjen e familjes.)

7.4.5 Roli i (para)shkollave

Aksesi në arsim është me rëndësi themelore për procesin e rehabilitimit të personave të kthyer. Është një faktor i rëndësishëm mbrojtës sepse sjell një ndjesi sigurie, normalizon jetën e përditshme të fëmijës, siguron ekspozimin ndaj diversitetit kulturor dhe rrit bashkëveprimin me individët jashtë shtëpisë.⁴⁶ Diskutimet mes specialistëve në Grupin e punës së Arsimit të RAN kanë sjellë informacione të rëndësishme (të

⁴⁶ Kia Keating & Ellis 2007; Hart, 2009.

përmbledhura më poshtë) se si duhet të përfshihen shkollat në rehabilitimin e fëmijëve të kthyer pa vënë në rrezik sigurinë e fëmijëve të tjerë, personelit të shkollës dhe të tjerëve të përfshirë.

Rast studimor — Fëmijë i kthyer që rikthehet në shkollë

Në mars 2014, një minoren mashkull u paraqit bashkë me të atin në shkollë për t'u regjistruar. Pas inspektimit rezultoi se djali kishte qenë në Siri për tre muaj dhe sapo ishte kthyer. Ai kishte ndjekur programin stërvitor gjatë qëndrimit në Siri. Ai ishte paraqitur shumë shpejt para një gjykate për të miturit, ku gjykatësi kishte vendosur se ai duhej të kthehej në shkollë sa më shpejt të ishte e mundur. Ky vendim u mor brenda një jave nga kthimi i tij. Historia e kthimit të tij ka disa versione: 1. U arratis sepse donte të shkonte në shtëpi. 2. Shkoi në Stamboll për të blerë veshje të ngrohta dhe më pas u arratis. 3. U kthye së bashku me një shok më të rritur.

Duke qenë se shkolla në fjalë në atë kohë u përball me një numër të rinjsh të radikalizuar, drejtori vendosi të kishte një takim konfidencial me disa prej mësuesve për të pyetur rreth reagimit të tyre dhe nëse do të ishin në gjendje të menaxhonin mësimin me këtë djalë në klasën e tyre. Mësuesit u përgjigjën me panik, disa filluan të qajnë dhe disa madje donin të jepnin dorëheqjen. Bazuar në këtë përvojë, drejtori vendosi ta referojë djalë në një shkollë tjetër dhe me konfidencialitet kontaktoi një koleg. Ishin në dijeni vetëm drejtori, punonjësi social, mësuesi i studimeve fetare dhe mësuesi kujdestar. Gjykatësi i të miturve gjithashtu vendosi një trajektore personale trajnimi, dhe familjes, në këtë rast vetëm babai, iu dhanë udhëzime. Procesi i riintegrit shkoi mirë. Djali do të diplomohet në fund të këtij viti shkollor.

- **Normalizimi si parim drejtues:** Parimi kryesor, gjatë punës me personat e kthyer në kontekstin arsimor, është “të kthehen në normalitet” sa më shpejt të jetë e mundur. Shkollat duhet të ofrojnë hapësirë të sigurt dhe të rregulluar, ku fëmijët ose fëmijët e rritur të ndihen të mbështetur, ku ka strukturë dhe rregulla dhe stresi largohet. Rreziku që një nxënës të shihet si “i ndryshëm” duhet të minimizohet, dhe duhet të bëhen përpjekje për të minimizuar vëmendjen.
- **Përballimi i rreziqeve të mundshme të paraqitura nga fëmijët e kthyer:** Për shkak të prejardhjes dhe përvojave personale, mund të ketë shqetësime se një fëmijë i kthyer paraqet rrezik për fëmijët e tjerë në shkollë; megjithëse jo shumë të mundshme, një ndërgjegjësim rreth reagimeve të traumës (si p.sh. sjellje e keqe dhe, në disa raste të rralla, dhunë ndërpersonale) dhe përgatitjet për t'u përballur me këto reagime, duhet të jenë pjesë e procesit të trajnimit për mësuesit. Siç është deklaruar më parë, duhet të kryhet një vlerësim i rrezikut dhe i nevojave përpara se fëmija të sillet në një mjedis arsimor.
- **Shkollat duhet të inkurajojnë fëmijët që të zhvillojnë ide dhe përgjegjësi:** Fëmijët duhet të mbështeten ndërsa bëhen anëtarë pozitivë të komunitetit të shkollës dhe u jepen mundësi për të qenë të suksesshëm. Kjo është edhe më e rëndësishme për fëmijët që perceptojnë se bëhet padrejtësi dhe janë të zemëruar ose të shqetësuar rreth zhvillimeve në jetën e tyre personale dhe në botë. Përballimi i zemërimit dhe trishtimit dhe padrejtësisë së perceptuar është thelbësor për të rezistuar kundër rreziqeve të ekstremizmit.
- **Kapërceni ngurrimin në disa shkolla për të marrë fëmijët e kthyer:** Disa shkolla mund të ngurrojnë të marrin fëmijët e kthyer sepse kanë frikë se brenda shkollës mund të ndodhë përhapja e ideve ekstremiste ose edhe akte terroriste. Kjo mund të krijojë tensione në shkollë dhe në komunitetet më të gjera. Për të kapërcyer këto sfida, duhet të emërohet një person/autoritet i pranueshëm dhe i besuar nga drejtorja e shkollës që të diskutojë, bindë dhe negociojë me shkollat rreth bashkëpunimit.
- **Ndarja e informacionit mbi mbërritjen e një fëmije të kthyer:** Është e rëndësishme që fëmija të mos paraqitet në shkollë pa asnjë njoftim. Drejtori i shkollës duhet të informohet dhe fëmija duhet të trajtohet në përputhje me procedurat e shkollës për mbrojtjen e fëmijës. Megjithëse mund të ketë disa përfitime nga ndarja e informacionit me personelin më të gjerë, kjo mund të sjellë anësi dhe stigmatizim që ngadalësojnë procesin e normalizimit. Mund të jetë e dobishme që të zhvillohen biseda me familjen se çfarë informacioni që duhet të ndahet, dhe me kë duhet të ndahet.

- **Shkollat duhet të kushtojnë më shumë vëmendje për mbarëvajtjen e fëmijës së ri:** Menaxhimi i shkollës duhet të sigurohet që fëmija të marrë vëmendje speciale, dhe që ata të mbahen të informuar rreth aktiviteteve të fëmijës dhe mirëqenies së tij. Ata mund t'i drejtojnë stafit pyetje, të përfshihen me fëmijën ose të caktojnë një anëtar të stafit ta monitorojë fëmijën nga afër.
- **Zhvilloni një strukturë mbështetëse për shkollat:** Kjo nevojitet për ta bërë të qartë për shkollat se kush janë ekspertët të cilët ata mund të mbështeten për të punuar me fëmijët e kthyer. Në bashkëpunimin multi-agjenci, shkollat duhet të bashkëpunojnë me partnerët në kujdesin e fëmijëve, kujdesin social, policinë, shërbimet e shëndetit mendor, ekspertët e traumës, shërbimet shëndetësore fizike, punonjësit që punojnë me të rinjtë, OJQ-të me ekspertizën përkatëse dhe organizuesit e aktiviteteve jashtëshkollore për të inkurajuar pjesëmarrjen.
- **Ofrojeni fëmijës një periudhë të ndërmjetme ripërshtatjeje:** Kjo mund ta ndihmojë fëmijën të fillojë (nga e para) në sistemin shkollor (pasi ka jetuar në një ambient krejtësisht të ndryshëm). Periudha duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur. Në disa vende, fëmijët duhet të hyjnë menjëherë në sistemin shkollor për shkak të legjislacionit/konfigurimit të sistemit. Gjatë periudhës së ripërshtatjes, është e rëndësishme që të ndërtohet besimi dhe të krijohet lidhje me fëmijën dhe familjen e tij/saj. Gjatë kësaj periudhe, mund të kryhet një vlerësim i nevojave dhe testim i aftësive gjuhësore, mirëqenies psikologjike dhe aftësive intelektuale.
- **Gjeni një përshtatje të mirë mes fëmijës së kthyer dhe shkollës:** Disa shkolla mund të jenë më të përshtatshme për fëmijën se të tjerat. Autoriteti përgjegjës për shkollat ose një qendër e specializuar duhet të luajnë rol kyç në identifikimin e shkollave më të përshtatshme. Ata duhet të japin trajnim, mbështetje dhe financim shtesë. Kthimi në mjedisin e vjetër dhe ish-shkollën mund të mos jetë në dobi të fëmijës dhe të familjes. Zhvendosja është në interes të fëmijës, që ai ose ajo, bashkë me pjesën tjetër të familjes, mund të kenë një fillim të ri pa stigmatizim apo admirim. Është e këshillueshme që të shmanget regjistrimi i këtyre fëmijëve në shkolla që ndodhen pranë vendeve ku janë kryer sulme në Evropë për shkak të pranisë së fëmijëve dhe stafit të traumatizuar ose të viktimizuar.
- **Trajtimi i publicitetit dhe reagimeve të shtypit:** Shkollat duhet të dinë se nëse pranojnë një fëmijë të kthyer, kjo mund të sjellë publicitet dhe tensione brenda komunitetit (të shkollës). Prindërit, shtypi dhe politikanët mund të fillojnë të drejtojnë pyetje dhe të ngrenë shqetësime. Për këtë nevojitet një strategji dhe konfidencialiteti duhet të jetë i rëndësishëm. Shkollat mund të përdorin protokollin e tyre të komunikimit në rast krize. Nëse ata nuk kanë ende një protokoll, ata mund ta bazojnë atë në mënyrën se si menaxhojnë fëmijët me të kaluar kriminale që kthehen në shkollë. Rekomandohet që shkolla të diskutojë strategjinë e tyre paraprakisht me autoritetin lokal. Në përgjithësi, shkollat nuk duhet të flasin me shtypin.
- **Programet speciale për fëmijët e kthyer:** Për sa u përket çështjeve të tjera delikate që përfshijnë fëmijët, fëmijët e kthyer nuk duhet të izoloohen apo të identifikohen për trajtim “special”. Por, kjo nuk hedh poshtë nevojën për programe mbështetëse individuale të personalizuar pas një vlerësimi të nevojave. Vlerësimi duhet të kryhet me përfshirjen e të gjithë familjes dhe të rrjetit mbështetës që ekziston jashtë shkollës. Rezultatet do të ndihmojnë shkollën të vlerësojë kapacitetet mësimore.
- **Krijimi i aksesit në ekspertizë rreth traumës dhe ekstremizmit:** Megjithëse në përgjithësi stafi i shkollës është i trajnuar të punojë me fëmijët vulnerabël, këshillohet trajnim shtesë rreth ekstremizmit dhe rrethanave në të cilat fëmijët e kthyer kanë jetuar. Shkolla gjithashtu duhet të ketë akses në një ekip ekspertësh rreth këtyre temave për ndihmë dhe mbështetje në situata sfiduese.

7.4.6 Praktika e informuar rreth traumës

Siç tregohet qartë në Dokumentin e RAN mbi fëmijët e kthyer nga zonat e konflikteve⁴⁷, ndërgjegjësimi për traumat është një aftësi që duhet ta kenë të gjithë specialistët e vijës së parë që punojnë me fëmijët e kthyer.

⁴⁷ Radicalisation Awareness Network (RAN) (2016). Issue Paper: ‘Child returnees from conflict zones’. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_child_returnees_from_conflict_zones_112016_en.pdf.

Aftësia për të njohur shenjat dhe simptomat e traumës është thelbësore për interpretimin e saktë të sjelljes së një fëmije dhe për të hartuar ndërhyrje të përshtatshme. Nevoja për këtë aftësi është përforcuar nga specialistët brenda Grupit të Punës të RAN Health and Social Care (RAN H&SC), që kanë prekur gjithashtu nevojën për “praktikë të informuar rreth traumës” gjatë punës me fëmijët e kthyer.

Specialistët që punojnë me fëmijë që janë rritur në mjedis radikal (si në Evropë ashtu edhe në zonat aktuale të luftës) duhet të kuptojnë natyrën e ndryshme të traumës dhe ndikimin e saj. Trauma shkakton një **reagim në varësi të ngarkesës** — sa më shumë trauma të përjetojnë fëmijët, aq më shumë mundësi ka që ata të kenë probleme psikologjike dhe fizike. Sjelljet rezultuese përfshijnë tendencën për të keqinterpretuar bisedat dhe për të qenë hiper-sensitivë, si edhe reagimet më shumë ose më pak sesa duhet (ose të dyja) ndaj stimujve. Këta fëmijë shpesh diagnostikohen gabimisht sikur kanë çrregullime të personalitetit, gjë që thekson nevojën që profesionistët të ndajnë informacione rreth historikut personal të një fëmije.

Ekziston nevoja që specialistët të kuptojnë “trurin e mbijetesës” të këtyre fëmijëve në lidhje me reagimin **largim/luftim/ngrirje** ndaj traumës (reagimet normale nga funksione të ulëta të trurit. Kur perceptojnë se janë nën rrezik, njerëzit do të luftojnë kërcënimin, do të largohen prej tij, ose do të ngrijnë si reagim). Kjo është pika ku “truri mendues” i këtyre fëmijëve të traumatizuar është rrëmbyer nga funksionet e ulëta të trurit, që nga ana e vet kalon në “regjimin e mbijetesës”. Fëmijët në regjimin e mbijetesës do ta kenë të vështirë të angazhohen sepse reagimi i tyre i parë është të mbijetojnë ose të “reagojnë”, në vend që të mendojnë “në mënyrë racionale” dhe të zhvillojnë dialog me profesionistët që po përpiqen t’i ndihmojnë ata.

Duhet të kuptohet se këta fëmijë nuk “dështojnë në angazhimin” me shërbime, siç supozohet zakonisht, por këta fëmijë “nuk janë në gjendje të angazhohen” për shkak të një kërcënimi të perceptuar. Profesionistët që punojnë për të sfiduar ideologjitë ekstremiste nuk mund ta bëjnë këtë kur një fëmijë është në regjimin e largimit/luftimit/ngrirjes sepse fëmija nuk është në gjendje të “mendojë” në atë pikë. Është e rëndësishme të garantohet që fëmija të ndihet i sigurt; procesi i ndërtimit të një raporti dhe krijimi i një mjedisi mikpritës dhe komod janë kontribuuesit kyçë për **tranzicionin e fëmijës nga “truri i mbijetesës” në “trurin mendues”**.

Procesi i krijimit të një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm dhe ndërtimi i një marrëdhënieje me fëmijën e kthyer, mund të zgjasë disa muaj. Megjithatë është e rëndësishme që të garantohet angazhimi efikas përpara se të punohet me luftimin e ideve ekstremiste, disa studime argumentojnë se nuk duhet të provohen ndërhyrje të konsiderueshme terapeutike për të paktën gjashtë muaj për shkak të nevojës që fëmija të përshtatet fizikisht dhe psikologjikisht me ambientin e ri. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet të ofrohet mbështetje, por që fëmijët që kanë përjetuar trauma të rënda paraqesin probleme të veçanta dhe këto mund të pengojnë më tej përfshirjen në terapi.

Për të zhvilluar praktikën e informuar rreth traumës, specialistët e RAN H&SC rekomandojnë që të punohet me fëmijët në bazë të një plani të përbashkët përkujdesjeje në të cilin autoritetet dhe institucionet e ndryshme të kujdesit kanë përgjegjësinë dhe ofrojnë ndërhyrje të ndryshme, por një menaxher i çështjes siguron vazhdimësinë e mbështetjes. Të gjithë partnerët e përfshirë duhet të jenë të ndërgjegjshëm për praninë e traumës dhe si të reagohet ndaj saj. Kjo përfshin specialistët dhe personelin e vijës së parë si p.sh. recepsionistët, që shpesh janë pika e parë e kontaktit gjatë përfshirjes me organizatat. Është e rëndësishme që ata të kuptojnë mënyrat në të cilat sjelljet e këtyre fëmijëve dhe/familjeve lidhen me traumën (p.sh. një fëmijë mund të jetë agresiv sepse është në “regjimin e mbijetesës”).

Lexim i mëtejshëm: *Dokumenti aktual i RAN H&SC i takimit të RAN H&SC mbi “Fëmijët dhe të rinjtë që rriten në një familje/mjedis të radikalizuar”* trajton traumën dhe praktikën e informuar rreth traumës gjerësisht dhe në lidhje me fëmijët.

7.4.7 Adresimi i ideologjisë ekstremiste

Si deklarohet në fillim të këtij kapitulli, **specialistët duhet të supozojnë se fëmijët e kthyer kanë pasur njëfarë niveli përfshirjeje dhe ekspozimi ndaj ideologjisë ekstremiste të ISIS-it**. Për të rriturit, adresimi i komponentit ideologjik të radikalizimit përmes ndërhyrjeve zakonisht referohet si “deradikalizim”. Megjithatë, ende nuk janë zhvilluar programe të përshtatura deradikalizimi për fëmijët e kthyer. Është e rëndësishme që të vihet re se, në shumë raste, pasi fëmija të jetë në një shtëpi të qëndrueshme, dhe të përfshihet rregullisht në shkollë, dhe njësia e familjes riintegrohet në shoqëri (p.sh. punësimi ose arsimimi i prindërve), çështja e ekstremizmit mund të zgjidhet vetë. Kjo ndodh sepse identiteti është i lidhur ngushtë me përjetimet e përditshme për fëmijët që rriten në një zonë konflikti. Ndryshimi i përjetimeve shpesh shoqërohet me një ndryshim të asaj dhe kush identifikohet fëmija.

Ekstremizmi duhet të adresohet dhe kjo duhet të bëhet me ndjeshmëri përmes një përjasjeje të kujdeshme dhe me nuanca. Nisja e programeve të deradikalizimit për të rinjtë që konfrontohen direkt me të rinjtë mbi çështjet e ideologjisë dhe identitetit, mund të sjellin një **krizë identiteti për fëmijët**, të përkeqësuar nga çështjet normale të identitetit që shoqërojnë tranzicionin nga fëmijëria në adoleshencë. Prandaj është e rëndësishme që të punohet dhe të rindërtohet një botëkuptim alternativ bazuar në përvojat pozitive dhe të ndryshme të përditshme. Familja, shkolla, komuniteti dhe organizatat e kohës së lirë mund të luajnë një rol pozitiv në ripërcaktimin e pikëpamjeve të fëmijës rreth shoqërisë dhe identitetit dhe rolit të tyre brenda saj.

7.4.8 Ndërtimi i kapaciteteve për të trajtuar fëmijët e kthyer

Ky manual ofron udhëzime rreth mënyrës së reagimit ndaj fëmijëve të kthyer. Megjithatë, shumë Shtete anëtare të BE-së kanë treguar se nuk kanë ende strukturat e duhura nëse fluksi i fëmijëve të kthyer përshpejtohet. Është e rëndësishme për Shtetet anëtare të fillojnë të ndërtojnë këtë kapacitet, dhe në veçanti në lidhje me:

- Zhvillimin e njohurive dhe ekspertizës për fëmijët e kthyer përmes zhvillimit të një përmbledhjeje ekspertize duke përfshirë profesionistë me përvojë rreth traumës (zhvillimi dhe reagimi), ekstremizmi, zhvillimi i fëmijës, arsimi dhe vlerësimi i rrezikut. Kjo ekspertizë duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme për specialistët e vijës së parë që punojnë me fëmijët e kthyer dhe e përshtatur sipas kontekstit lokal dhe kombëtar në të cilin do të rriten fëmijët e kthyer;
- Trajnimi bazë rreth ndërgjegjësimit për specialistët në kontakt (të drejtpërdrejtë) me fëmijët e kthyer (p.sh. mësuesit e shkollave, punonjësit socialë, anëtarët e organizatave të aktiviteteve argëtuese). Ky trajnim bazë duhet të mbulojë të paktën:
 - informacion rreth situatës në Siri/Irak ndaj të cilës janë ekspozuar këta fëmijë;
 - ushtrime bazë reaguese dhe për ndërgjegjësimin ndaj traumës kur fëmija i kthyer shfaq një sjellje të veçantë;
 - informacion rreth mënyrës se si të raportoni shenjat shqetësuese dhe ku të kërkonti ndihmë shtesë;
- Strukturat e qarta ligjore dhe organizative për punën me fëmijët e kthyer;
- Shërbimet ekzistuese të mirëqenies së fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve.



8 Çështjet që mbulojnë disa fusha

Ky kapitull përfundimtar ekzaminon dy tema të gjera me rëndësi të madhe për ata që punojnë me personat e kthyer: rolet e ndryshme dhe motivimet e luftëtarëve të huaja terroriste femra dhe grave të kthyer, dhe se si të komunikoni — me personat e kthyer dhe vetë familjet e tyre, si dhe me komunitetet në të cilat do të kthehen.

8.1 Diferencimi gjinor

Nëpër Evropë, shumica e luftëtarëve të huaj terroristë janë meshkuj (80 %). Ndërkohë që gratë përbëjnë mesatarisht 20%, ka ndryshime rajonale, pjesëmarrja e grave p.sh. është më e ulët në Itali dhe Spanjë (10%). Marrja në konsideratë e diferencimeve gjinore është me rëndësi për të parandaluar ndërhyrjet për një numër arsyes.

Duhet të kuptohen motivimet për pjesëmarrje në grupet xhihadiste në mënyrë që të përshtaten reagimet ndaj luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer. Për burrat, ka një fokusim të fortë te maskulizmi, jeta si luftëtar dhe glorifikimi i martirizimit. Një **sub-kulturë xhihadizmi modern gërsheton të rinjtë që kërkojnë sensacione me kulturën pop, propagandën dhe filmat**. Ruajtja e nderit riprodhohet përmes luftës dhe martirizimit. Studiuesi Evin Ismail e ka shpjeguar këtë maskulizëm të tipit “jeto shpejt, vdis i ri” brenda ISIS-it. Shpesh, rekrutët e rinj kanë një të kaluar kriminale dhe çrregullime psikologjike asociale që do të thotë se kanë një mori vështirësish, si p.sh. kontroll të ulët të impulsivitetit, probleme me menaxhimin e zemërimit, prirje për dhunë si mjet pushteti dhe kontrolli, nuk i kuptojnë mirë metaforat etj. Duhet të adresohet trauma nga shkaktimi, përjetimi ose dëshmimi i dhunës.

Në kontrast me këtë, roli i grave në propagandën e ISIS-it është projektuar drejt **identitetit dhe përkatësisë**, drejt pasjes së roleve aktive dhe vitale në ndërtimin e të ashtuquajturit Shteti Islamik. Nëse ato pëmbushin detyrat e tyre si gra dhe nëna, disa mund të kontribuojnë në mënyrë aktive si mësuese dhe infermiere, ose për propagandë ose rekrutim. Shpesh gratë tërhiqen nga vizioni romantik i një jete të devotshme fetare pa diskriminim, dhe ku ato bëhen themeli i familjes dhe i rritjes së brezit të ri. Për disa rekrute femra, ISIS-i është rruga e arratisjes nga problemet e vështira të identitetit, si p.sh. zgjedhja mes vlerave moderne perëndimore dhe ruajtja e parimeve tradicionale islamike të familjeve të tyre.

Si i tillë, ISIS-i mund të ofrojë një perceptim lirie nga traditat patriarkale dhe normat kulturore, për disa është një perspektivë emocionuese që të zgjedhin dhe të martohen me një luftëtar dhe të kenë rol mbështetës. Gjithashtu u ofron atyre mundësinë e nderimit si e veja e një martiri, selafistët e respektojnë rolin e grave për të lindur fëmijë dhe për t'i rritur ata që të bëhen martirë. Martesa është një institucion i detyrueshëm, dhe për të mbrojtur pastërtinë ato martohen mes moshës 9 dhe 17 vjeçare.

Luftëtarët e huaja terroriste femra të kthyer shpesh kthehen për të lindur fëmijët ose për t'u arratisur nga vështirësitë e konfliktit. **Gratë me fëmijë shpesh janë vulnerabël dhe kërkojnë mbështetje të konsiderueshme dhe angazhimin e shërbimeve sociale**. Shumë nga këto gra kanë frikë se do të humbin fëmijët për shkak të masave për mbrojtjen e fëmijëve. Gratë e kthyer shpesh izolohehen dhe ndihen të turpëruara përballë pjesës tjetër të komunitetit. Kjo kombinohet me traumën që kanë përjetuar, së bashku me fëmijët, përmes ekspozimit ndaj kushteve të luftës dhe dhunës së lartë brutale. Është thelbësore që të kryhet një vlerësim i rrezikut të këtyre personave të kthyer dhe fëmijëve të tyre, dhe që të ofrohet mbështetje kundër traumës, duke përfshirë edhe ata që nuk janë dënues për krime. Gratë që kanë përjetuar kushte të tmerrshme dhe realitetin e jetës në një regjim terrorist, shpesh janë të zhgënjyera pas kthimit.

Janë të dobishme masat e mëposhtme gjatë punës me gratë e kthyer:

- vizita të menjëhershme në shtëpi nga shërbimet sociale dhe policia (qoftë në mënyrë të pavarur ose së bashku) për të vlerësuar nivelin e angazhimit ndaj grupeve terroriste;
- një vlerësim të marrëdhënieve me anëtarët e familjes;

- mbrojtjen e fëmijëve, si edhe opsionet e ndryshme për këshillim;
- aksesin e shpejtë në trajtimin kundër traumës dhe shërbimet e shëndetit mendor;
- trajnimin e prindërve për personat e kthyer përveç mentorimit;
- krijimin e rrjeteve familjare, të mbështetura nga autoritetet lokale / OJQ-të.

8.2 Çështjet e komunikimit dhe kundër narrativave

Kjo pjesë përmban informacion dhe këshilla për opsionet e reagimit në nivel lokal për dy pyetje specifike komunikimi.

- Si t'u përgjigjeni sfidave të komunikimit në nivel lokal gjatë punës me personat e kthyer — Strategjia e komunikimit lokal.
- Si t'i përgjigjeni narrativës negative të grupeve terroriste rreth kthimit në vendet e BE-së — Komunikimi rreth kthimit.

Shikoni Aneksin 2 për Komunikimin strategjik dhe kundër-narrativat në lidhje me kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë, një përshkrim të elementeve për t'i marrë në konsideratë gjatë hartimit të strategjive të komunikimit për qeverinë rreth personave të kthyer.

8.2.1 Strategjia lokale e komunikimit

Përmbledhje e përgjithshme dhe çështje

Trajtimi i komunikimeve në lidhje me sfidat që paraqesin personat e kthyer kërkon përgatitje të kujdesshme. Një kërcënim i mundshëm i kombinuar me perceptimin e atij kërcënimi nga publiku i gjerë, si edhe shqetësimet e publikut të gjerë mbi rehabilitimin e një personi që është kthyer nga “lufta” krah për krah me terroristët, do të thotë se **nga personat e kthyer pritet që të krijojnë vëmendje të lartë mediatike**. Ata mund të bëhen gjithashtu çështje kontroverze që tërheqin vëmendje të lartë publike për faktorë destabilizues siç janë organizatat ekstremiste të djathta. Autoritetet lokale dhe partnerët e tyre të shoqërisë civile dhe të komunitetit duhet të përgatiten për vëmendjen dhe presionin e shtuar mediatik dhe politik. Prandaj, është e rëndësishme që të përgatitet një strategji komunikimi për të gjithë përjasjen për të reaguar ndaj personave të kthyer, idealisht përpara mbërritjes së personave të kthyer në komunitetin lokal.

Pse është e rëndësishme një strategji komunikimi

Është një **temë kontroverze**. Komunikimet rreth personave të kthyer ka mundësi të tërheqin vëmendje maksimale publike.

Është një temë polarizuese. Grupet ekstremiste dhe terroriste përdorin qëllimisht taktika dhe mesazhe të projektuara për të polarizuar dhe përçarë komunitetet.

- Në planin afatshkurtër, personat e kthyer paraqesin një **dilemë publike komunikimi** për qeverinë dhe partnerët.
- Në planin afatgjatë, autoritetet dhe komunitetet lokale duhet të punojnë së bashku për t'i **risocializuar ose integruar** personat e kthyer në shoqëri.
- Nuk ekziston një **profil shabllon për personat e kthyer**. Ekzistojnë ndryshime në motivimet për largimin dhe për kthimin. Komunikimi i nuancës është thelbësor, por sfidues.
- Reagimi i menjëhershëm publik ndaj kësaj çështjeje mund të jetë **emocional ose i bazuar mbi supozime të gabuara**. Në planin afatshkurtër, reagimet e menjëhershme të disave ndaj çështjes do të karakterizohen nga frika dhe zemërimi dhe duhen adresuar. Do të duhet kohë që faktet dhe shifrat të racionalizojnë diskutimin rreth kësaj teme.
- Personat e kthyer janë një çështje që mbulojnë disa fusha. Fenomeni i personave të kthyer **mund të provokojë debate ose polemika rreth një sërë prioritetesh të tjera**, si p.sh. radikalizimi në burgje, kohezioni në komunitet, deradikalizimi, si edhe strategjitë kombëtare të parandalimit.

Parimet drejtuese gjatë komunikimit me personat e kthyer

Gjatë hartimit të një strategjie lokale komunikimi rreth personave të kthyer, duhet të kihet parasysh një numër parimet drejtuese.

- Përgatitni një analizë lokale herët për të përcaktuar se si të jeni proaktiv dhe defensiv në komunikimet e punës. Komunikimet duhet të jenë të hapura dhe transparente.
- Sigurohuni që strategjia e komunikimeve lokale me personat e kthyer **të jetë e ndërthurur me strategji të tjera të rëndësishme**. Është shumë e rëndësishme që kjo punë të bashkërendohet me komunikime të tjera lokale dhe kombëtare strategjike rreth parandalimit të radikalizimit, dhe strategjitë e komunikimeve rreth radikalizimit në burgje. Një hap i gabuar në trajtimin e një çështjeje me personin e kthyer mund të ketë pasoja të mëdha për të dyja fushat e aktivitetit, dhe ka potencialin të bëhet një narrativë penguese për komunikimet e parandalimit.
- Qëllimi i komunikimit është ta çojë diskutimin drejt një hapësire që është sa më **e qetë dhe sa më racionale** që të jetë e mundur. Ndonjëherë komunikimet duhet t'u adresohen fillimisht emocioneve, shqetësimeve dhe frikës së audiencës.

Metodat konkrete

Në formatin e vet më të thjeshtë, ne këshillojmë që një strategji komunikimi të mendohet mirë në shtatë hapa.

5. **Përcaktoni qartë çështjen lokale** përmes studimit dhe kuptimit të komunitetit, medias dhe mendimit të gjerë të palëve. Në veçanti, fokusohuni te target-grupet, si p.sh. ato që kanë prirje për radikalizim nga organizatat e ekstremist të djathtë. Gjithashtu, sigurohuni që strategjia e komunikimit të jetë integruar me strategji të tjera komunikimi, kjo çështje mund të ketë ndikim në komunikimet e tjera dhe mund të frymëzohet nga ato. Cili është objektivi i qartë?
5. **Kuptoni se me kë doni të flisni** dhe si të flisni me ta qartë dhe në një mënyrë të kuptueshme për ta. Cilat janë zërat që përputhen me audiencat e synuara? Çfarë mesazhesh duhet të përçohen dhe si dëgjohen këto nga audiencia e synuar?
7. Punoni në mënyrë krijuese rreth fushatave dhe **punoni në partneritet** me të tjerët, në veçanti mes qeverisë (në ekipin lokal të bashkëpunimit multi-agjenci), komunitetit dhe partnerëve organizata bamirëse, si edhe me mbështetjen e agjencive (komunikimi, dizajni, media etj.) dhe ku është e mundur me kompanitë e medias sociale. A mund të identifikohen partnerët krijues? Pika kombëtare e kontaktit për personin e kthyer duhet të informohet rreth planeve të komunikimit dhe mund të japë informacione shtesë.
8. **Kush janë zërat në komunitet** dhe partnerët me të cilët do të punoni? A mund të ndajnë ata histori që mund të humanizojnë çështjen e personave të kthyer? Është e qartë se nevojiten fushata koncize për të nxjerrë në pah faktet, por do të nevojiten fushata më të gjera për të adresuar emocionet që kjo çështje mund të ngrejë, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes (të ekstremist të djathtë) ose islamofobinë.
9. **Mënyra e arritjes së një audience** do të varet nga fakti se kush janë ata, por media tradicionale nuk është gjithmonë më e besuara. Partnerët e komunitetit mund të jenë në gjendje të përdorin median sociale për të arritur ata që janë më "të përfshirë" me këtë çështje. A do të jetë ky një kontakt i koordinuar apo do të mbështetet me reklamat me pagesë që ofrojnë platformat e medias sociale? A do të ndihmojnë evenimentet lokale në komunitet për të shpjeguar këtë çështje? Këtyre pyetjeve duhet t'u ketë dhënë përgjigje tashmë kërkimi dhe analiza fillestare.
10. **Monitoroni reagimin** për çdo komunikim me kujdes. Kjo është përshtypja parësore dhe mund të përdoret në mënyrë të përsëritur për t'u informuar me punën dhe për të bërë përshtatjet e duhura. Kjo do të përfshihet gjithashtu në një vlerësim të suksesit të përgjithshëm të aktivitetit dhe do të ofrojë informacione rreth mangësive.

5. **Raportoni dhe diskutoni përpjekjet e komunikimit** dhe suksesin me palët e tjera në ekipin lokal multi-agjenci. Kjo punë do të ndihmojë me informimin e komunikimeve të ardhshme parandaluese dhe zhvillimet e politikës rreth personave të kthyer. Sigurohuni që rezultatet të bëhen të disponueshme dhe kërkon planifikim të mëtejshëm të komunikimeve për të vazhduar mbi këtë sukses.

Praktika në veprim: Seminaret e Komunitetit në Finlandë

Në Finlandë, Seminaret e Komunitetit organizohen në nivel lokal. Seminaret bashkojnë faktorë të ndryshëm lokalë nga sektorë të ndryshëm publikë (forcat e zbatimit të ligjit, shërbimet etj.), OJQ-të që specializohen në punën me grupet vulnerabël dhe që kanë ekspertizë në përpjekjet parandaluese lokale, komunitet fetare dhe organizatat e bazuara në komunitet, me akses bazë te qytetarët dhe besimi i tyre. Seminaret funksionojnë si platformë bashkëkrijuese dhe për ndërtimin e besimit dhe për praktikën dhe nismat lokale parandaluese. Pas një seminari, autoritetet lokale marrin mbështetje nga një ekip lokal multi-agjenci dhe plan veprimi. Objektivi i këtij bashkëkrijimi është të mundësohet një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës për të gjitha palët që parandalon gjithashtu stigmatizimin dhe “targetimin” e p.sh. komuniteteve myslimane. Kjo është e rëndësishme nga pikëpamja e komunikimeve strategjike — si polarizimi rreth temës së radikalizimit, ekstremizmi i dhunshëm dhe luftëtarët e huaj terroristë të kthyer, reflektojnë një imazh të ngushtë dhe të gabuar të natyrës së ekstremizmit të dhunshëm si fenomen. Për më shumë informacion, kontaktoni [Finn Church Aid dhe Peacemakers Network](#).

8.2.2 Komunikimi rreth kthimit

Përmbledhje e përgjithshme dhe çështje

Një numër specialistësh kanë raportuar se anëtarë të familjeve të luftëtarëve të huaj terroristë thonë se **ISIS-i ka një narrativë specifike rreth kthimit** për ta dekurajuar këtë (përveçse kur ata duan qëllimisht që personat të kthehen). Ata pretendojnë se personat që kthehen nga ISIS-i do të kenë trajtim jashtëzakonisht të keq në vendet e BE-së. Personat e kthyer do të burgosen menjëherë dhe për një kohë të gjatë, do t’u nxjerrin me detyrim informacione rreth ISIS-it gjatë hetimeve të gjata dhe personat e kthyer nuk do të pranohen kurrë (më) nga shoqëria. Mesa duket, strategjia e ISIS-it për t’i detyruar personat të qëndrojnë duke ndëshkuar ashpër ata që përpiqen të largohen nga territoret e kontrolluara nga ISIS-i,⁴⁸ plotësohet me narrativa të asaj që do të ndodhë nëse ata largohen.

Këto narrativa janë të thata, duke synuar që të bindin ata që mund të kthehen se kthimi në shtëpi nuk është opion. Personat e kthyer duhet të përballen me pasojat e veprimeve të tyre. Në realitet, kthimi në shoqëri në vendin e tyre është i mundur; do të zbatohen parimet e përgjithshme të shtetit ligjor, kujdesit shëndetësor, arsimit dhe sistemit të asistencës sociale. Duke qenë se shumica e personave të kthyer kontaktojnë me anëtarët e familjes përpara se të kthehen, këta të afërm janë në pozicionin më të mirë për të informuar luftëtarët e huaj terroristë rreth saj që do të ndodhë kur të kthehen. Specialistët që janë në kontakt me familjet e luftëtarëve të huaj terroristë mund të diskutojnë me familjet se çfarë ndodh dhe si mund të trajtohet anëtari i familjes nëse ai/ajo kthehet.

Parimi udhëzues gjatë komunikimit me familjet rreth kthimit nga territori i kontrolluar nga terroristët

- **Transparenca:** Tregohuni realistë dhe transparentë kur diskutoni pasojat dhe situatat me të cilat do të përballen personat e kthyer kur të kthehen. Personi i kthyer në fund të fundit i është bashkuar një grupi terrorist dhe duhet të përballlet me pasojat. Tregohuni transparent rreth ndjekjes penale, monitorimit nga policia apo shërbimet e inteligjencës, burgosja dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijëve. Dhe tregohuni po aq transparent rreth risocializimit, trajtimit mjekësor dhe/ose mendor, mbështetjes për punësimin dhe arsimin, si dhe opsionet e strehimit dhe të ndihmës sociale.

⁴⁸ Willsher, K., “Shkova të bashkohesha me ISIS-in në Siri, duke marrë me vete fëmijën katër vjeç. Ishte udhëtim brenda ferrit”, The Guardian, 9 janar 2016. Marrë nga <https://www.theguardian.com/world/2016/jan/09/sophie-kasiki-isis-raqqa-child-radicalised>.

Referencat

Briggs Obe, R., Silverman, T. (2014), *Foreign Fighters Innovations in Responding to the Threat*, Institute for Strategic Dialogue.

Cialdini, R. (2006), *Influence: The Psychology of Persuasion*, Harper Business, New York.

Dodwell, B., Milton, D., Rassler, D., *Then and Now: Comparing the Flow of Foreign Fighters to AQI and the Islamic State* (Version of 8 December 2016). E disponueshme në <https://www.ctc.usma.edu/v2/wp-content/uploads/2016/12/Then-and-Now.pdf>.

Dutch General Intelligence and Security Service (2017), Focus on Returnees. E disponueshme në <https://english.aivd.nl/publications/publications/2017/02/15/publication-focus-on-returnees>.

Dutch General Intelligence and Security Service (2016), Life with ISIS: the Myth Unravelling. E disponueshme në <https://english.aivd.nl/publications/publications/2016/06/17/life-with-isis-the-myth-unravelling-available-in-arabic>.

Fazel, M., Reed, R. V., Panter-Brick, C., & Stein, A. (2012). Mental health of displaced and refugee children resettled in high-income countries: risk and protective factors. *The Lancet*, vol. 379(9812), pp. 266-282.

Fergusson, D.M., Swain-Cambell, N.R. and Horwood, J. (2001) Deviant Peer Affiliations, Crime and Substance Use: A Fixed Effects Regression Analysis. *Journal of Abnormal Child Psychology*, vol.30 (4) pp. 419–430.

Ferguson, N. (2016), Disengaging from Terrorism: a Northern Irish Experience, *Journal for Deradicalization*. E disponueshme në <http://journals.sfu.ca/jd/index.php/jd/article/viewFile/41/36>.

Gustafsson, L., Ranstorp M. (2017). Swedish Foreign Fighters in Syria and Iraq; *An Analysis of open-source intelligence and statistical data*, Center for Asymmetric Threat Study, Swedish Defence University.

Hair, N. L., Hanson, J. L., Wolfe, B. L., & Pollak, S. D. (2015). Association of child poverty, brain development, and academic achievement. *JAMA pediatrics*, vol. 169(9), pp. 822-829.

Hart, R. (2009). Child refugees, trauma and education: interactionist considerations on social and emotional needs and development. *Educational Psychology in Practice*, vol. 25(4), pp. 351-368.

Horgan, J. G., Taylor, M., *Winter*, C., From Cubs to Lions: A Six Stage Model of Child Socialization into the Islamic State. *Studies in Conflict & Terrorism* (Volume 40, Issue 7, 2017).

Ingram, H.J. (2016), *Deciphering the Siren Call of Militant Islamist Propaganda* (The Hague: ICCT).

Kaati, L. (2017), *Det digitala kalifatet: En studie av Islamiska statens propaganda* (Stockholm: FOI (FOI-R—4429—SE).

Kia-Keating, M., & Ellis, B. H. (2007). Belonging and connection to school in resettlement: Young refugees, school belonging, and psychosocial adjustment. *Clinical Child Psychology and Psychiatry*, vol. 12(1), pp. 29- 43.

Kohrt, BA., Jordans, MJD., Koirala, S. et al (2014). Designing Mental Health Interventions Informed by Child Development and Human Biology Theory: A Social Ecology Intervention for Child Soldiers in Nepal. *American Journal of Human Biology*, vol. 27, pp. 27-40.

Lakhani, S., Ahmadi, B. (2016), Women in Extremist Movements: Not Just Passive Victims, (U.S. Institute of Peace). E disponueshme në <https://www.usip.org/blog/2016/11/women-extremist-movements-not-just-passive-victims>.

Loeber, R., Farrington, D.P. and Petechuk, D. (2003), Child Delinquency: Early Intervention and Prevention. *Child Delinquency*, Bulletin Series (May). E disponueshme në <http://www.forensiccounselor.org/images/file/Child%20Delinquency%20Early%20Intervention%20and%20Prevention.pdf>.

Maher, S., Neumann P. (2016). *Pain, Confusion, Anger, and Shame: The Stories of Islamic State Families*, International Centre for the Study of Radicalisation and Political Violence

Mehra, T., (2016). *Foreign Terrorist Fighters: Trends, Dynamics and Policy Responses*, ICCT Policy Brief.

Mulder, E. J., De Medina, P. R., Huizink, A. C., Van den Bergh, B. R., Buitelaar, J. K., & Visser, G. H. (2002). Prenatal maternal stress: effects on pregnancy and the (unborn) child. *Early human development*, vol. 70(1), pp. 3-14

Moghaddam, F.M., *The Staircase to Terrorism; A Psychological Exploration*, Georgetown University 2005. E disponueshme në [http://www.uni-bielefeld.de/ikg/zick/Moghaddam%20\(2005\)%20staircase%20model.pdf](http://www.uni-bielefeld.de/ikg/zick/Moghaddam%20(2005)%20staircase%20model.pdf).

Olidort J. (2016), Inside the Caliphate's Classroom: Textbooks, Guidance Literature and Indoctrination Methods of the Islamic State, *Policy Focus* 147

Orton, K. (2017), *Foreign Terrorist Attacks by the Islamic State 2002-2016*

Paulussen C., Nijman, J. and Lismont, K., (2017), Mental Health and the Foreign Fighter Phenomenon: A Case Study from the Netherlands, ICCT Report. E disponueshme në <https://icct.nl/wp-content/uploads/2017/03/ICCT-Paulussen-Nijman-Lismont-Mental-Health-and-the-Foreign-Fighter-Phenomenon-March-2017.pdf>

Pressman, D.E., *Risk Assessment Decisions for Violent Political Extremism* 2009-02. E disponueshme në <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/2009-02-rdv/index-en.aspx>.

Radicalisation Awareness Network (RAN), (2016). Issue Paper: 'The Root Causes of Violent Extremism'. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_root-causes_jan2016_en.pdf

Radicalisation Awareness Network (RAN), Collection of Approaches and Practices. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices_en

Radicalisation Awareness Network (RAN). (2016). Expert paper, RAN YF&C and RAN H&SC: 'Working with families and safeguarding children from radicalisation'. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_yf-c_h-sc_working_with_families_safeguarding_children_en.pdf

Radicalisation Awareness Network (RAN). (2016). Issue Paper: 'Child returnees from conflict zones'. E disponueshme në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_child_returnees_from_conflict_zones_112016_en.pdf

Saklofske, D. H. Schwan, V. L., Reynolds, C. R. (2013) The Oxford Handbook of Child Psychological Assessment. Oxford University Press.

Theodore, L. (2016) Handbook of Evidence-Based Interventions for Children and Adolescents. Springer, New York

Willsher, K., 'I went to join Isis in Syria, taking my four-year-old. It was a journey into hell', The Guardian, 9 January 2016. E disponueshme në <https://www.theguardian.com/world/2016/jan/09/sophie-kasiki-isis-raqqa-child-radicalised>.

Winter, C., *Documenting the Virtual Caliphate* (London: Quilliam Foundation, 2015).

Zelin, A. Y., *Picture Or It Didn't Happen: A Snapshot of the Islamic State's Official Media Output*. (Version of 2015). E disponueshme në <http://www.terrorismanalysis.com/pt/index.php/pot/article/view/445/html>

Aneksi 1:

Përmbledhje e mjeteve të vlerësimit të rrezikut

Ky aneks përmban informacione historike rreth mjeteve të ndryshme të vlerësimit të rrezikut që janë përdorur nga qeveritë. Katër mjetet e vlerësimit të rrezikut të përshkruara këtu duhet të gjyko-hen për përshtatshmërinë rreth meritave të tyre dhe në përputhje me rrethanat e personit të kthyer. Shumica e këtyre mjeteve të vlerësimit të rrezikut janë përdorur në burg. Gjykimet Profesioniste të Strukturuar kërkojnë trajnim për ata që i administrojnë ato.

Një mjet më i përgjithshëm është mjeti i vlerësimit HCR-20, i cili përdoret gjerësisht për të vlerësuar nivelet e rrezikut për sjelljen e dhunshme. Ka një bazë të konsiderueshme provash për këtë matricë rreziku, që mund të përdoret gjithashtu, nëse përshtatet, për vlerësimin e rrezikut të sjelljes së dhunshme mes personave të kthyer.

Extremism Risk Guidelines ERG22+

Extremism Risk Guidelines ERG22+ është produkti i studimeve të qeverisë së MB-së rreth proceseve të radikalizimit, është përshtatur si mjet vlerësues nga NOMS Operational Intervention Services Group, dhe është prezantuar në vitin 2011. Ai bazohet në 22 faktorë parësorë të radikalizimit dhe përdoret në Kuadrin e Channel Vulnerability Assessment (CVA). Secilit tregues i jepet një peshë e barabartë dhe tregon se mund të vëzhgohen faktorë të tjerë përtej këtyre 22 treguesve (që ndahen në tri fusha: angazhimi, qëllimi dhe faktorët e aftësisë).

IR46

IR46 nga Modeli i Shtëpisë së Sigurt Rajonale i Haaglanden (Veiligheidshuis) është një model policor holandez monodisiplinor për vlerësimin e rrezikut që është përshtatur për vlerësimin e rrezikut multi-agjenci. Ai bazohet në katër faza dhe në: *Shkallën drejt terrorizmit (Staircase to Terrorism)*.⁴⁹ Staircase to Terrorism i Moghaddam ndahet në dy kolona: Ideologjitë (Qëllimet) dhe Konteksti social (Aftësitë). Në tërësi, ky model ofron 46 tregues që ofrojnë bazën për vlerësimet e rrezikut multi-agjenci në të cilin secilin tregues vlerësohet përmes gjykimit multidisiplinor, të strukturuar dhe profesionist.

⁴⁹ Moghaddam, F.M., The Staircase to Terrorism; A Psychological Exploration, Georgetown University 2005. E disponueshme në [http://www.uni-bielefeld.de/ikg/zick/Mogh-addam%20\(2005\)%20staircase%20model.pdf](http://www.uni-bielefeld.de/ikg/zick/Mogh-addam%20(2005)%20staircase%20model.pdf).

VERA-2

Vlerësimi i rrezikut VERA-2⁵⁰ zhvillon treguesit specifikë që kombinojnë bindjet dhe qëndrimet që mbështesin ideologjinë; sfondin historik dhe ngjarjet që u japin formë ideve dhe bindjeve të personit; angazhimi dhe nxitësit motivues dhe kapaciteti i individit për të planifikuar dhe ekzekutuar një sulm të dhunshëm terrorist. Këto elemente më pas peshohen kundrejt *treguesve mbrojtës* që zbusin sjelljen e rrezikut.

TRAP-18

TRAP-18 është një instrument rreziku që kombinon sjelljet paralajmëruese (si p.sh. rruga, identifikimi, fiksimi dhe agresioni i ri) dhe 10 karakteristika të skajshme më afatgjata (si p.sh. ankesat personale, inkuadrimi ideologjik dhe psikopatologjia). Është një mjet hetues i fokusuar në veçanti në terrorizmin e “ujqve të vetmuar”.

HCR-20 – Vlerësimi i rrezikut të dhunës

Për të ndihmuar gjykimin e vlerësuesve, shumë përdorin HCR-20, duke e konsideruar atë si pikë të çmuar reference për të treguar më tej shkakun dhe rëndësinë e faktorëve dhe formulimin e çështjeve, duke përfshirë për shembull teori rreth personalitetit, aftësive njohëse sociale, çorganizimit social, dhe vendimmarrjes.

Bazuar në literaturën e gjerë rreth faktorëve që çojnë në dhunë, HCR-20 e merr emrin e saj nga tri shkallë — Historike, Klinike (e tashmja), Menaxhimi i Rrezikut (e ardhmja) — dhe nga numri i artikujve (20) që ajo mat. Secili artikull rreziku vlerësohet sipas një strukture vlerësimi me tre nivele (E ulët, Mesatare ose E lartë).

⁵⁰ Pressman. D.E., Vendimet për Vlerësimin e Rrezikut për Ekstremizmin e Dhunshëm Politik 2009-02. E disponueshme në <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/2009-02-rdv/index-en.aspx>.

I. Faktorët e rrezikut historik	Shkalla e rrezikut: E ulët	Shkalla e rrezikut: Mesatare	Shkalla e rrezikut: E lartë
1. Historiku i dhunës			
2. Moshë e re në incidentin e parë të dhunshëm			
3. Paqëndrueshmëria në marrëdhënie			
4. Problemet e punësimit			
5. Problemet e përdorimit të substancave			
6. Sëmundjet kryesore mendore			
7. Psikopatia			
8. Keqpërshtatjet e hershme			
9. Çrregullimet e personalitetit			
10. Dështimi i mëparshëm i mbikëqyrjes			
II. Artikujt klinikë (faktorët aktualë)	Shkalla e rrezikut: E ulët	Shkalla e rrezikut: Mesatare	Shkalla e rrezikut: E lartë
11. Mungesa e informacioneve			
12. Qëndrimet negative			
13. Simptomat aktive të sëmundjeve kryesore mendore			
14. Impulsiviteti			
15. Mungesa e reagimit ndaj trajtimit			
III. Artikujt e menaxhimit të rrezikut (faktorët e ardhshëm)	Shkalla e rrezikut: E ulët	Shkalla e rrezikut: Mesatare	Shkalla e rrezikut: E lartë
16. Planeve u mungon prakticiteti			
17. Ekspozimi ndaj destabilizuesve			
18. Mungesa e mbështetjes personale			
19. Mospajtueshmëria me përpjekjet për ndreqje			
20. Stresi			

Aneksi 2:

Personat e kthyer: Çështjet e komunikimit dhe kundër narrativave

Informacion këshillues i ESCN,
Maj 2017



Personat e kthyer:

Çështjet e komunikimit dhe kundër narrativave

1. Pamje e përgjithshme: Sfida e komunikimeve

- 1.1 ISIS-i ka krijuar tashmë një ndryshim të paradigmës në cilësinë e komunikimeve terroriste. Por, ndërsa i ashtuquajti “kalifat” në Siri dhe Irak bie, ISIS-i duhet të përshtasë mesazhet e veta për të mbajtur pozitën si i rëndësishëm.
- 1.2 ISIS-i dhe mbështetësit e tij nuk u kërkojnë më njerëzve të ndërmarrin hixhretin, por inkurajojnë mbështetësit përëndimorë, duke përfshirë edhe personat e kthyer, që të kryejnë akte terroriste në emrin e tij. ISIS-ia ka filluar tashmë të ristrukturojë narrativat e tij duke shfrytëzuar më shumë përvojat e myslimanëve në Perëndim për të krijuar regjime të dhunshme të ata që nuk kanë qenë në gjendje të udhëtojnë drejt kalifatit dhe të ata që kthehen nga një zonë konflikti.
- 1.3 Komunikimet “zyrtare” të ISIS-it janë në rënie, duke preferuar në vend të kësaj të rrisin përdorimin dhe varësinë të rrjetet “jozyrtare”. Tre rrjete “jozyrtare” shfrytëzojnë më së shumti faktorët “nxitës” që përforcojnë perceptimin se nuk mund të jetohej i qetë si mysliman në Perëndim. Këto rrjete jozyrtare përbëhen nga ithtarë dhe mbështetës, shumë prej të cilëve do të përfaqësohen nga ata që janë kthyer nga shërbimi pranë ISIS-it në Irak dhe Siri.
- 1.4 Strategjia e re e ISIS-it është “përçaj, polarizo dhe radikalizo”. Duke përhapur narrativat që shfrytëzojnë ndjesinë e diskriminimit, paragjykitimit dhe pabarazisë, të nxitura këto nga ndjenjat anti-muslimane në Perëndim, ISIS-i po krijon një sens të fortë padrejtësie dhe viktimizimi.
- 1.5 Si rezultat, ISIS-i po krijon një komunitet global me njerëz besnikë përmes një narrative të vetme të shtypjes dhe revoltës, duke portretizuar poshtërimin dhe pafuqinë e “ummah”. Personat e kthyer përbëjnë një strukturë bazë të mbështetësve dhe mbrojtësve besnikë përvojat personale të të cilëve do të sjellin peshë në përpjekjet influencuese të ISIS-it.
- 1.6 Kthimi i “ish-luftëtarëve” që kanë braktisur ISIS-in dhe familjet që kanë qenë dëshmitare të jetës nën ISIS-in, “personat e kthyer”, luajnë kështu një rol të rëndësishëm në përcaktimin e suksesit të përpjekjes së ISIS-it për të ristrukturuar strategjinë e vet të komunikimit. Po ashtu, dhe në masë të barabartë, ata përfaqësojnë një mundësi për të marrë dëshmi të jetës reale që mund të hedhin poshtë dhe riformulojnë legjitimitetin e përpjekjeve zyrtare dhe jozyrtare të komunikimit të ISIS-it.

2. Përqasja strategjike e komunikimeve

- 2.1 Një aplikim i disiplinuar i parimeve strategjike të komunikimeve mund të mbështesë hartimin dhe ndërmarrjen e përpjekjeve specifike të komunikimeve në përgjigje të sfidës së “personave të kthyer” të përshkruar më lart.

1. Përkufizoni **Problemin**

Përqasja e Shtetit anëtar ndaj personave të kthyer ndryshon. Për të përkufizuar problemin, duhet të aplikohet një përqasje kërkimore, proces që përcakton se cilat elemente të personave të kthyer janë shkaku i shqetësimit brenda secilit juridiksion, dhe se si mund të reagojnë komunikimet ndaj kësaj.

2. Kuptoni **Audienca**t

Përqasja studimore garanton më tej që ne të kuptojmë se cilët nxitësve emocionalë dhe psikologjikë duhet t’u drejtohen komunikimet për të gjetur përputhje me personat e kthyer. Si komunikojmë ne me ta? Përmes cilave kanale dhe cilave zëra gjejnë ata përputhje?

3. Hartoni **Arkitekturën**

Aty ku ekzistojnë programet e rehabilitimit për personat e kthyer, megjithëse janë të udhëhequra nga qeveria, ato zbatohen nga partnerë të shoqërisë civile. Ndërhyrjet mes personave të përafërt pothuajse ofrohen vetëm përmes projekteve të partneritetit të cilat shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë përvojën e qeverisë dhe shoqërisë civile. Një reagim ndaj komunikimeve duhet të pasqyrojë atë përqasje partneriteti.

4. Ndërtoni **Partneritetet**

Në shumë raste, Shteteve anëtare do t’u kërkohet të zhvillojnë rrjetë të reja të shoqërisë civile për të plotësuar nevojat për kapacitete të zhvillimit të projekteve dhe ofrimit të ndërhyrjeve. Përmes cilave marrëdhënie ekzistuese mund të punohet? Cili element i mbështetjes së industrisë nevojitet për ta bërë këtë punë me efikasitet?

5. Zbatoni Fushatat

Bazuar në një kuptim të qartë të problemeve dhe audiencave, dhe të zbatuara përmes partnerëve të duhur brenda arkitekturave të reja të përshtatshme, komunikimet mund të jenë shumë efikase në adresimin e “personave të kthyer”. Kjo përjasje e veçantë do të kërkojë prezantimin e një fushate inovative dhe të posaçme dhe të dhe produkteve që mund të aplikohen, shpesh përmes ndërhyrjeve, për t’iu adresuar personave të kthyer.

6. Matni Performancën

Studimi fillestar ndihmon gjithashtu matjen e performancës së fushatave. Përveç vlerësimit të shkallës së kontaktit përmes analizës së komunikimeve, mund të shfrytëzohen edhe të dhënat e mëtejshme sasiore dhe cilësore për të treguar impaktin, por vetëm kundrejt një vije bazë të ndërmarrë në fazat fillestare të studimit.

7. Raportoni Suksesin

Raportimi i suksesit, por edhe i mësimave, brenda qeverive dhe palëve, ndihmon në ndërtimin e vullnetit dhe konfidencës në efektshmërinë e komunikimeve si mjet për t’iu adresuar kësaj çështjeje.

3. Zhvillimi i një reagimi

3.1 Hartimi i një përjasjeje të drejtuar nga studimet

- 3.1.1 Studimet janë themeli për të gjitha komunikimet e mira dhe përbën hapin e parë në zhvillimin e reagimit të komunikimeve ndaj një çështjeje strategjike. Një përjasje e drejtuar nga studimet ndaj komunikimeve strategjike, siguron që përpjekjet e komunikimeve të përcaktojnë problemin e komunikimeve dhe të zhvillojnë arritjen e kuptimit nga audienca. Nëse bëhet mirë, kjo siguron që komunikimet të jenë në një linjë me audiencën e synuar, të arrijnë efektin e dëshiruar dhe të sigurojnë prova të suksesit të saj.
- 3.1.2 Megjithatë, megjithëse ka studime të gjera që kanë arritur të kuptojnë komunikimet e ISIS-it, studimet mbi “personat e kthyer”, megjithëse po zhvillohen me shpejtësi, janë aktualisht të kufizuara.
- 3.1.3 Duhet të zhvillohen studime të cilat kuptojnë më mirë nxitësit emocionalë dhe vulnerabilitetet e personave të kthyer për të përcaktuar se cilat komunikime nevojiten për t’iu adresuar këtyre emocioneve.

- 3.1.4 Në mënyrë të ngjashme, si pjesë e këtij ushtrimi duhet të eksplorojnë më tej studime që kuptojnë fuqinë dhe ndikimin e dëshmimeve personale të atyre që kthehen për të reduktuar fuqinë e markës ISIS për të rekrutuar mbështetës të rinj.
- 3.1.5 Rrjetet evropiane duhet të inkurajohen për të ndarë përvojën dhe njohurinë për të hartuar praktika më të mira në zhvillimin e përqasjeve të studimeve dhe për të dhënë një kuptim të problemit dhe audiencave.
- 3.1.6 Studimet cilësore janë përqasja më e mirë për të garantuar arritjen e një kuptimi shumë të hollësishëm dhe të personalizuar të çështjes.

3.2 Krijimi i përmbajtjes së fuqishme

- 3.2.1 Studimi i fenomenit të personave të kthyer është tepër i individualizuar. Po ashtu duhet të jetë edhe reagimi ndaj komunikimeve.
- 3.2.2 Sfida e komunikimeve që paraqet ISIS-i është një sfidë thellësisht emocionale dhe psikologjike, sepse ajo shfrytëzon brishtësitë personale të audiencës që synon. Komunikimet e ISIS-it gjithnjë e më shumë shfrytëzojnë emocionet më shumë sesa ideologjinë ose teologjinë.
- 3.2.3 Përqasja e studimit, e përkufizuar më lart, duhet të synojnë të kuptojnë këto nxitës emocionale që qëndrojnë në qendër të mentalitetit të personit të kthyer.
- 3.2.4 Analiza aktuale thekson katër karakteristika shumë të rëndësishme emocionale, të lidhura dhe që mbështesin njëra-tjetrën në mënyrë reciproke, të cilat deri më sot kanë përcaktuar joshjen e ISIS-it.
 - I. Viktima e pafajshme;
 - II. Drejtësia ose hakmarrja;
 - III. Ndjekja e famës apo e njohjes;
 - IV. Turpi ose faji.
- 3.2.5 Duke kuptuar këto karakteristika emocionale, ne mund të prodhojmë produkte komunikimesh që ndihmojnë që ato të “zëvendësohen” ose të “kanalizohen në drejtime të ndryshme”.
- 3.2.6 Ky proces i përfshirjes emocionale është hartuar për të krijuar një “moment dyshimi”, i projektuar për të sfiduar ata që mendojnë të bashkohen me “kalifatin”, përfshi edhe personat e kthyer, që të mos kryejnë akte terrorizmi të brendshëm.
- 3.2.7 Kjo përqasje mund të jetë rreth “alternativave pozitive” si “kundërnarrativa” dhe faza e zhvillimit të çdo përqasjeje duhet të eksplorojë këto opsione.

3.2.8 Prandaj, një përjasje strategjike duhet t'u drejtohet nxitësve përkatës emocionalë, duke ofruar botëkuptime alternative pozitive dhe duke ngritur dyshime të mjaftueshme në mentalitetin e personave të kthyer.

3.2.9 Prandaj, fokusi duhet të jetë që të realizohen:

1. Komunikime të fuqishme që adresojnë nxitësit emocionalë që përdoren për të gjeneruar një reagim te personat e kthyer.
2. Komunikime që ndërtojnë marrëdhënie mes individëve të rrezikuar dhe atyre që janë në gjendje të realizojnë ndërhyrjet përkatëse;
3. Komunikime që ofrojnë alternativa pozitive dhe i kanalizojnë individët në angazhime më pozitive;
4. Komunikimet që mund të aplikohen në angazhime mes personave të afërt dhe mund të krijojnë përmbajtje efikase virtuale.
5. Komunikimet që shfrytëzojnë zërin e personave të kthyer ku ata janë në gjendje t'i adresohen direkt fuqisë së ndikimi të markës së ISIS-it përmes dëshmime personale.

3.3 Përhapja e dëshmime personale

3.3.1 "Personat e kthyer" përbëjnë një mundësi për të shfrytëzuar një gamë dëshmish reale, të fuqishme dhe personale për të nxjerrë në shesh mashtrimet që përmban narrativa e ISIS-it. Përmbajtja duhet të tregojë se pretendimet e ISIS-it janë të rreme.

3.3.2 Prandaj, personat e kthyer, nëse konsiderohen si "jokriminelë" dhe aty ku gjykohet se nuk janë më shqetësime për shërbimet e sigurisë, mund të përdoren si një zë për komunikim më të gjerë parandalues.

3.3.3 Historitë e ish-luftëtarëve që kanë braktisur ISIS-in ose familjet që kanë qenë dëshmitare të jetës nën ISIS-in mund të përdoren për t'u folur atyre që janë në rrezik radikalizimi, në veçanti ndaj thirrjeve për të shkuar në territoret e ISIS-it, për t'u përfshirë në dhunë, ose për t'u bashkuar me organizatën jashtë vendit.

- 3.3.4 E theksojmë shumë që kjo duhet të bëhet me kujdes, për t'u siguruar që ata kanë trajnimin e duhur, dhe janë të ndërgjegjshëm për presionin psikologjik që do të sjellin diskutimet publike. Individit duhet t'i përmbahet detyrimit që të tregojë kujdes, dhe ndoshta mund të jetë tepër herët për këto përpjekje.

3.4 Adresimi i komuniteteve në një reagim me spektër të plotë

- 3.4.1 Strategjia e re e ISIS-it është "përçaj, polarizo dhe radikalizo". Duke përhapur narrativat që shfrytëzojnë ndjesinë e diskriminimit, paragjykitimit dhe pabarazisë, të nxitura këto nga ndjenjat anti-myslimane në Perëndim, ISIS-i po krijon një sens të fortë padrejtësie dhe viktimizimi brenda komuniteteve myslimane. Organizatat e ekstremit të djathtë po reagojnë, duke shfrytëzuar rritjen e perceptuar në kërcënime të brendshme.
- 3.4.2. Prandaj, qeveritë dhe komunitetet duhet të përgatiten t'u adresohen komunikimeve negative nga këto grupe që mund të përdorin gjithnjë e më shumë si kapital çështjen e personave të kthyer për të nxitur tensione në komunitet, frikë dhe dhunë, si edhe për përkeqësuar më tej rrezikun e tensioneve të komunitetit.
- 3.4.3 Në këtë kontekst, duhet të merren në konsideratë përpjekjet që synojnë reduktimin e izolimit, polarizimit dhe stigmatizimit.

Ky manual është shkruar nga Marije Meines, Merel Molenkamp, Omar Ramadan dhe Magnus Ranstorp — dhe redaktuar nga Nicola Davenport — të gjithë nga RAN Centre of Excellence.

Autorët dëshirojnë të falënderojnë specialistët e shumtë që ndanë rastet studimore, këshillat dhe praktikat dhe informacione të tjera. Pa mbështetjen e tyre, realizimi i këtij manuali nuk do të ishte i mundur.

Translated within: